



**UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT
PROGRAMI I DOKTORATURËS “SHKENCA EKONOMIKE”**

**“AMVISIMI I RREZIKUT TË KREDISË NË
BANKAT TREGTARE NË KUADËR TË
IMPLEMENTIMIT TË BAZEL I/II”**

**UDHËHEQËSI SHKENCOR
Prof. Dr. Drini SALKO**

**DISERTANT
Denada BUSHI (HAFIZI), Msc**

Korrik, 2016

©Copyright
i
Denada BUSHI (HAFIZI)
2016

Udhëheqësi i Denada Bushi (Hafizi) vërteton se ky është version i miratuar i disertacionit të mëposhtëm:

**“AMVISIMI I RREZIKUT TË KREDISË NË BANKAT
TREGTARE NË KUADËR TË
IMPLEMENTIMIT TË BAZEL I/II”**

Prof.Dr.Drini SALKO

“AMVISIMI I RREZIKUT TË KREDISË NË BANKAT
TREGTARE NË KUADËR TË
IMPLEMENTIMIT TË BAZEL I/II”

Përgatitur nga Denada BUSHI (HAFIZI), MSc

Disertacion i paraqitur në

Fakultetin e Biznesit

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Në përputhje të plotë

me kërkesat

për Gradën “Doktor”

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Korrik, 2016

Dedikim!

“Për dy fëmijët e mi, bashkëshortin dhe prindërit e mi”!

Falenderime dhe Mirënjohje!

Me sinqeritetin më të lartë shpreh mirënjohje dhe falenderim për të gjithë Profesorët Shkollës së Doktoraturës të Universitetit “Aleksandër Moisiu” të cilët kanë dhënë kontributin e tyre përmes inkurajimit, mbështetjes dhe këshillave konstruktive gjatë gjithë ciklit akademik, duke kontribuar në rritjen time profesionale.

Falenderimi më i madh shkon për profesorin tim udhëheqës, i nderuari Prof.Dr. Drini Salko, që asnjëherë nuk u kursye të më japë këshillat profesionale shumë të nevojshme për finalizimin me sukses të këtij studimi.

Një mirënjohje e veçantë është për Drejtorin e BKT-Shkodër Z. Ylber Berhani që më dha shtysë, këshilla dhe mbështetje në çështje të veçanta të punimit.

Por, një tjetër falenderim shkon edhe për familjen time të cilët më kanë mbështetur në çdo moment të vështirë si edhe më kanë inkurajuar të vazhdoj rrugën time akademike.

Deklaratë mbi origjinalitetin

Denada Bushi (Hafizi)

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të shkruajtura nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat. Tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë edhe internetin, janë pranuar në mënyre eksplicite si të tilla.

Jam i/ e vetëdijshme/shme se në rast të mospërputhjeve, Këshilli i Profesorëve të UAMD-së është i ngarkuar të më revokojë gradën “Doktor”, që më është dhënë mbi bazën e kësaj teze, në përputhje me “Rregulloren e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë (Doktoratë) të UAMD-së, neni 33, miratuar prej Senatit Akademik të UAMD-së me Vendimin nr._____, datë _____.

Durrës, më _____

Firma

PËRMBLEDHJE

Sistemi bankar në Shqipëri, sikurse ndodh edhe në ekonomitë e vendeve të tjera në tranzicion, përbën bërthamën e sistemit financiar. Prandaj, rregullimi dhe funksionimi i tij siç duhet janë çështje me rëndësi mjaft të madhe në kuadrin e stabilitetit të sistemit financiar.

Të gjitha vendet kanë përmirësuar rregulloret e politikat e tyre bankare dhe ka një lëvizje të të gjithë sistemit bankar drejt marrëveshjeve të Bazel I/II. Që më 31 dhjetor 2014 ka hyrë në fuqi ligji për zbatimin e shtyllës së parë i Bazel II, ku minimumi i kërkuar i mjaftueshmërisë së kapitalit të jetë 12%, prandaj për bankat është e shumë e rëndësishme matja e ndikimit të rrezikut të kredisë, rrezikut të tregut dhe rrezikut operacional tek raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit.

Qëllimi i këtij studimi është të japë një pamje të përgjithshme të menaxhimit të rrezikut të kredisë nga këndvështrimi i Bazel I/II, për të matur ndikimin e rrezikut të kredisë, rrezikut të tregut dhe rrezikut operacional në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Ky studim është një përpjekje për të paraqitur ndikimin sasior të disa treguesve të veçantë mbi mjaftueshmërinë e kapitalit për sistemin bankar shqiptar bazuar në të dhënat 3-mujore për një periudhë kohore 11-vjeçare nga viti 2004-2014, të siguruar nga raportet statistikore të Bankës së Shqipërisë.

Qëllimi i studimit është arritur përmes një modeli të ndërtuar për matjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, duke marrë për bazë treguesit, faktorët, e rreziqet kryesore që ndikojnë në këtë tregues, ku vendin më të rëndësishëm e zë rreziku i kredisë dhe përmes një pyetësoi i cili konsiston në grup pyetjesh në lidhje me problematikat e brendshme dhe makroekonomike për veprimtarinë dhe rritjen e kredidhënies, për menaxhimin e rrezikut të kredisë dhe të klientëve me vonesa dhe për menaxhimin për rritjen e kredidhënies cilësore. Gjithashtu janë paraqitur disa konkluzione të ndara sipas secilës analizë dhe disa rekomandime të cilat i drejtohen institucioneve vendimarrëse me qëllim përmirësimin e nivelit të kredive me probleme dhe optimizimit të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas kërkesave të Bazel I/II.

Fjalët Kyçe: Mjaftueshmëria e kapitalit, Kreditë me probleme, Bazel, Interesi i kredisë, Papunësia

SUMMARY

The banking system in Albania, as happens in other emerging economies, is the core of the financial system. Therefore, the regulation and properly functioning are issues of great importance in the context of financial stability.

All countries have improved their regulations banking policies and there is a movement of the entire banking system towards Basel agreements I / II. Since December 31, 2014 entered into force the Law on the implementation of the first pillar of Basel II minimum required capital adequacy ratio is 12%, so for banks is very important to measure the impact of credit risk, market risk and operational risk in capital adequacy ratio.

For banks, it is more important to measure the impact of credit risk, market risk and operational risk in capital adequacy ratio. Since December 31, 2014 entered into force law on the implementation of the first pillar of Basel II to have the minimum required capital adequacy ratio of 12%. For banks, it is very important to measure the impact of credit risk, market risk and operational risk in capital adequacy ratio.

The purpose of this study is to provide an overview of credit risk management from the perspective of Basel I / II, to measure the impact of credit risk, market risk and operational risk in capital adequacy ratio. This study is an attempt to present the quantitative impact of some specific indicators of capital adequacy for the Albanian banking system based on data for a 3-month a 11-year period from 2004 to 2014, service provided by the statistical reports of the Bank of Albania.

The goal of the study is achieved through a model for measuring the capital adequacy ratio, taking into account the main indicators and main risks factors that affect this indicator, where the most important is credit risk;and through a questionnaire that consists on questions related to the issue of internal and macroeconomic operations used to increase lending, to manage credit risk to manage customer delays, and to increase the management quality lending. In the end, are some conclusions divided according to each analysis and recommendations addressed to decision makers in order to improve the level of non-performing loans and optimization of the capital adequacy ratio required by Basel I / II.

Keywords: CAR, NPL's, Basel, Interest Loan Rate, Unemployment

PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1 HYRJE DHE NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.....	14
HYRJA	14
1.1 KONTEKSTI DHE PËRMBLEDHJA E LITERATURËS	15
1.2 MARËVESHJA E BAZEL I, BAZEL II E BAZEL III DHE LIDHJA E TYRE ME RREZIKUN E KREDITIT.....	17
1.3 OBJEKTIVI, HIPOTEZAT DHE PYETJET KËRKIMORE	19
1.4 METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT	22
1.5 RËNDËSIA E STUDIMIT	23
1.6 KUFIZIMET E STUDIMIT	24
1.7 PROPOZIME PËR KËRKIME TË MËTEJSHME	24
1.8 STRUKTURIMI I PUNIMIT	24
KAPITULLI 2 RISHIKIMI I LITERATURËS	26
2.1 BAZEL I DHE SFIDAT E ZBATIMIT TË BAZEL II/III NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR.....	26
2.1.1 Bazel II, derivon nga Bazel I dhe është transformuar në Bazel III.....	28
2.1.2 Matja e Rrezikut të Kredisë	30
2.1.3 Matja e Rrezikut të Tregut.....	32
2.1.4 Matja e Rrezikut Operacional.....	33
2.2 REGJISTRI I KREDIVE, INSTRUMENT PËR AMVISIMIN E RREZIKUT TË KREDISË	33
2.3 VLERËSIMI I KOLATERALIT, INSTRUMENT PËR KTHIMIN E KREDIVE ME PROBLEME	34
2.4 KËRKIME TEORIKE TË TJERA.....	36
2.5 ASIMETRIA E INFORMACIONIT	41
2.6 LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR AMVISIMIN E RREZIKUT DHE MJAFTUESHMËRINË E KAPITALIT.....	42
2.7 SHPJEGIMI I VARIABLAVE.....	44
KAPITULLI 3 SISTEMI BANKAR NË VEND DHE PËRSHKRIMI I DISA MASAVE QË KANË NDËRMARRË BANKAT	52
3.1 ECURIA E NIVELIT TË KREDIVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR.....	52
3.2 ECURIA E PESHËS SË KREDITIMIT TË DISA SEKTORËVE KYÇ NË SISTEMIN BANKAR.....	52

3.3 ECURIA E NIVELIT TË DEPOZITAVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR.....	54
3.4 ECURIA E RAPORTIT TË MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT	55
3.5 ECURIA E NORMËS SË KREDIVE ME PROBLEME	56
3.6 ECURIA E RAPORTIT KREDI/DEPOZITA	57
3.7 ECURIA E RAPORTIT KREDI TOTALE/AKTIVE TOTALE.....	57
3.8 ECURIA E DY TREGUESVE TË PËRFITUESHMËRISË.....	58
3.9 PYETJET KËRKIMORE	60
KAPITULLI 4 METODOLOGJIA DHE ANALIZA E TË DHËNAVE	67
4.1 ANALIZA E REGRESIONIT	68
4.1.1 Modeli dhe variablat.....	69
4.1.2 Hipotezat.....	70
4.1.3 Testimi i hipotezave dhe interpretimi i rezultateve	72
4.1.4 Interpretimi grafik i modelit	82
4.1.4.1 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit-Kapitali Rregullator	82
4.1.4.2 Lidhja mes Raporti të Mjaftueshmërisë së Kapitalit- Kapitali Total/Aktive Totale	82
4.1.4.3 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit- Depozita Totale/Aktive Totale	83
4.1.4.4 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit- Aktive të Ponderuara/Aktive Totale.....	84
4.1.4.5 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit-Norma e Kredive me Probleme.....	84
4.1.4.6 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit- Norma e Papunësisë	85
4.1.4.7 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit- Norma mesatare e Inflacionit	86
4.1.4.8 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit-Norma mesatare e Interesit të Kredisë	86
4.1.4.9 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit-Kursi mesatar i Këmbimit Lekë/USD	87
4.2 ANALIZA E PYETËSORIT	88
4.2.1 Problematika që vështirësojnë kreditimin	88
4.2.2 Menaxhimi i klientit me vonesa	90
4.2.3 Masat për menaxhimin e rrezikut të kredisë.....	91

4.2.4 Masat për rritjen e kredidhënies cilësore	92
4.2.5 Ndikimi i ambientit të jashtëm në rritjen kredidhënies cilësore	94
4.3 KONKLUSIONE	96
KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME TË STUDIMIT	97
BIBLIOGRAFIA.....	105
APENDIKSE	113

LISTA E TABELAVE

Tabelë 1. Dallimet bazë mes Bazel II e Bazel III	19
Tabelë 2. Krahësimi i Bazel I me Bazel II.....	29
Tabelë 3. Llogaritja e Aktiveve të Ponderuara	45
Tabelë 4. Raportet dhe nivelet e kapitalit	46
Tabelë 5. Plani i masave për kreditë me probleme	59
Tabelë 6. Ndryshimet në legjislacion për implementimin e RMK	60
Tabelë 7. Rezultatet e para të modelit të regresionit.....	73
Tabelë 8. Rezultatet e modelit të saktë	74
Tabelë 9. Testi i formës funksionale për modelin.....	77
Tabelë 10. Testi i korrelacionit për modelin	78
Tabelë 11. Testi i heteroskedasticitetit për modelin	79
Tabelë 12. Përmbledhja e hipotezave të studimit	80
Tabelë 13. Problematika që vështirësojnë kreditimin e klientëve	88
Tabelë 14. Menaxhimi i klientit me vonesa.....	90
Tabelë 15. Masat për menaxhimin e rrezikut të kredisë	91
Tabelë 16. Masat për rritjen e kredidhënies cilësore	92
Tabelë 17. Ndikimi i ambientit të jashtëm në rritjen kredidhënies cilësore	94

LISTA E FIGURAVE

Figurë 1: Struktura e Bazel II.....	18
Figurë 1. Kuadri konceptual i punimit.....	20

Figurë 2. Ecuria e nivelit të kredive, 2007 – 2014 (në mln lekë)	52
Figurë 3. Pesha e sektorëve më të kredituar në sistemin bankar, 2007 – 2014 (në %).....	53
Figurë 4. Pesha e sektorëve më pak të kredituar në sistemin bankar 2007–2014(në%)...	54
Figurë 5. Ecuria e nivelit të depozitave, 2007 – 2014 (në mln lekë)	55
Figurë 6. Ecuria e Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit, 2004-2014 (në %).....	55
Figurë 7. Ecuria e Normës së Kredive me Probleme, 2004-2014 (në %).....	56
Figurë 8. Ecuria e Raportit Kredi/Depozita, 2004-2014 (në %)	57
Figurë 9. Ecuria e Raportit Kredi Totale/Aktive Totale, 2004-2014 (në %)	58
Figurë 10. Ecuria e dy treguesve të përfitueshmërisë, 2004-2014 (në %).....	58
Figurë 11. Ecuria e Normës së Kredive me Probleme, 1998-T I 2016 (në %).....	61
Figurë 12. Ecuria e Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit, 1998-T I 2016 (në %).....	62
Figurë 13. Dallimet mes Bazel II e Bazel III	64
Figurë 14. Paraqitja grafike e treguesve para dhe pas implemetimit të Bazel I/II.....	65
Figurë 15. Testi i normalitetit për modelin	77
Figurë 16. Ecuria e RMK - LnKapitali Rregullator	82
Figurë 17. Ecuria e RMK - Kapital Total/Aktive Totale	83
Figurë 18. Ecuria e RMK - Depozita Totale/Aktive Totale.....	83
Figurë 19. Ecuria e RMK - Aktive të Ponderuara/Aktive Totale	84
Figurë 20. Ecuria e RMK - Normës së Kredive me Probleme	85
Figurë 21. Ecuria e RMK - Norma e Papunësisë.....	85
Figurë 22. Ecuria e RMK - Norma mesatare e Inflacionit.....	86
Figurë 23. Ecuria e RMK - Norma mesatare e interesit të kredisë	87
Figurë 24. Ecuria e RMK - Kursi mesatar i Këmbimit Lekë/USD.....	87
Figurë 25. Problematika që vështirësojnë kreditimin e klientëve.....	88
Figurë 26. Menaxhimi i klientit me vonesa	90
Figurë 27. Masat për menaxhimin e rrezikut të kredisë.....	91
Figurë 28. Masat për rritjen e kredidhënies cilësore	93
Figurë 29. Ndikimi i ambientit të jashtëm në rritjen kredidhënies cilësore.....	95

Lista e shkurtimeve

RMK	Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
KRR	Kapitali Rregullator
KT/AT	Kapitali Total/Aktivët Totale
DT/AT	Depozita Totale/Aktivët Totale
AP/AT	Aktivët e Ponderuara/Aktivët Totale
NKP	Norma Kredive me Probleme
K/D	Kredi/Depozita
NK/AT	Kredi Totale/Aktivët Totale
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
P	Norma e Papunësisë
INF	Norma e Inflacionit
INT	Norma mesatare e Interesit të Kredisë
KMKeur	Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Euro
KMKusd	Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Usd
INSTAT	Instituti i Statistikës
BSH	Banka e Shqipërisë
ZRPP	Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
ME	Ministria e Ekonomisë
AAB	Shoqata e Bankave
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
ECAI	Institucione të Jashtme të Vlerësimit të Kredisë
PD	Probabiliteti i mospagimit të kredisë
LGD	Humbja e dhënë për dështim
EAD	Ekspozimi ndaj dështimit
M	Maturiteti

KAPITULLI 1 HYRJE DHE NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

HYRJA

Sistemi bankar në Shqipëri, sikurse ndodh edhe në ekonomitë e vendeve të tjera në tranzicion, përbën bërthamën e sistemit financiar. Prandaj, rregullimi dhe funksionimi i tij siç duhet janë çështje me rëndësi mjaft të madhe në kuadrin e stabilitetit të sistemit financiar. Sektori bankar shqiptar, i cili po vazhdon të zgjerohet e të konsolidohet, aktualisht përbëhet nga 16 banka. Gjatë kësaj periudhe, ky sektor ka shënuar rritje të numrit të degëve, ka përmirësuar produktet e tij ndaj publikut dhe ka rritur rolin e vet ndërmjetësues, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Gjithashtu, hyrja e grupeve të njohura bankare europiane është shoqëruar me konsolidim të industrisë bankare, dhe krijimin e një mjedisi më eficient e konkurrues. Prandaj, amvisimi i rrezikut ka shumë vlerë dhe nëse bankat nuk arrijnë të amvisojnë rrezikun e tyre, kostoja në shoqëri mund të jetë e lartë dhe impakti në ekonomi mund të jetë shkatërrues.

Nga ana tjetër, mbikëqyrja bankare e ushtruar nga Banka e Shqipërisë, ka si qëllim të adaptojë standartet më të mira ndërkombëtare në këtë fushë. Si rezultat, është vlerësuar se kuadri ligjor e rregullativ është përmirësuar në pajtim me objektivat për një zhvillim të qëndrueshëm e të shëndetshëm, dhe është udhëhequr nga standartet më të larta të përgjegjshmërisë, monitorimit, transparencës dhe qeverisjes së vetë sistemit bankar. Në këtë temë do të trajtohet një fenomen mjaft aktual dhe sigurisht i përshtatshëm për të krijuar një formim sa më të plotë mbi orientimin e bankave në realitetin e sotëm.

Ky studim, do të fokusohet fillimisht në aspektin teorik të rrezikut të kredisë në kuadër të amvisimit të tij nga bankat tregtare, në këndvështrimin e zbatimit të disa parimeve bazë të Bazel I/II dhe mbikëqyrjes nga Banka e Shqipërisë.

Zgjedhja e kësaj teme është ndikuar nga fakti se “ulja e rrezikut që shoqëron kredidhënien në sektorin bankar do të çojë në zhvillimin e rritjen e këtij sektori dhe të ekonomisë në vend”.

Të gjitha bankat janë duke investuar shumë në amvisimin e rrezikut të kredisë. Ky amvisim konsiston në monitorimin e kredive të dhëna dhe ristrukturimin e tyre në kushte të favorshme për bankën e klientin.

Kreditë me probleme marrin një rëndësi për vetë faktin se bankat vuajnë mungesën e likuiditetit si pasojë e rritjes së tyre, e shoqëruar kjo dhe me një rritje të tepruar asetesh (prona të ish debitorëve) të cilat ofrohen në treg me çmime shumë më të ulëta se vlera reale e tyre, të cilat gjithashtu përbëjnë kosto për bankat.

Gjithashtu, si pasojë e krizave të mëparshme, veçanërisht atë të vitit 2008, bankat janë më shumë të orientuara drejt uljes së kredive të këqija sesa drejt kredidhënies.

Efektet e krizës së vitit 2008 mbi kreditë janë shfaqur në këto drejtime kryesore:

- Zvogëlimi i volumit të kredive
- Shtrëngimi i kushteve të kreditimit
- Ulja e cilësisë së portofolit të kredive
- Rritja e rrezikut të moskthimit të kredive

- Rritja e rrezikut të kursit të këmbimit
- Përkeqësimi i cilësisë së kolateraleve

Nisur nga këto drejtime me qëllim uljen e kredive me probleme, mbrojtja nga rreziku i kredisë merr një rëndësi të veçantë për sistemin bankar.

Pyetjet kërkimore

Për të paraqitur efektin që ka pasur implementimi i disa parimeve të Bazel I/II tek rreziku i kredisë, duhet ti jepet përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

1. A është përmirësuar treguesi Normë e Kredive me Probleme pas fillimit të implementimit të kuadrit rregullator të Bazel I/II?
2. A është imoperativ implementimi i plotë i kuadrit rregullator Bazel II dhe projekcioni i Bazel III ?
3. A është përmirësuar treguesi Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit pas fillimit të implementimit të kuadrit rregullator të Bazel I dhe II ?
4. Si kanë ndikuar masat e ndërmarra nga bankat për të menaxhuar më mirë rrezikun e kredisë?

Qëllimi

Qëllimi i këtij punimi është të vlerësojë rrezikun e kredisë në sistemin bankar shqiptar në këndvështrimin e aplikimit të Bazel I e Bazel II dhe të evidentojë drejtimit kryesore të amvisimit të tij në të ardhmen.

1.1 KONTEKSTI DHE PËRMBLEDHJA E LITERATURËS

Për të dhënat dytësore është shfrytëzuar literatura bashkëkohore mbi rrezikun e kredisë, janë trajtuar teknikat kryesore bashkëkohore që përdoren sot në botë për menaxhimin e kredisë.

Janë shfrytëzuar raportet vjetore e statistikore të Bankës së Shqipërisë, të dhëna nga Ministria e Financave, INSTAT-i, progres raportet për Shqipërinë nga FMN, teknikat dhe metodat që përdorin bankat tregtare në amvisimin e rrezikut të kredisë, punime në këtë fushë të autorëve vendas dhe të huaj si dhe kërkimet në këtë fushë të Bankës së Shqipërisë.

Për të dhënat primare është shpërndarë një pyetësor i cili konsiston kryesisht në grup pyetjesh në lidhje me problematikat e brendshme dhe makroekonomike për veprimtarinë dhe rritjen e kredidhënies, grup pyetjesh pyetjesh në lidhje me masat e marra për menaxhimin e rrezikut të kredisë dhe të klientëve me vonesa, dhe grup pyetjesh në lidhje me masat e marra për menaxhimin e rritjen e kredidhënies cilësore.

Sipas Bessis (2003)¹, aktiviteti kryesor i bankave është dhënia e kredive të formave të ndryshme. Portofoli i kredive përbën klasën e aktivitetit kryesor si dhe burimin kryesor të bankës për të përfituar të ardhura. Kjo do ta bënte të pashmangshme shfaqjen e rrezikut, i cili rritet me rritjen e kredidhënies.

¹ J. Bessis, (2003), “Risk Management”

Veprime të huadhënies² quhen ato veprime nëpërmjet të cilave bankat përfitojnë mjetet financiare për plotësimin e nevojave të tyre.

Për bankat, shërbimi i huadhënies është një çështje e diskutueshme dhe e vështirë. Nga njëra anë, firmat ankohen për standarte të larta të vendosura nga bankat dhe nga ana tjetër bankat vuajnë humbje nga kreditë e këqija.

Dihet tashmë që kreditë janë aktivet më fitimprurëse të bankës. Fitimet e bankës nga dhënia e kredive vijnë si rezultat i :

- Interesit që duhet të paguajë kredimarrësi
- Komisionet e paguara nga ai

“Rreziku i kredisë”³ është pamundësia e kredimarrësit dhe e garantuesit ose e kundërpartisë për aktivet e tjera, për të përmbushur detyrimet ndaj bankës sipas kushteve të marëveshjes së lidhur mes tyre.”

- “Rreziku” nga këndvështrimi financiar përbën shmangien nga vlera e pritur e kthimit;
- “Rreziku” nga këndvështrimi bankar përbën kombinimin e probabilitetit të ndodhjes së një ngjarjeje me ndikim në një ngjarje tjetër.

Të dyja ngjarjet janë ngjarje probabilitare të ardhshme e të mundshme.

Kredidhënësi duhet të ketë aftësi për të nxjerrë jashtë loje huamarrësit jo kompetentë dhe jo të besueshëm. Prandaj, detyrë e bankës është të bëhet dallimi ndërmjet firmave/projekteve të mira dhe të këqija dhe karakterit të mirë dhe të keq të kredimarrësit që nënkupton ndershmërinë e kredimarrësit.

Gabimet që çojnë në krizë, lidhen gjithnjë me paaftësinë për të zbatuar parimet e amvisimit të rrezikut, sidomos lidhur me instrumentet novatore financiare, duke përfshirë këtu:

1. Uljen e standarteve të kreditimit;
2. Përqëndrime dramatike të rrezikut në sektorë të caktuar si ai i ndërtimit, i shtëpive e i kreditorëve nënstandart;
3. Moskryerja e analizave të duhura, kontrollin në regjistrin e kredive, etj.

Duhet pranuar se gjatë procesit të kredidhënies dallojmë tre situata⁴:

1. **Asimetria e informacionit** përbën një nga problemet kryesore me të cilat një bankë përballlet gjatë kreditimit, është i lidhur me rrezikun e kreditit, i cili si problem ka të bëjë me pamundësinë e bankës që të disponojë të njëjtin informacion që ka huamarrësi mbi kthimin e mundshëm dhe rrezikun e projektit.
2. **Situata e zgjedhjes së pafavorshme** ndodh kur huamarrësit me probleme, të cilët kanë projekte të dobëta ekonomike dhe me rrezik të lartë, janë të prirur të pranojnë kushte jo të favorshme të kredisë. Këta kreditorë, duke patur projekte me rrezik të lartë, janë të gatshëm të pranojnë norma të larta interesi sepse në rast se projekti finalizohet me sukses, ata do jenë të vetmit fitues.

² Frederic S. Mishkin, Stanley G. Eakins (fifth edition, 2006), “Financial Market & Institution”

³ Alan Shapiro, J. Willey dhe Sons, (1984), “Multinational Financial Management”, seventh edition Megginson, Trueblood, Ross, “Business”

⁴ Akerlof (G.) (1970): “The Market for Lemons: Quality Uncertainty and the Market Mechanism”, Quarterly Journal of Economics, August, fq. 488-500

3. **Situata e rrezikut moral** mund të evidentohet pasi huamarrësi të ketë marrë kredinë dhe lidhet me mundësinë e përfshirjes në veprimtari të papranueshme për huadhënësin. Asimetria e informacionit midis huamarrësit dhe huadhënësit krijon kushte për një situatë të tillë.

1.2 MARËVESHJA E BAZEL I, BAZEL II E BAZEL III DHE LIDHJA E TYRE ME RREZIKUN E KREDITIT

Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare përbën një organizëm për bashkëpunim me qëllim përmirësimin e mbikëqyrjes botërore bankare. Ky Komitet ka ndërtuar disa parime e rregulla të cilat bankat janë të detyruara ti zbatojnë.

Disa prej bankave më të mëdha në vend, kanë filluar të adaptojnë dhe të bëjnë një riorganizim të plotë të njësive drejtuese për menaxhimin e rrezikut bankar sipas parimeve themelore të Bazel II, të shkëputura nga strukturat e tjera operacionale të bankës.

Bazel I⁵ përbën një grumbull rregullash ndërkombëtare bankare mbi mbikëqyrjen bankare të cilat u publikuan në vitin 1988. Bazel I⁶ hyri në fuqi në vitin 1988 dhe fokusi i saj ishte tek rreziku i kredisë, duke krijuar një sistem të klasifikimit të aseteve në 0%, 20%, 50% e 100%, si dhe i detyronte bankat që të mbanin një shumë minimale prej 8% të kapitalit të mbajtur, bazuar në 1% të aseteve të ponderuara me rrezikun. Bazel I⁷ përcaktoi dy standarte minimale për pranueshmërinë e kapitalit adekuat të kërkuar: 1.Rreziku bazuar në raportin e kapitalit dhe 2.Aktivet ndaj shumëfishit të kapitalit. Implementimi i Bazel I, krahas arritjeve që solli, u shoqërua dhe me shumë kritika për arsye se përfshinte në kategori të njëjta të përbashkëta, të gjitha llojet e rreziqeve individuale, pa bërë diferencim në llojin dhe cilësinë e kredimarrësit. Pra, ai kërkonte përqindje të njëjtë kapitali si për bankat e vogla dhe për bankat e mëdha.

Bazel II⁸, u botua në vitin 2004, hyri në fuqi me 01.01.2008, dhe lindi si nevojë për të përballuar sfidat e reja të produkteve financiare, avancimit të teknologjisë së komunikimit dhe teknikave të menaxhimit të rrezikut. Bazel II, shërben për të kontrolluar vëllimin e kapitalit që bankat duhet të lënë mënjanë për tu mbrojtur kundër rreziqeve të mundshme financiare dhe operacionale. Këtu, kreditë me probleme kategorizohen në disa mënyra, në varësi të shkallës së problematikës që paraqesin. Bazel II lidh mbikëqyrjen bankare me menaxhimin e rrezikut nga vetë bankat, duke nxitur në këtë mënyrë fuqizimin e sistemit të menaxhimit nga bankat. Në krahasim me Bazel I, Bazel II ofroi më shumë instrumenta zbutës të rrezikut, por gjithashtu solli edhe rritjen e kërkesës për kapital minimal të bankave nga 8% në 12%, me qëllim mbulimin e humbjeve të papritura nga rreziku i kredisë, rreziku i tregut dhe rreziku operacional.

Struktura e Bazel II ngrihet mbi tre shtylla:

1. Nevoja për kapital
2. Mbikëqyrja

⁵ KPMG, Basel II: A Worldwide Challenge for the Banking Business, fq.12

⁶ WIFO, Capital Requirements for Banks (Basel II), "The new Basel Capital Accord (Basel II) from a Macroeconomic Point of View" fq. 52

⁷ Basel II (2006): International Convergence of Capital Measurement and Capital Standards, A Revised Framework Version


⁸ Franz, Basel II: A Worldwide Challenge for the Banking Business, fq.4

3. Disiplina e tregut

Sipas Bazel II, propozohen tre metoda për llogaritjen e nevojave minimale për kapital të nevojshëm për të mbuluar rrezikun e kredisë:

1. Metoda e Standartizuar
2. Metoda Bazë e Vlerësimit të Brendshëm (IRB)
3. Metoda e Avancuar e Vlerësimit të Brendshëm

Figurë 1: Struktura e Bazel II



Burimi : Bank for International Settlement (2011)

Bazel III⁹, u publikua në vitin 2011 si një përmbledhje standartesh që zëvendësojnë Bazel II. Bazel III vendosi detyrime më strikte mbi mjaftueshmërinë e kapitalit bankar dhe për herë të parë vendosi detyrime mbi likuiditetin. Gjithashtu, përcaktoi detyrimet minimale që duhet të ndjekin bankat dhe secili shtet ka të drejtë të vendosë detyrime për implementimin e tij. Sipas tij, bankat duhet të rrisin cilësinë e sasinë e kapitalit duke shtrënguar kushtet se çfarë mund të klasifikohet si kapital dhe duke rritur raportin e detyruar të këtij kapitali kundrejt aktiveve totale të ponderuara me rrezikun.

Përkufizimet për kapitalin sipas Bazel III janë:

Kapitali Tier I përbën kapitalin themeltar të një banke (kapitali aksioner + fitimi i pashpërndarë). Tatimi i shtyrë aktiv dhe interesat jokontrrolluese nuk njihen si pjesë e kapitalit nga Bazel III siç njiheshin nga Bazel II.

Kapitali Tier II përbën kapitalin dytësor (më pak cilësor) dhe përfshin rezervat e paraportuara, rezervat e përgjithshme, borxhin e varur (subordinuar) dhe kapitalin “hibrid”. Kapitali hibrid ka disa cilësi të borxhit.

⁹ KPMG, Basel II: A Worldwide Challenge for the Banking Business, fq.4

Kapitali total përbën shumën e kapital Tier I dhe Tier II. Kapitali Tier II nuk mund të jetë më i madh se kapital Tier I, pra të paktën 50% e kapitalit total të një banke duhet të jetë kapital Tier I.

Minimumi i detyruar i kapitalit për një bankë është raporti i kapitalit me aktivet totale të ponderuara me rrezikun sipas Bazel II e Bazel III.

Tabela e mëposhtme përbën dallimet bazë mes Bazel II e Bazel III:

Tabelë 1. Dallimet bazë mes Bazel II e Bazel III

Kërkesat	Sipas Bazel II	Sipas Bazel III
Raporti minimal i kapitalit total kundrejt Aseteve të Ponderuara me Rrezikun	8%	10.50%
Raporti minimal i Kapitalit Aksioner kundrejt Aseteve të Ponderuara me Rrezikun	2%	4.50% - 7.00%
Kapitali Tier I kundrejt Aseteve të Ponderuara me Rrezikun	4%	6.00%
Kapitali bazë Tier I kundrejt Aseteve të Ponderuara me Rrezikun	2%	5.00%
Mbulimi me kapitalin rezervë kundrejt Aseteve të Ponderuara me Rrezikun	-	2.50%
Raporti i borxhit	-	3.00%

Burimi : Bank for International Settlement (2005)

1.3 OBJEKTIVI, HIPOTEZAT DHE PYETJET KËRKIMORE

Objektivi kryesor:

Vlerësimi i rrezikut të kredisë, veprimtarisë kredidhënëse të bankave dhe amvisimit të rrezikut të kredisë pas implementimit të disa parimeve të Bazel I/II.


Objektiva të tjerë:

1. Një vështrim teorik mbi implementimin e parimeve bazë të Bazel I, Bazel II në Sistemin Bankar Shqiptar si dhe projektionit të aplikimit të Bazel III.
2. Analizë e tregut të kredidhënies nga bankat tregtare gjatë dekadës së fundit dhe ndikimit të krizës ekonomiko-financiare në aktivitetin kredidhënies.

Dimë që Bazel II përbën një ligj ndërkombëtar për kapitalin rregullator, dhe kërkon që ky kapital të marrë në konsideratë edhe rreziqet me të cilët përballet sistemi bankar, duke nxitur përdorimin e teknikave për amvisimin e rrezikut sistematik dhe në veçanti për amvisimin e rrezikut të kredisë si rreziku më i madh për sistemin bankar.

Rreziku i kredisë i parë nga këndvështrimi i Bazel I/II, do të thotë me fjalë të tjera se duhet të studiohet nga këndvështrimi i mjaftueshmërisë së kapitalit.

Figurë 2. Kuadri konceptual i punimit



Burimi: BCBS (2004)

Nisur nga formula bazë e ofruar nga Bazel II në lidhje me raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, janë marrë në studim variablat të cilët përfaqësojnë më mirë kapitalin total, treguesit që shprehin sinjale për rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional.

Ky model merr një rëndësi të veçantë sepse që më 31 dhjetor 2014 ka hyrë në fuqi rregullorja e re¹⁰ e mjaftueshmërisë së kapitalit sipas Bazel II, i cili duhet të jetë minimumi 12%. Prandaj dhe niveli i lartë i menaxhimit të çdo banke që operon në vend duhet të ketë një model tip që i lehtëson matjen e mjaftueshmërisë së kapitalit që duhet rezervuar për të tre rreziqet e mësipërme, e në të njëjtën mënyrë lejon që fitimet e mbajtura si pjesë e kapitalit të mos sakrifikohen që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të mos bjerë nën 12%.

Për të arritur këto objektiva janë shtruar pyetjet kërkimore, është ndërtuar një model për matjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, duke marrë për bazë tre rreziqet kryesore që ndikojnë në këtë tregues, ku vendin më të rëndësishëm e zë rreziku i kredisë, dhe përmes një pyetësi i cili konsiston në grup pyetjesh në lidhje me problematikat e brendshme dhe makroekonomike për veprimtarinë e kredidhënies; grup pyetjesh në lidhje me masat e marra për amvisimin e rrezikut të kredisë dhe të klientëve me vonesa; grup pyetjesh në lidhje me masat e marra për menaxhimin për rritjen e kredidhënies cilësore.

Ky model, do ndihmojë në identifikimin dhe vlerësimin mjaftueshmërisë së kapitalit duke vlerësuar nivelin e kapitalit rregullator, nivelin e rrezikut të kredisë, rrezikut të tregut dhe rrezikut operacional për të gjithë sistemin bankar shqiptar.

¹⁰ Banka e Shqipërisë, Rregullorja “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” (miratuar me vendimin nr. 48, datë 31.07.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë), e cila përaftron më tej kuadrin rregullativ me Direktivën Evropiane 2006/48/EC mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe direktivën 2006/49/EC mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të institucioneve të kreditit dhe të shoqërive të investimit, si dhe akordin e kapitalit - Bazel II

Hipotezat:

Hipotezat që do shtrohen në këtë punim janë:

H0.1: Kapitali rregullator nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.1: Kapitali rregullator ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.2: Raporti Kapitali Total/Aktive Totale nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.2: Raporti Kapitali Total/Aktive Totale ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.3: Raporti Depozita Totale/Aktive Totale nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.3: Raporti Depozita Totale/Aktive Totale ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.4: Raporti Aktivitet e Ponderuara/Aktivitet Totale nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.4: Raporti Aktivitet e Ponderuara/Aktivitet Totale ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.5: Norma e Kredive me Probleme nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.5: Norma e Kredive me Probleme ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.6: Raporti Kredi/Depozita nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.6: Raporti Kredi/Depozita ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.7: Raporti Kredi Totale/Aktive Totale nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.7: Raporti Kredi Totale/Aktive Totale ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.8: Norma e Produktit të Brendshëm Bruto nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.8: Norma e Produktit të Brendshëm Bruto ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.9: Norma e papunësisë nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.9: Norma e papunësisë ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.10: Norma mesatare e inflacionit nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.10: Norma mesatare e inflacionit ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.11: Norma mesatare e interesit të kredisë nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.11: Norma mesatare e interesit të kredisë ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.12: Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Euro nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.12: Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Euro ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.13: Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Usd nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.13: Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Usd ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

1.4 METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT

Metodologjia e aplikuar në këtë studim përbëhet nga një bazë të dhënash reale të sistemit bankar në Shqipëri, të siguruara përmes raporteve vjetore e statistikore të Bankës së Shqipërisë, të dhënave nga Ministria e Financave, INSTAT-i, progres raporteve për Shqipërinë nga FMN, teknikave dhe metodave që përdorin bankat tregtare në amvisimin e rrezikut të kredisë, punimeve në këtë fushë të autorëve vendas dhe të huaj si dhe kërkimeve në këtë fushë të Autoritetit Monetar (BSH).

Përpunimi i këtyre të dhënave do të bëhet në bazë të metodave sasiore dhe statistikore që konvergjojnë me metodikat e reja që propozohen. Këto të dhëna dytësore janë siguruar për një hark kohor 11- vjeçar nga viti 2004-2014, dhe është bërë një analizë e të gjithë variablave të modelit të regresionit për sistemin bankar në Shqipëri.

Për të dhënat primare është shpërndarë një pyetësor i cili konsiston kryesisht në grup pyetjesh në lidhje me problematikat e brendshme dhe makroekonomike për veprimtarinë dhe rritjen e kredidhënies, grup pyetjesh në lidhje me masat e marra për menaxhimin e rrezikut të kredisë dhe të klientëve me vonesa, grup pyetjesh në lidhje me masat e marra për menaxhimin për rritjen e kredidhënies cilësore.

Nga analizimi i të dhënave përmes modelit të regresionit dhe pyetësorit do të nxjerrim përfundimin nëse është përmirësuar amvisimi i rrezikut të kredisë në kuadër të

implementimit të disa rregullave të Bazël I/II, apo ka mbetur në të njëjtat nivele që ishte edhe para implementimit të tyre.

Modeli i regresionit për sistemin bankar në Shqipëri me variabël të varur raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit është si më poshtë:

Variabli i varur:

RMK Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Variablat e pavarur:

LnKRR Logaritmi natyror i Kapitalit Rregulator

KT/AT Kapitali Total/Aktivet Totale

DT/A Depozita Totale/Aktivet Totale

AP/AT Aktivët e Ponderuara/Aktivet Totale

NKP Norma Kredive me Probleme

K/D Kredi/Depozita

NK/AT Kredi Totale/Aktivet Totale

LnPBB Logaritmi natyror i Produktit të Brendshëm Bruto

P Norma e Papunësisë

INF Norma e Inflacionit

INT Norma mesatare e Interesit të Kredisë

LnKMKeuro Logaritmi natyror i Kursit mesatar të këmbimit Lekë/Euro

LnKMKusd Logaritmi natyror i Kursit mesatar të këmbimit Lekë/Usd

Përmes modeleve do shohim se cili nga këto ka ndikimin më të madh. Në këtë mënyrë, për faktorët me ndikim më të madh, do propozohen rregullore e kritere për të minimizuar ndikimin e tyre.

1.5 RËNDËSIA E STUDIMIT

Sistemi bankar në Shqipëri, sikurse ndodh edhe në ekonomitë e vendeve të tjera në tranzicion, përbën bërthamën e sistemit financiar. Prandaj, rregullimi dhe funksionimi i tij siç duhet janë çështje me rëndësi mjaft të madhe në kuadrin e stabilitetit të sistemit financiar. Duke qënë se edhe gama e produkteve e shërbimeve është rritur shumë, gjithashtu ato janë përballë llojeve të ndryshme të rreziqeve financiare.

Qëllimi i këtij punimi është të vlerësojë rrezikun e kredisë në sistemin bankar shqiptar në këndvështrimin e aplikimit të Bazël I dhe II dhe të evidentojë drejtimet kryesore të amvisimit të tij në të ardhmen.

Ky punim merr rëndësi për arsyet e mëposhtme:

1. Identifikon vështirësitë që kanë bankat e nivelit të dytë në implementimin e rregullores së re për mjaftueshmërinë e kapitalit;
2. Vlerëson dhe teston lidhjen e rrezikut të kredisë, rrezikut të tregut, rrezikut operacional dhe kapitalit rregulator me raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit;
3. Jepen disa rekomandime të cilat, nëse zbatohen nga autoriteti përkatës, sistemi bankar do rritet edhe më shumë, duke krijuar stabilitet të sistemit financiar në vend, e për rrjedhojë zhvillimin ekonomik në vend;
4. Paraqet ndikimin tek norma e kredive me probleme dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit implementimi i Bazël I e Bazël II;

5. Paraqet masat që përdorin bankat e nivelit të dytë për të menaxhuar rrezikun e kredisë;
6. Mund të përdoret nga studiues të tjerë për studime të mëtejshme në këtë fushë.

1.6 KUFIZIMET E STUDIMIT

Ky studim ka disa kufizime që vijnë nga faktorë të ndryshëm si:

1. Mungesa e të dhënave cilësore, mund të shikohet si një kufizim i mundshëm i modelit, por përjashtimi i tyre është bërë sepse në këndvështrime të ndryshme kanë interpretime të ndryshme dhe ato lënë vend për subjektivizëm.
2. Mungesa e një raportimi në formën e serive kohore në lidhje me kolaterale të kanë shkaktuar rritjen e kredive me probleme, bën që përfshirja e këtij variabli të mos jetë e mundur. Prandaj ai është përfshirë vetëm tek pyetësori.
3. Të dhënat janë në bazë tremujore dhe vetëm për periudhën 2004-2014, dhe duke qënë se ligji për zbatimin e Bazeli II për mjaftueshmërinë e kapitalit ka hyrë në fuqi me datë 31.12.2014, datë kjo që përjashton periudhën e studimit, e bën që një matje më e saktë e uljes së kredive me probleme nga këndvështrimi i Bazeli II do rezultojë pas vitit 2016-2017, pra pas një periudhe kohe të hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Nga ana tjetër është përjashtuar viti 2015 sepse në shtator të këtij viti ishte fushata anti-informalitet e ndërmarrë nga qeveria, e cila ka dhënë impaktin e vet në shumë tregues, dhe kjo do sillte një deformim të analizës.
4. Disa nga pyetësorët e shpërndarë nuk janë plotësuar e disa të tjerë janë plotësuar në mënyrë jo të plotë, duke ndikuar kështu në saktësinë e rezultateve. Gjithashtu, kjo analizë bazohet tek përgjigjet e tyre të cilat janë subjektive sepse secili drejtues/specialist i ka plotësuar sipas politikës së bankës së vet.
5. Në studim nuk është përfshirë rreziku politik e rreziku ligjor të cilët përbëjnë rreziqe të rëndësishme për sistemin bankar. Këto tregues janë përjashtuar sepse teknikisht nuk mund të mateshin dhe se dilni nga tema e punimit meqënëse rreziku i kredisë duhej analizuar nga këndvështrimi i Bazeli I/II.

1.7 PROPOZIME PËR KËRKIME TË MËTEJSHME

Ky studim, u përpoq të plotësonte qëllimin dhe objektivat e tij. Natyrisht, duke pasur paraqysh kufizimet që u parashtruan më lart, kryesisht kufizimi në lidhje me periudhën e hyrjes në fuqi të rregullores së re për mjaftueshmërinë e kapitalit më datë 31.12.2014, periudhë kjo që përjashtohet nga studimi sepse është shumë shpejt matja e efekteve të saj, prandaj, pas 2-3 vitesh do jetë më i saktë e më i matshëm ndikimi i rregulloreve të Bazelit mbi rrezikun e kredisë dhe rreziqet e tjera. Gjithashtu, të dhënat nga analiza e pyetësorit mund të përpunohen edhe më tej duke i marrë si mesatare të sistemit për të krahasuar secilën grup banke G1, G2 dhe G3.

1.8 STRUKTURIMI I PUNIMIT

Struktura e këtij punimi përmban katër kapituj:

Kapitulli nr 1: Ky kapitull titullohet *“Hyrje dhe një vështrim i përgjithshëm”*, dhe do prezantojë çështjet kryesore që përbëjnë bazën e këtij studimi. Në këtë pjesë të punimit,

prezantohen objektivat e studimit, problemi i studimit, hipotezat e studimit që do të testohen, rëndësia e studimit dhe kufizimet e studimit.

Kapitulli nr 2: Ky kapitull titullohet “*Rishikimi i literaturës*” dhe do trajtojë të gjithë bazën e nevojshme teorike në lidhje me këtë studim. Këtu do prezantohet një përshkrim i masave të Bazel I/II/III, i masave që kanë ndërmarrë bankat e nivelit të dytë për plotësimin e kushteve sipas kërkesave të Bazel I/II/III, dhe faktorëve kyç që janë dhe ndikojnë në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, duke marrë rëndësi të veçantë për rrezikun që shoqëron kredidhënien, që përbëjnë elementin kyç të studimit.

Kapitulli nr 3: Ky kapitull titullohet “*Sistemi bankar në vend dhe përshkrimi i disa masave që kanë ndërmarrë bankat*”, këtu do të paraqitet një panoramë e ecursisë së treguesve kyç të sistemit bankar.

Kapitulli nr 4: Ky kapitull titullohet “*Metodologjia dhe analiza e të dhënave*”, dhe do prezantojë dy analiza: 1. Përmes modelit të regresionit të shumëfishtë linear duke prezantuar metodologjinë e përdorur për të mbledhur të dhënat e studimit si dhe për të testuar hipotezat e studimit, treguesit statistikorë të përdorur për të realizuar këtë studim duke prezantuar modelin e zgjedhur për realizimin e studimit; 2. Përmes pyetësorit i cili konsiston në grup pyetjesh në lidhje me problematikat e brendshme dhe makroekonomike për veprimtarinë dhe rritjen e kredidhënies, grup pyetjesh për menaxhimin e rrezikut të kredisë dhe të klientëve me vonesa dhe grup pyetjesh për menaxhimin për rritjen e kredidhënies cilësore. Në përfundim do të bëhet një analizë e hollësishme dhe interpretim i të gjitha të dhënave të mbledhura.

Në fund do paraqiten Konkluzione dhe Rekomandime për studime në të ardhmen, këtu do të tregohen të gjitha përfundimet e studimit, diskutimet, sugjerimet me efekte në të ardhmen për amvisimin e rrezikut të kredisë në kuadër të zbatimeve të parimeve bazë të Bazelit.

KAPITULLI 2 RISHIKIMI I LITERATURËS

Banka përfaqëson institucionin më të specializuar që merret me tregtimin e kapitalit para dhe që kryen funksione të rëndësishme ekonomike (Zaho dhe Salko 2000)¹¹. Vitet e fundit e gjithë vëmendja është orientuar drejt gjetjes së metodave për uljen e kredive me probleme, në mënyrë që kjo e fundit të mos çojë sistemin bankar në faliment e për rrjedhojë edhe uljen e ekonomisë në përgjithësi.

Aktualisht e gjithë vëmendja e ekspertëve financiarë është e përqëndruar drejt sektorit bankar, duke marrë shkas nga kriza e vitit 2007-2008 dhe nga kriza që po kalon shteti Grek së fundmi.

Përveç zhvillimeve pozitive, tranzicioni i tejzgjatur shqiptar ka qënë i shoqëruar edhe me dukuri negative të tilla si: papunësi e lartë dhe e vazhdueshme, korrupsion, institucione të dobëta dhe treg pjesërisht të lirë¹².

Analiza për pavarësinë e këshillit drejtues të bankave tregon se pavarësisht kërkesave ligjore të një standardi të lartë, ka hapësira për një rol më aktiv të autoritetit rregullator bankar shqiptar, në lidhje me zbatimin e këtyre kërkesave, në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Bazelit dhe Bashkimit Evropian Autoriteti Mbikëqyrës i veprimtarisë bankare në Shqipëri e përcepton qeverisjen e shëndoshë të bankave si një burim endogjen për stabilitetin financiar, besimin e publikut dhe mbrojtjen e konsumatorit. Angazhimi i tij është materializuar vazhdimisht në një gamë të gjerë veprimtarish rregullatore bankare gjatë dhe pas krizës financiare.¹³

2.1 BAZEL I DHE SFIDAT E ZBATIMIT TË BAZEL II/III NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare¹⁴ është një komitet i Autoriteteve të Mbikëqyrjes Bankare, që u themelua në vitin 1975 nga guvernatorët e bankave qëndrore të Grupit të G-10-ës.

Komiteti i Bazelit drejton aspektet më të rëndësishme të mbikëqyrjes bankare dhe shërben si orientim për mbikëqyrësit kombëtar dhe është një urë lidhëse për organizatat ndërkombëtare si FMN, Banka Botërore, etj..

Banka për Marrëdhëniet Ndërkombëtare (BIS)¹⁵ në Bazel është në pronësi të bankave qëndrore dhe ofron shërbime për këto banka. Ajo shërben si vendi ku zhvillohen kongreset e Komitetit të Bazelit dhe nuk merr pjesë në hartimin e parimeve të Komitetit të Bazelit-it. Ato japin direktiva e politika që mbikëqyrësit e çdo vendi ti përdorin për të vendosur politikat e mbikëqyrjes që aplikojnë në vendet e tyre.

Në vitin 1988, Komiteti i Bazelit prezantoi marrëveshjen kryesore e cila siguronte një opsion për matjen e kapitalit të bankave me aktivitet ndërkombëtar. Kjo marrëveshje

¹¹ Lavdosh Zaho dhe Drini Salko (2000): "Teknika Bankare", fq.1

¹² B.SH.Kuadri ligjor dhe praktika e qeverisjes së korporatave në sektorin bankar shqiptar 06 (65) 2013, Roden Pajaj - Rezart Ferzaj

¹³ Kuadri ligjor dhe praktika e qeverisjes së korporatave në sektorin bankar shqiptar 06 (65) 2013, Roden Pajaj - Rezart Ferzaj

¹⁴ BSH, Marrëveshja Themelore, material shpjegues, (2007), fq. 7

¹⁵ KPMG, Basel II: A Worldwide Challenge for the Banking Business, fq.12

fokusohej në shumën totale të kapitalit të bankës, i cili është shumë i rëndësishëm në reduktimin e rrezikut të paaftësisë paguese të bankës dhe kostove të mundshme nga dështimi i bankës në mbledhjen e depozitave. Studiues të ndryshëm, kanë shprehur mendime pozitive e negative në lidhje me zbatimin e kësaj marëveshjeje. Sipas Adamati-DeMarzo-Hellwing (2010)¹⁶, zbatimi i marëveshjes me kërkesat më të larta mbi kapitalin do ndikojë në: 1. krijimin e sistemit financiar të shëndoshë nëpërmjet uljes së rrezikut të falimentimit të bankave; 2. uljen e rrezikut sistematik, dhe 3. si rezultat i eliminimit të rrezikut moral do të ketë kosto sociale më të ulët. Nga ana tjetër, BIS (2010) dhe Angelini (2011)¹⁷ mendojnë se kërkesat e larta mbi kapitalin do të ndikojnë në rritjen e kostos së financimit për bankat, financim ky që është më i shtrejtë se sa financimet e huazuara, të cilat do të ndikojnë në: 1. ngadalësimin e rritjes së kredive të lejuara duke ndikuar në uljen e zhvillimit ekonomik, 2. në rënien e përfitueshmërisë, nëpërmjet zvogëlimit të fitimeve të pashpërndara dhe 3. eliminimit të mundësive për zgjerimin e operacioneve bankare në të ardhmen.

Në vitin 1996¹⁸ u prezantua një amendament i cili fokusohej tek rreziqet tregtare, dhe ai për herë të parë u lejonte disa bankave që të përdornin sistemet e tyre për të matur rreziqet e tregut.

Në vitin 1999¹⁹, Komiteti publikoi një propozim për të zëvendësuar marëveshjen e vitit 1988 me një tjetër më të ndjeshme ndaj rrezikut, dhe në vitin 2001 propozoi versionin e ri, i cili filloi aplikimin në vitin 2004. Marëveshja e re (2001), jepte një spektër të rrugëve nga metodologjitë më të thjeshta deri tek ato më të avancuarat për matjen e rrezikut të kredisë, rrezikut operacional dhe vendosjen e nivelit të kapitalit. Marëveshja e re ndërton modele për matjen më të saktë të rrezikut dhe të ruajtjes së nivelin e përgjithshëm të kapitalit rregullator. Kërkesat për kapital në varësi të rrezikut do të lejojnë bankat që të menaxhojnë në mënyrë më efikente bizneset e tyre.

Marëveshja e Bazel II është më komplekse se versioni i vjetër, por ofron një numër mundësish për bankat që të përdorin metodologji më analitike dhe më të ndjeshme ndaj rrezikut. Kjo kërkon më shumë detaje në aplikim dhe një rregullore më të plotë.

Bazel II, përbën një kornizë të gjerë standardesh rregullative të cilat kanë për qëllim përcaktimin e rregullave që duhet të ndjekin bankat në lidhje me kërkesat për kapital si dhe mënyrën e mbikëqyrjes nga ana e autoriteteve mbikëqyrëse. Implementimi i Bazel II, vjen si një kërkesë e domosdoshme në kushtet e zhvillimit të vazhdueshëm të sistemit bankar dhe globalizimit të këtij sistemi. Këto standarte përbëjnë një bazë të sigurtë për trajtimin në të njëjtën mënyrë të rrezikut dhe të ndihmojnë në rritjen e stabilitetit në shkallë botërore.

¹⁶ Admati, A. R., DeMarzo, P. M., Hellwig, M. F., & Pfleiderer, P. (2011): Fallacies, Irrelevant Facts, and Myths in the Discussion of Capital Regulation: Why Bank Equity is not expensive. Rock Center for Corporate Governance at Stanford University Working Paper No. 86

¹⁷ Angelini, P., Clerc, L., Curdia, V., Gambacorta, L., Gerali, A., Locarno, A., et al. (2011): BASEL III: Long-term impact on economic performance and fluctuations. BIS Working Papers No 338, Bank for International Settlements. Balance Sheet, Vol. 9(3), fq. 24-7

¹⁸ Fernando Carvalho, (2005), Basel II: A Critical Assessment, fq. 3

¹⁹ Fernando Carvalho, (2005), Basel II: A Critical Assessment, fq. 4

Autoritetet mbikëqyrëse të çdo vendi kanë mundësi të kenë një standart, ta modifikojnë dhe ta përshtasin me kuadrin e tyre rregullativ pa prekur thelbin e standarteve, duke inkurajuar përmirësimin e praktikave të menaxhimit.

2.1.1 Bazel II, derivon nga Bazel I dhe është transformuar në Bazel III

Korniza e Bazelit në Shqipëri ka filluar të integrohet në kuadrin rregullator të vendit në vitin 1999, kryesisht mbi rregulloret për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, kjo në një formë të thjeshtuar dhe të modifikuar për t'iu përshtatur nivelit të zhvillimit të sistemit bankar në vend. Përgatitje tjetër për Bazel II, ishte dhe detyrimi i të gjitha bankave rezidente në Shqipëri për raportimet sipas Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar që nga 1 janari 2009.

Raporti minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 8%, dhe tashmë që nga 31 dhjetor 2014 ky raport është jo më pak se 12%, e cila për vendin tonë mund të reflektojë një orientim më të madh në menaxhimin e rrezikut nga Banka e Shqipërisë. Duke pasur parasysh që bankat në Shqipëri e mbështesin aktivitetin e tyre në kredi për individët, bizneset, letra me vlerë të qeverisë qendrore dhe vendosje me bankat, Bazel I siguron një shkallë të mirë të kapitalizimit të bankave, pa cënuar rritjen dhe zhvillimin e aktivitetit bankar.

Duke qënë se aktiviteti bankar është gjithnjë në zhvillim, bankat tashmë janë pjesë e grupeve ndërkombëtare dhe nevoja për një menaxhim më të madh të rrezikut, bëri që Banka e Shqipërisë të krijojë kushtet për adaptimin e kuadrit rregullator mbi kërkesat për kapital me kornizën e Bazel II, në një formë më të thjeshtuar dhe në përputhje me nivelin e zhvillimit të sistemit bankar.

Banka e Shqipërisë në vitin 2013 publikoi versionin e parë të rikonceptuar të mjaftueshmërisë së kapitalit. Rregullorja ka hyrë në fuqi me 31 dhjetor 2014 dhe raportimi i parë sipas metodës së re është kryer në tremujorin e parë të vitit 2015, ku raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është vendosur 12%. Fokusi kryesor i bankave të nivelit të dytë ishte përgatitja për të shtuar kapitalin ose për të ulur nivelin e aktiveve në rrezik nga bilanci, për të qënë në nivelin e kërkuar për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit prej 12%.

Më konkretisht rregullorja e re²⁰ konsistonte në:

- *Në lidhje me rrezikun e kredisë:*
 1. Grupimin e zërave brenda dhe jashtë bilancit në një numër më të madh klasash ekspozimi, duke u bazuar në tipin e klientit, mbulimin me kolateral, etj...ku secila klasë ka rregullat dhe parimet specifike mbi mënyrën se si përcaktohen për çdo ekspozim faktorët e rrezikut;
 2. Për disa nga klasat, mënyra e vlerësimit të rrezikut u ndryshua, bazuar në faktin se vendi konsiderohej i zhvilluar dhe merrte automatikisht një vlerësim pozitiv nga ana e

²⁰ Banka e Shqipërisë, Rregullorja “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” (miratuar me vendimin nr. 48, datë 31.07.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë), e cila përafron më tej kuadrin rregullativ me Direktivën Evropiane 2006/48/EC mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe direktivën 2006/49/EC mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të institucioneve të kreditit dhe të shoqërive të investimit, si dhe akordin e kapitalit - Bazel II

rrezikut, drejt konceptimit të vlerësimit të kredisë (credit rating) përmes ECAI (Institucioni i Jashtëm i Vlerësimit të Kredisë);

3. Prezantimi i parimeve dhe metodave për njohjen e teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë;
 4. Prezantimi i parimeve dhe metodave për trajtimin e investimeve në titullzim;
 5. Prezantimi i parimeve dhe metodave për trajnimin e rrezikut të kundërpartisë;
 6. Prezantimi i rregullave specifike, që kërkojnë një njohje më të mirë të situatës financiare dhe të kolateralit.
- *Në lidhje me rrezikun e tregut:*
1. Prezantimi i metodës standarte për llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e tregut;
 2. Prezantimi i parimeve bazë mbi mënyrën e trajtimit, rregullimit dhe administrimit të librit të tregtueshëm;
 3. Prezantimi i rrezikut operacional si burim rreziku për të cilin duhet mbajtur kapital;
 4. Prezantimi i dy metodave: a) metoda e treguesit të thjeshtë dhe b) metoda standarte për llogaritjen e rrezikut operacional.

Më poshtë janë disa mangësi^{21 22} që ka Bazel I kundrejt Bazel II.

Tabelë 2. Krahasimi i Bazel I me Bazel II

Bazel I	Bazel II
Nuk është bërë diferencimi i rrezikut sipas klasifikimit të tyre	Gjatë llogaritjes së raportit të kapitalit duhet të trajtohen: rreziku i kredisë, rreziku i tregut dhe rreziku operacional
Nuk është marrë në konsideratë rritja e rrezikut operacional nga ana e bankave	Bankat mund të bëjnë llogaritjen e raportit të kapitalit duke i shfrytëzuar tri metoda: metodën standarde, metodën e vlerësimit të brendshëm dhe metodën e avancuar të vlerësimit
Nuk kanë aplikuar metodat në vlerësimin dhe zbutjen e rrezikut të kredisë, të tilla si kolateral dhe format tjera të garancive	Gjatë shfrytëzimit të këtyre metodave në përllogaritjen e rrezikut të kredisë, bankat duhet të kenë parasysh edhe komponentët e tjerë të rrezikut të kredisë: probabilitetin ndaj dështimit, humbjet e dhëna ndaj dështimit, ekspozimi ndaj dështimit dhe maturitetin
Nuk ka vlerësim të përshtatshëm në bazë të maturitetit të strukturës së kredive, fondeve dhe depozitave në raport me maturitetin e ekspozimit kreditor	Në kuadër të Bazel II, procesi i mbikëqyrjes duhet të bazohet në katër parimet bazë për vlerësimin e rrezikut. Në këtë drejtim bankat duhet të zhvillojnë strategjitë dhe metodologjitë mbi vlerësimin e kapitalit dhe rrezikut

Burimi: BCBS (2004) dhe Carvalho (2005)

²¹ Basel Committee on Banking Supervision. International Convergence of Capital Measurement and Capital Standards: Basel II, Basel: Bank for International Settlements, (2004)

²² Fernando Carvalho, (2005), Basel II: A Critical Assessment, fq. 2-3

2.1.2 Matja e Rrezikut të Kredisë

Bazel II, e ka ndryshuar në thelb trajtimin e rrezikut të kredisë dhe kërkon që bankat të mbajnë kapital të mjaftueshëm për të mbuluar rreziqet operacionale. Ai imponon kërkesa cilësore për menaxhimin e të gjitha rreziqeve. Për të mundësuar implementimin e tij sa më të plotë, shumë banka do të duhet të organizojnë strategjinë e tyre të biznesit ashtu si dhe rreziqet që vijnë prej tyre. Për të llogaritur kërkesën për kapital, një bankë i duhet të implementojë një strukturë gjithë përfshirëse të menaxhimit të rrezikut në të gjithë institucionin, pasi përmirësimet e menaxhimit të rrezikut shpërblehen me kërkesa të ulëta për kapital. Megjithatë, ky proces do ketë një efekt të gjerë edhe në sistemet e informacionit të bankave, në proceset, njerëzit dhe biznesin.

Bazel II, inkurajon përmirësime të vazhdueshme në vlerësimin, menaxhimin dhe në zvogëlimin e rrezikut duke u dhënë bankave kohën për të fituar avantazh konkurrues nëpërmjet shpërndarjes së kapitalit në ato procese, segmente dhe tregje që paraqesin një raport të fortë rrezik/kthim.

Sipas marrëveshjes së Basel II²³, institucionet financiare përballen me tre rreziqe:

1. **Rrezikun e kredisë**- Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes për shkak të mospagimit të detyrimit nga ana e huamarrësit në kushtet e kredisë apo ndonjë linje kreditore²⁴. Komiteti i Bazel-it ka përcaktuar dy metodologji mbi përllogaritjen e kërkesave të kapitalit mbi rrezikun e kredisë, matja e rrezikut të kredisë me metodën e standardizuar (SA) dhe metodologjia tjetër e lejuar nga autoritetet rregullative lejohet përdorimi i metodës së vlerësimit të brendshëm (IRB).
2. **Rrezikun e tregut** -Rreziku i tregut është përcaktuar si rreziku i humbjeve, në zërat e bilancit dhe në zërat jashtë bilancit, të pozicionit financiar që rrjedhin nga lëvizjet e çmimit të tregut²⁵.
3. **Rrezikun operacional**- Rreziku operacional është përcaktuar si rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë dhe të tërthortë si rezultat i procedurave dhe proceseve të brendshme jo të përshtatshme ose nga mjedisi i jashtëm. Ekzistojnë tri metoda për vlerësimin e këtij rreziku: Metoda e treguesit bazë (BIA), Metoda e Standardizuar (SA) dhe Metoda e Vlerësimit të Avancuar (AMA).

Karakteristikat Metodës së Standardizuar²⁶:

1. Pësia e rrezikut përcaktohet sipas ECAI-ve të pranuar;
2. Kjo është metodë e thjeshtë;

²³ Banka e Shqipërisë, Rregullorja “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” (miratuar me vendimin nr. 48, datë 31.07.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë), e cila përafron më tej kuadrin rregullativ me Direktivën Evropiane 2006/48/EC mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe direktivën 2006/49/EC mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të institucioneve të kreditit dhe të shoqërive të investimit, si dhe akordin e kapitalit - Bazel II

²⁴ Basel II (2006): International Convergence of Capital Measurement and Capital Standards, A Revised Framework Version

²⁵ Prudential Financial Policy Department, Risk-Weighted Capital Adequacy Framework (Basel I), fq.3

²⁶ Banka e Shqipërisë, Rregullorja “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” (miratuar me vendimin nr. 48, datë 31.07.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë), e cila përafron më tej kuadrin rregullativ me Direktivën Evropiane 2006/48/EC mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe direktivën 2006/49/EC mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të institucioneve të kreditit dhe të shoqërive të investimit, si dhe akordin e kapitalit - Bazel II

3. Metoda vlen vetëm nëse kompanitë janë të vlerësuara "rated";
4. Nuk merr në konsideratë ndryshimet e papritura në kushtet ekonomike apo të një sektori të veçantë, duke çuar në nënvlerësimin apo mbivlerësimin e rreziqeve aktuale.

Karakteristikat e Metodës së Vlerësimit të Brendshëm²⁷:

1. Kemi dy metoda : Metoda bazë e vlerësimit të brendshëm dhe metoda e avancuar e vlerësimit të brendshëm;
2. Metoda bazë e vlerësimit të brendshëm është më mirë të aplikohet në vende ku aktiviteti bankar është me pakicë siç është Shqipëria;
3. Ekspozimet janë njësoj si tek metoda standarte, vetëm se ka numër më të lartë të klasave: sovran, bankat, korporatat, pakica dhe ekspozime të kapitalit neto;
4. Peshat e rrezikut janë të bazuara në vlerësimet e brendshme që bëjnë vetë bankat. Bankat duhet të plotësojnë kushtet për këtë: 1.Të kenë përdorur një sistem vlerësimi të paktën tre vjet para se të kualifikohet për metodën e vlerësimit të brendshëm, 2.Periudha e vëzhgimit për vlerësimin e probabilitetit të dështimit (PD) nga banka duhet të jetë të paktën pesë vite, ndërsa të dhënat e përdorura për të vlerësuar humbjen nga dështimi (LGD) dhe ekspozimin në dështim (EAD) duhet të jetë të paktën shtatë vite, me përjashtim të ekspozimeve me pakicë për të cilat afati është pesë vite;
5. PD duhet të vlerësohet gjithmonë nga bankat, ndërsa LGD e EAD e Maturiteti nga mbikëqyrja.

Sipas BSH, për zbatimin e Marrëveshjes së Bazeli II, kërkohet nga institucionet financiare që të bëjnë vlerësimin e ekspozimit të kredive për secilin konsumator dhe për secilin produkt të kredive nëpërmjet këtyre matësve:

- **Probabiliteti i mospagimit të kredisë (PD)** - probabiliteti që një kredimarrës do të dështojë brenda 12 muajve të ardhshëm, prandaj kjo kredi konsiderohet si e dështuar. Ndërsa të gjitha bankat pranojnë se dështimi ndodh kur brenda 90 ditëve nuk ka pagesë;
 - **Humbja për dështimet (LGD)**- përqindja për secilin produkt të kredive në rast të mospagesës apo dështimit;
 - **Ekspozimi ndaj dështimit (EAD)** - ekspozimi i pritur për secilën kredi kur ndodh dështimi;
 - **Maturiteti (M)**- afati deri në pagesën e fundit të një kontrate kredie apo ndonjë instrumenti tjetër financiar;
- Pra humbja e pritur llogaritet si më poshtë:

$$EL \text{ (humbja e pritur)} = PD * LGD * EAD$$

Probabiliteti i mospagimit të kredisë – PD

²⁷ Banka e Shqipërisë, Rregullorja “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” (miratuar me vendimin nr. 48, datë 31.07.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë), e cila përafron më tej kuadrin rregullativ me Direktivën Evropiane 2006/48/EC mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe direktivën 2006/49/EC mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të institucioneve të kreditit dhe të shoqërive të investimit, si dhe akordin e kapitalit - Bazeli II

Rregullativa e Bazeli II ka për qëllim të vendosë standardet ndërkombëtare mbi kapitalin, se sa është kapitali minimal që bankat duhet të mbajnë për t'u mbrojtur nga krizat financiare si dhe rreziqet e tjera. Prandaj, kjo përbën koston të cilën banka duhet të paguajë për të zhvilluar aktivitetin e saj dhe kjo kosto është e ndarë në dy pjesë: humbja e pritshme dhe humbja e papritshme.

Objektivi kryesor i matësit PD është që të parashikojë shkallën e dështimit dhe të bëjë parashikime të përshtatshme për dalluar ndërmjet strukturës së klientëve, klientët e mirë që nuk kanë probleme gjatë shlyerjes së detyrimeve ndaj bankës dhe klientë jo të mirë që kanë probleme dhe vonesa të theksuara gjatë kthimit të detyrimeve të tyre.

Bankat e zbatojnë rregullativën e Bazeli II për të bërë matjen e humbjeve të pritshme, që konsiston në matjen e **probabilitetit ndaj dështimit, matjen e humbjes së dhënë ndaj dështimit** dhe matjen e **ekspozimit ndaj dështimit**.

Humbjet për dështimet - LGD

Sipas Bazeli II, LGD është kredia që është humbur nga një institucion financiar kur një kredimarrës i saj dështon në pagimin e detyrimit, e shprehur në përqindje ndaj dështimit të kredimarrësit. Në momentin që ndodh kjo humbje, kredidhënësi merr në pronësi asetin ose kolateralin që ka lënë kredimarrësi dhe ky kthim quhet norma e mbulueshmërisë:

$$RR=1-LGD$$

Ekspozimi ndaj Dështimit – EAD

Ekspozimi ndaj dështimit është treguesi i cili përdoret për llogaritjen e kapitalit ekonomik apo kapitalit rregullativ për institucionet bankare. Janë dy mënyra për vlerësimin e EAD, në mënyrën e parë ka vetëm një ekspozim në zërat e gjendjes së bilancit, ose ndryshe kredimarrësit nuk i lejohet rritja e ekspozimit kreditor, ndërsa në mënyrën e dytë kredimarrësi mund të bëjë rritjen e ekspozimit të vlerës së tij edhe nëpërmjet zërave jashtë bilancor. Për llogaritjen e ekspozimit ndaj dështimit (EAD) përdoret formula si më poshtë:

$$EAD = \text{zërat e bilancit} + CCF * \text{zërat jashtë bilancit} + 3 \text{ muaj të interesit}$$

2.1.3 Matja e Rrezikut të Tregut

Rreziku i tregut është përmbledhje e një tërësi të rreziqeve si: rreziku i normës së interesit, rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziku i kapitalit (Vyas & Singh, 2010). Për të menaxhuar rrezikun e tregut, bankat kanë zhvilluar një numër të madh të teknikash të sofistikuar matematiko-statistikore. Njëra ndër teknikat më të aplikuara është *Vlera në Rrezik* (VaR), e cila shfrytëzohet në më shumë se 15 vite dhe është vendosur si standard në rregullat për matjen e rrezikut të tregut. Për llogaritjen e kërkesës minimale të kapitalit komiteti i Bazeli-it për rrezikun e tregut ka përcaktuar dy metoda: metoda e standardizuar (SA) dhe metoda e vlerësimit të brendshëm (IRB) BCBS (2006).

Adaptimi i marëveshjes do të kërkohej më shumë në disa institucione sesa në disa të tjerë bazuar në faktorë të tillë si mbledhja e të dhënave dhe aftësitë e modelimit, praktikat e menaxhimit të rrezikut, numrit të karakteristikave, madhësia e biznesit, tipeve të rrezikut, bizneseve specifike, portofolit dhe kushteve të tregut.

Sfida për sistemin bankar është transformimi e përshtatja e institucioneve ndërkohë që janë duke bërë biznes.

2.1.4 Matja e Rrezikut Operacional

Sipas Bazel II, rreziku operacional është rreziku i humbjeve që rezultojnë nga procedurat dhe politikat e brendshme jo të përshtatshme dhe nga stafi me të cilin vepron institucioni financiar. Mbulimi i këtij rreziku me kapital, rrit vëmendjen që këto institucione të përdorin metoda siç është Metoda e Avancuar e Vlerësimit, duke çuar në rritjen e raportimit dhe monitorimit.

2.2 REGJISTRI I KREDIVE, INSTRUMENT PËR AMVISIMIN E RREZIKUT TË KREDISË

Në Bankën e Shqipërisë, që më 3 janar 2008 filloi funksionimi i Regjistrit të Kredive, që është baza elektronike e të dhënave për kredimarrësit e sistemit bankar dhe financiar shqiptar. Regjistri i Kredive funksionon sipas parimit të përpunimit dhe mbrojtjes së të dhënave të informacionit të tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të dhënat personale, sekretin profesional dhe atë bankar.

Fillimisht, raportuese të të dhënave në Regjistrin e Kredive ishin vetëm bankat dhe degët e bankave të huaja. Që më 19.11.2010, baza e të dhënave është pasuruar edhe me informacionin e raportuar nga subjektet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit.

Aktualisht, pjesëmarrës në regjistr²⁸ janë 16 banka, 12 subjekte financiare jobanka që ushtrojnë aktivitetin e kredidhënies dhe të qirasë financiare, 1 shoqëri kursim-krediti që ushtron aktivitetin e pavarur nga unionet si dhe 2 unione të shoqërive të kursim-kreditit në rolin e përfaqësuesve të shoqërive anëtare të tyre.

Raportuesit e të dhënave ngarkojnë çdo ditë kreditë e reja, si dhe përditësojnë çdo fund muaji statusin e shlyerjes së kredive. Regjistri përmban informacione pozitive dhe negative për kredimarrësin dhe këto të dhëna ruhen për 5 vjet. Përdorimi i historikut të shlyerjes së kredive nga kredimarrësit iu shërben raportuesve të të dhënave në procesin e vendimmarrjes, si informacion mbështetës për dhënien ose jo të kredive të reja duke reduktuar rrezikun e dhënies së kredive klientëve me probleme. Subjektet kredidhënëse, të cilat raportojnë kreditë e dhëna prej tyre në regjistrin e kredive, mbajnë përgjegjësi të plotë për saktësinë dhe plotësinë e këtyre të dhënave.

Raporti i kredimarrësit, që raportuesit e të dhënave marrin si produkt nga regjistri, përmban informacion mbi shumën e kredisë, shlyerjet e saj, shumat e vonuara, garancitë e vëna për të, të dhëna për linjat e kredisë ku kredimarrësi është person i lidhur, si dhe historikun e statusit të kredisë për dy vitet e fundit. Raporti i kredimarrësit mund të gjenerohet nga çdo subjekt bankar dhe financiar që është pjesë e regjistrit të kredive, si dhe nga Banka e Shqipërisë, e ky regjistër ndihmon në reduktimin e kohës që bankave u nevojitet për marrjen e vendimit për dhënien e kredisë dhe ndikon në rritjen e cilësisë së kredidhënies.

²⁸ Banka e Shqipërisë, Regjistri i kredive

Siç e dimë, rregullorja e re e Bankës së Shqipërisë “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” ka hyrë në fuqi me 31.12.2014, duke detyruar bankat që të përdorin metodën standarte për llogaritjen e rrezikut të kredisë, në kuadër të zbatimit të Bazel II. Dy mundësitë që ofron Bazel II për matjen e rrezikut të kreditit, janë Metoda Standarte dhe Metoda e bazuar tek Vlerësimi i brendshëm. Për zbatimin e Metodës Standarte, bankat do bazohen tek vlerësimet e ECAI²⁹-s për rrezikun e kredisë. Por, kjo metodë kërkon që të gjitha bizneset të jenë të vlerësuara “rated”, gjë e cila nuk është e mundur pasi mungon tregu i kapitalit dhe shumica e bizneseve nuk janë të kuotuar. Nga ana tjetër, Metoda e Vlerësimit të Brendshëm, bazohet në vlerësimet e brendshme që bankat iu bëjnë huamarrësve të tyre, por edhe kjo metodë kushtëzohet nga disponibiliteti i të dhënave të besueshme dhe të përshtatshme. Pikërisht këtu merr rëndësi informacioni që ofron regjistri i kredive dhe sipas L. Vrioni (2015)³⁰, shumë mirë mund të shërbejë si një instrument alternativ për një zbatim të besueshëm të Bazel II. Regjistri i Kredive ofron të gjithë informacionin që mund të përdoret nga mbikëqyrja në vlerësimin e parametrave të rrezikut, të nevojshëm për zbatimin e Metodës së Vlerësimit të Brendshëm “foundation” së bashku me sistemin e brendshëm të bankave.

2.3 VLERËSIMI I KOLATERALIT, INSTRUMENT PËR KTHIMIN E KREDIVE ME PROBLEME

Kriza financiare globale dhe paqëndrueshmëria në treg, përbën një sfidë më vete për bankat e nivelit të dytë të cilët krahas vlerësimit të aftësisë paguese të huamarrësit, duhet të analizojnë edhe kolateralin që ofron klienti. Kolaterali ose ndryshe garancia e ofruar nga kredimarrësi, është pjesë integrale e procesit të aprovimit të kredisë për të, prandaj vlerësimi i tij merr rëndësi të veçantë. Bankat bëjnë vlerësimet e kolateraleve nga vlerësuesit e jashtëm të cilët janë inxhinierë të licencuar për atë lloj kolaterali (apartament, njësi, truall) ose nga vlerësuesit e brendshëm të cilët janë inxhinierë staf të bankës. Raporti i vlerësimit përmban tre vlera me rend zbritës: 1. Vlerën e Tregut, 2. Vlerën e likuidimit të menjëhershëm dhe 3. Koston bruto të zëvendësimit.

Nisur nga problematikat e hasura me vlerësimet e kolateraleve, kryesisht nga vlerësuesit e jashtëm, Banka e Shqipërisë vendosi kriteret në metodologjinë e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 658 të datës 26.09.2012 dhe në tetor 2013 publikon udhëzuesin.

Më poshtë është shkurtimisht përmbajtja e udhëzuesit³¹ për bankat e nivelit të dytë dhe vlerësuesit (të jashtëm dhe të brendshëm), në lidhje me procesin e vlerësimit:

➤ **Parimi 1:**

Vlerësimi duhet të jetë konsistent dhe i bazuar në njohuri të përbashkëta të metodave dhe proceseve të vlerësimit. Standartet Evropiane të Vlerësimit³², të cilat duhet të mbahen në konsideratë nga çdo vlerësues, por pa rënë ndesh me përcaktimet ligjore në fuqi janë si më poshtë:

²⁹ Institucione të Jashtme të Vlerësimit të Kredisë

³⁰ Lindita Vrioni (2015), Revista Ekonomike “Sfidat e zbatimit të Bazel II”, fq.48

³¹ Banka e Shqipërisë, Udhëzues për përgatitjen e vlerësimeve të pasurive të paluajtshme për qëllime të marrjes së një kredie nga një institucion financiar (2013)

³² Standarde Evropiane të Vlerësimit 2012, Botimi 7, <http://www.tegova.org/en/p4912f1dc0472d>

1. *Metoda e vlerës së tregut:* Vlera për të cilën aktivi duhet të shkëmbehet, në datën e vlerësimit, midis një blerësi të vullnetshëm dhe një shitësi të vullnetshëm dhe të palidhur me njëri-tjetrin.
2. *Metoda vlerësimi të tjera përveç metodës së vlerës së tregut:* Metoda të tilla vlerësimi mund të përdoren, siç kërkohet nga ligji, nga rrethanat ose nga udhëzimet e klientit, kur supozimet mbi metodën e vlerës së tregut nuk qëndrojnë ose nuk mund të plotësohen. Rezultati i përfutur nuk do të jetë ai i vlerës së tregut.
3. *Vlerësuesi i kualifikuar:* Të gjithë vlerësuesve të kualifikuar dhe organizatave profesionale ose teknike, përfaqësuese të tyre, u kërkohet t'i përmbahen kodit të sjelljes profesionale të TEGoVA-s dhe të shoqatave anëtare.
4. *Proçesi i vlerësimit:* Kushtet e angazhimit për kryerjen e vlerësimit dhe metodat mbi të cilat do të kryhet vlerësimi, duhet të përcaktohen me shkrim përpara se të përpilohet raporti i vlerësimit.
5. *Raporti i vlerësimit:* Vlerësimi duhet të jetë i shkruar qartë sipas një standardi profesional, transparent në lidhje me udhëzimet, qëllimin, bazën, metodën, përfundimet dhe përdorimin e mundshëm të tij në të ardhmen.

➤ **Parimi 2:**

Vlerësimi i kolateralit duhet të kryhet nga një vlerësues i licencuar, i brendshëm ose i jashtëm.

1. Vlerësuesi duhet të jetë i pavarur nga funksionet e tjera, si për shembull: funksioni i kredithënies, i investimit ose i mbledhjes së fondeve, dhe nuk duhet të ketë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, financiar ose jo-financiar, mbi pronën që do të vlerësohet.
2. Vlerësuesi i brendshëm duhet të raportojë tek Komiteti i Administrimit të Rrezikut (ose komiteti analog) ose tek Komiteti i Kontrollit të Brendshëm, ndërsa vlerësuesi i jashtëm, duhet të angazhohet drejtpërdrejtë nga institucioni financiar.
3. Vlerësimi pranohet nëse: i) Vlerësuesi nuk ka interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, financiar ose jofinanciar, mbi pronën ose transaksionin, dhe; ii) Institucioni financiar përcakton që vlerësimi është në përputhje me kërkesat e vendosura prej tij dhe është i pranueshëm.

➤ **Parimi 3:**

Institucionet financiare duhet të disponojnë një listë të miratuar me vlerësues të licencuar për të kryer vlerësimet e pasurive të paluajtshme. Përfshirja e një vlerësuesi në këtë listë mbetet në diskrecionin e institucionit.

Vlerësuesi i përfshirë në këtë listë duhet të përmbushë kërkesat e objektivitetit profesional, që nënkupton se ai/ajo duhet të jetë i vetëdijshëm për çdo situatë që mund të perceptohet si një konflikt interesi si dhe kostot e vlerësimit duhet të jenë transparente.

➤ **Parimi 4:**

Për të gjitha pasuritë e paluajtshme është i nevojshëm një vlerësim. Megjithatë përjashtim nga ky përcaktim mund të bëjnë disa raste të veçanta.

➤ **Parimi 5:**

Institucioni financiar duhet të përcaktojë bazat dhe frekuencën për të cilat një kolateral duhet të rivlerësohet gjatë kohëzgjatjes së kredisë, për të siguruar se vlerësimi pasqyron kushtet aktuale të tregut.

➤ **Parimi 6:**

Prona e marrë në pronësi nga institucioni financiar është objekt i një vlerësimi periodik dhe institucioni financiar duhet të vendosë një afat kohor, të arsyeshëm dhe prudent, për mbajtjen e një prone të tillë.

Drejtuësit e institucionit financiar mund të miratojnë zgjatjen e periudhës së mbajtjes për një pronë të veçantë, me kusht që kjo zgjatje në kohë të mbështetet nga dokumentacioni i mësipërm, i cili tregon qartë se mungon kërkesa e tregut për këtë pronë.

2.4 KËRKIME TEORIKE TË TJERA

Të gjitha vendet kanë përmirësuar rregulloret e politikave të tyre bankare dhe ka një lëvizje të të gjithë sistemit bankar drejt marrëveshjeve të Bazel I/II.

Sipas studimit të Abba (2013)³³, mjaftueshmëria e kapitalit në përgjithësi ndikon në të gjitha subjektet, më shpesh përdoret në diskutimin e kompanive që operojnë në sektorin financiar të ekonomisë nëse firmat kanë kapital të mjaftueshëm për të mbuluar rreziqet me të cilët përballlet biznesi i tyre.

Tamini dhe Obeidat (2013)³⁴ kanë bërë një studim me qëllim identifikimin e faktorëve më të rëndësishëm që përcaktojnë të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave tregtare të Jordanisë për periudhën 2000 - 2008 duke përdorur analizën e regresive dhe koeficientin e korelacionit. Rezultatet e studimit ishin : 1- Ka një korrelacion statistikisht të rëndësishëm dhe lidhje pozitive në mes raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit në bankat tregtare dhe faktorëve të mëposhtëm të pavarur: rrezikut të likuiditetit, normës së kthimit nga aktivet; ndërsa nga ana tjetër, ekziston një lidhje e zhdrejtë me rëndësi statistikore mes raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave tregtare dhe faktorëve të pavarur: normë e kthimit të kapitalit neto dhe normës së interesit. Rezultat tjetër i studimit të tyre ishte që nuk rezultonte as lidhje dhe as rëndësi statistikore mes raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit në bankat tregtare dhe faktorëve të pavarur si: rrezikut të kapitalit dhe rrezikut të kredisë.

Sipas një studimi të Santomero dhe Watson (1977)³⁵, të cilët studiuan lidhjen e mjaftueshmërisë së kapitalit në lidhje me nivelin e kredidhënies, iu rezultoi që shtrëngimi i bankave për ruajtjen e nivelit minimal të mjaftueshmërisë së kapitalit, rezultoi në uljen e

³³ Abba, G. O., Zachariah, P., & Inyang, E. E. (2013). Capital Adequacy Ratio and Banking Risks in the Nigeria, Money Deposit Banks. *Research Journal of Finance and Accounting*, fq. 17

³⁴ Khaled Abdalla Moh'd Al-Tamimi, Samer Fakhri Obeidat, (2013), Determinants of Capital Adequacy in Commercial Banks of Jordan an Empirical Study

³⁵ Santomero, A. M., & Watson, R. D. (1977), "Determining an Optimal Capital Standard for the Banking Industry", fq. 1267

nivelit të kredidhënies, duke shkaktuar humbje për bankën, e për rrjedhojë kosto për të gjithë shoqërinë.

*Yonas Mekonnen, (2015)*³⁶, analizuan tetë banka tregtare në Etiopi për periudhën e studimit 2004-2013 dhe të dhënat janë siguruar nga raportet vjetore të bankave në studim. Në studim analizoi marrëdhëniet midis variablave bankare: si kapitali rregullator, raporti i depozitave, raporti kredi/aktivet totale, raporti i likuiditetit, raporti i kthimit nga aktivet, raporti i kthimit nga kapitali, marzhi neto i interesave dhe raporti i levës. Rezultati ishte që me probabilitet më pak se 5%, raporti i kthimit nga aktivet, raporti i depozitave dhe kapitali rregullator kishin efekt pozitiv mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, ndërsa raporti i kthimit mbi kapitalin dhe marzhi neto i interesave kishin një efekt negativ mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, dhe së fundmi raporti i likuiditetit, raporti kredi/aktivet totale dhe raporti i levës nuk kishin një efekt të rëndësishëm në mjaftueshmërinë e kapitalit.

Sipas studimit *Abba, Zachariah dhe Inyang, (2013)*³⁷ për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, ato shprehen se ajo përbën një masë të rëndësishme për "sigurinë dhe shëndetin" e bankave dhe institucioneve depozituese sepse ai shërben për absorbimin e humbjeve, duke e kthyer kështu në një nga standardet kryesore për institucionet financiare. Qëllimi i studimit është ekzaminimi në mënyrë empirike të marrëdhënies ndërmjet mjaftueshmërisë së kapitalit dhe rreziqeve bankare për bankat në Nigeri për një periudhë 5 vjeçare nga 2007-2011. Variablat e përdorur janë asetet e ponderuara me rrezikun, depozita dhe norma e inflacionit. Nga analiza rezultoi që ekziston një lidhje e rëndësishme negative në mes të raportit të rrezikut dhe mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave, që do të thotë se kur niveli i rrezikut rritet, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit bie.

*L. Bateni, H.Vakilifard dhe F.Asghari (2014)*³⁸ studiovan ndikimin që kanë shtatë faktorë financiarë bankarë mbi mjaftueshmërinë e kapitalit në bankat Iraniane për periudhën 2006-2012. Rezultatet e tyre tregojnë lidhjen negative në mes të kapitalit rregullator dhe raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave dhe lidhje pozitive midis raportit kredi/aktive, kthimit mbi kapitalin, kthimit mbi aktivet dhe raportit kapitalit/aktive. Ndërsa raporti i aktiveve të ponderuara dhe raporti depozita/aktive nuk kishin ndikim në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

*Bokhari dhe Ali, (2012)*³⁹, bënë studimin e përcaktuesve të mjaftueshmërisë së kapitalit në sektorin bankar në Pakistan, ku në analizë u përfshinë 12 banka dhe të dhënat e përdorura ishin për periudhën 2005-2009. Rezultatet treguan se variablat shpjegues të studimit, shpjegojnë arsyen se përse bankat mbajnë kapitalin përtej kërkesat rregullatore.

³⁶ Yonas Mekonnen, (2015), Determinants of capital adequacy of Ethiopia commercial banks

³⁷ Abba, Gabriel Ogere, Zachariah Peter, E.E Inyang, (2013), "Capital Adequacy Ratio and Banking Risks in the Nigeria Money Deposit Banks"

³⁸ Leila Bateni, Hamidreza Vakilifard dhe Farshid Asghari, (2009). "Determinants of Bank Profitability: Evidence from the Greek Banking Sector". Economic Annals, Volume LIV No. 182, fq.7.

³⁹ Ijaz Hussain Bokhari, Syed Muhamad Ali, (2012) "Determinants of capital adequacy ratio in banking sector: an empirical analysis from Pakistan"

Rezultatet treguan se raporti mesatar i kapitalit, raporti i kërkesës për kapital dhe niveli i rrezikut të portofolit kishin korrelacion të dobët, ndërsa depozitat, dhe kthimi nga kapitali kanë lidhje të fortë negative me raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

*Chiuri dhe Ferri dhe Majnoni (2001)*⁴⁰ kanë bërë një studim në lidhje me ndikimin që kanë faktorët makroekonomikë në mjaftueshmërinë e kapitalit të bankave në ekonomitë në tranzicion. Fokusi i tyre ishte matja e ndikimit të përmirësimit të standardeve të kontabilitetit, sigurimit të depozitave dhe ligjet e falimentimit, të cilët e bëjnë më të ndjeshëm kërkesën për kapital ndaj ndryshimeve në cilësinë e portofolit të bankave. Konkluzioni i tyre ishte se “kriza e kapitalit” dhe “kriza e kredive”, nisur nga zbatimi i rregulloreve për kapitalin e bankës është më i përhapur në ato vende që janë më pak të zhvilluara, prandaj zbatimi i kërkesave të reja të kapitalit duhet bërë hap pas hapi, në mënyrë që të shmangen efektet makroekonomike të padëshirueshme.

*Kikanda (2014)*⁴¹ ka bërë një studim në lidhje me ndikimin që kanë faktorët makroekonomike në përfitueshmërinë e bankave në Kenia për periudhën 2008-2012, në mënyrë specifike për kapitalin e bankës duke përdorur funksionin Cobb-Douglas. Qëllimi i tij ishte matja në mënyrë më të detajuar ndikimin e faktorëve makroekonomik si GDP real, inflacioni dhe kursi i këmbimit. Rezultatet empirike të këtij studimi tregojnë që faktorët makroekonomik të marrë në shqyrtim kanë ndikim të parëndësishëm në përfitueshmërinë e bankave në Kenia, ku GDP real dhe inflacioni kanë ndikim pozitiv të parëndësishëm, ndërsa kursi i këmbimit ka ndikim negativ të parëndësishëm.

*Otuori (2013)*⁴² studioi ndikimin e faktorëve makroekonomikë si kursi i këmbimit dhe norma e inflacionit në performancën e bankave tregtare në Kenia. Nga ky studim rezultoi se norma e inflacionit ka ndikim negativ dhe statistikisht të rëndësishëm në përfitueshmërinë e bankave.

*Sufian dhe Kamarudin (2012)*⁴³ kanë bërë një studim në lidhje me ndikimin që kanë faktorët makroekonomike në përfitueshmërinë e bankave në Bangladesh për periudhën 2000-2010 duke marrë për bazë 31 banka tregtare, duke përdorur analizën e regresionit. Rezultatet empirike të studimit tregojnë që faktorët makroekonomike kanë ndikim statistikisht të rëndësishëm dhe lidhja mes tyre është negative. Inflacioni ka lidhje pozitive dhe statistikisht të rëndësishëm, ndërsa GDP reale ka lidhje negative statistikisht të rëndësishëm.

⁴⁰Chiuri, Ferri and Majnoni (2001), The Macroeconomic Impact of Bank Capital Requirements in Emerging Economies: Past Evidence to Assess the Future

⁴¹Evans Ovamba Kiganda (2014), “Effect of Macroeconomic Factors on Commercial Banks Profitability in Kenya: Case of Equity Bank Limited”, Journal of Economics and Sustainable Development ISSN 2222-1700 (Paper) ISSN 2222-2855 (Online) Vol.5, No.2, 2014

⁴²Otuori, O. H. (2013). “Influence of exchange rate determinants on the performance of commercial banks in Kenya”. European Journal of Management Sciences and Economics, 1(2), 86-98

⁴³Sufian, F. & Kamarudin, F. (2012). “Bank specific and Macroeconomic Determinants of Profitability of Bangladesh’s Commercial Banks”. Bangladesh Development Studies. Vol. XXXV, December 2012, No.4 World Bank (2012)

Duke pasur parasysh që rregulloret e brendshme bazë për amvisimin e rrezikut të kredisë janë pothuajse të njëjta ndërmjet bankave që operojnë në të njëjtin vend, kjo si rrjedhojë e rregulloreve të Bankave Qëndrore përkatëse, atëherë si shkaqe kryesore që ndikojnë në mjaftueshmërinë e kapitalit dhe amvisimin e rrezikut janë edhe faktorët makroekonomike të cilët kanë ndikime të ndryshme në vende të ndryshme.

Ndryshimet makroekonomike ndikojnë thuajse në të gjitha institucionet, kuptimi dhe analizimi i ndikimit të tyre në sektorin bankar merr një rëndësi të veçantë duke qënë se bankat prirën të marrin më shumë rrezik përsipër sesa institucionet e jofinanciare (Hellwig 1995)⁴⁴.

*Babazadeh dhe Farrokhnejad (2012)*⁴⁵ studiovan ndikimin e kursit të këmbimit në operacionet dhe përfitimet e një banke tregtare në Iran për periudhën 2006-2010 duke përdorur modelin e Korigjimeve të Gabimeve (Error Correction Model). Rezultati tregoi që kursi i këmbimit është variabël statistikisht i rëndësishëm për fitimet.

*Rao dhe Lakew (2012)*⁴⁶ kanë bërë një studim në lidhje me ndikimin që kanë faktorët makroekonomike në përfitueshmërinë e bankave në Etiopi për periudhën 1999-2009 duke marrë për bazë banka tregtare që operojnë në vend. Sipas analizës me skenare, makroekonomike rezulton se faktorët e jashtëm kanë ndikim statistikisht të rëndësishëm. Inflacioni rezulton pozitivisht i lidhur me përfitueshmërinë e bankave, por statistikisht i parëndësishëm. Ndërsa PBB reale rezultoi statistikisht i parëndësishëm, por me shenjë pozitive.

*Ramadan, (2011)*⁴⁷ studioi lidhjen ndërmjet përfitueshmërisë së bankave dhe karakteristikave të faktorëve të brendshëm e të jashtëm duke përdorur të dhënat e 10 bankave në Jordani për një periudhë prej 2001-2010. Rezultatet treguan që inflacioni dhe PBB reale u shfaqën me lidhje pozitive dhe statistikisht të parëndësishëm për ROA-në.

*Zhang dhe Dong (2011)*⁴⁸ studiovan përfitueshmërinë e sektorit bankar amerikan për periudhën 2000-2008 duke përdorur metodën e katrorëve më të vegjël. Në studimin e përfitueshmërisë u morën në shqyrtim karakteristikat specifike dhe faktorët makroekonomike. Rezultatet treguan se PBB dhe normat e interesit ishin statistikisht të rëndësishëm në ndikimin e përfitimeve të bankave.

⁴⁴ Hellwig, M. F. (1995). Systemic Aspects of Risk Management in Banking and Finance, fq. 723-737

⁴⁵ Babazadeh, M. & Farrokhnejad, F. (2012). "Effects of Short-run and Longrun Changes in Foreign Exchange Rates on Banks' Profit". International Journal of Business and Management; Vol. 7, No. 17; 2012 ISSN 1833-3850 E-ISSN 1833-8119

⁴⁶ Rao, K. R. M. & Lakew, T. B. (2012). "Determinants Of Profitability of Commercial Banks in a Developing Country: Evidence from Ethiopia". International Journal of Accounting and Financial Management Research (IJAFMR). ISSN 2249-6882. Vol. 2 Issue 3 Sep 2012 1-20

⁴⁷ Ramadan, I. Z., Kilani, Q. A. & Kaddumi, T. A. (2011). "Determinants of Bank Profitability: Evidence from Jordan". International Journal of Academic Research, Vol. 3. No. 4

⁴⁸ Zhang, C. & Dong, L. (2011). "Determinants of Bank Profitability: Evidence from the U.S Banking Sector. Research Project Submitted in Partial Fulfillment of the Requirements for the Degree of Master of Financial Risk Management

*Jasmine (2011)*⁴⁹ studioi faktorët e përfitueshmërisë për bankat tregtare në Malajzi pas krizës financiare botërore të vitit 2008. Në studim u morën të dhënat për 8 banka tregtare për periudhën 2004-2010, ku si përcaktues i përfitueshmërisë u mor treguesi ROA si variabël i varur dhe norma bazë e kredisë, PBB, norma e inflacionit, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, të ardhurat totale, shpenzimet e menaxhimit, totali i kredive, totali i depozitave, madhësia e bankës dhe norma e mbulimit të interesave. Nga analiza rezultoi se norma bazë e kredisë është variabël statistikisht i rëndësishëm, ndërsa norma e inflacionit është variabël statistikisht jo i rëndësishëm për përfitueshmërinë në bankat tregtare në Malajzi.

*Dietrich dhe Wanzenried (2009)*⁵⁰ studioan përfitueshmërinë e 453 bankave tregtare në Zvicër për periudhën 1999- 2006. Krahas faktorëve specifikë të bankave, ato morën në studim edhe faktorët makroekonomikë. Me anën e analizës së regresionit rezultoi që norma e rritjes së PBB-së ka ndikim pozitiv në përfitueshmërinë e bankave.

*Constantinos dhe Sofoklis (2009)*⁵¹ studioan ndikimin që kanë faktorët makroekonomike në përfitueshmërinë e bankave në Greqi, duke përdorur të dhënat e gjashtë bankave Greke. Norma e inflacionit rezultoi me ndikim pozitiv, por me një ndikim të vogël në përfitueshmërinë e bankave. Ndërsa faktorët e tjerë, si PBB rezultuan statistikisht të parëndësishëm.

*Flamini dhe Mcdonald dhe Schumacher (2009)*⁵² në studimin e tyre për përfitueshmërinë e bankave të Afrikës rezultoi se variablat makroekonomike ndikojnë në përfitueshmërinë e tyre. Në veçanti inflacioni kishte një ndikim pozitiv në fitimet e bankës, gjithashtu edhe PBB reale ka ndikim pozitiv në përfitueshmërinë e bankave.

*Olga Bohachova (2008)*⁵³ në analizën ekonometrike midis faktorëve makroekonomikë dhe rrezikut të bankës në mënyrë të veçantë, duke marrë në shqyrtim 4,931 banka në 120 shtete për periudhën 2001-2005, tregon se cikli i biznesit është i lidhur me rrezikun e bankës se variablat makroekonomikë ndikojnë në përfitueshmërinë e tyre. Normat e larta të inflacionit shoqëroheshin me mbulim më të lartë kapitali bankar , duke nxitur bankat në uljen e kreditimit. Në shtetet me ekonomi të zhvilluar bankat tentojnë që të rrisin normat e mbulimit me kapital gjatë bumeve ekonomike, në mënyrë që në kohë recesioni do zbusi humbjet e mundshme. Në vendet jo anëtare të Konventës së Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, normat e mbulimit të kapitalit rriteshin gjatë

⁴⁹Jasmine,E. (2011).“An Empirical Analysis of Commercial Banks’ Profitability Determinants in Malaysia after the 2008 Financial Crisis”

⁵⁰Dietrich,A. & Wanzenried,G. (2009). “What Determines the Profitability of Commercial Banks? New Evidence from Switzerland”. Institute of Financial Services IFZ, Lucerne University of Applied Sciences, Grafenauweg 10,6304 Zug, Switzerland

⁵¹Aleiou,C.& Sofoklis,V.(2009). “Determinants of Bank Profitability: Evidence from the Greek Banking Sector”. Economic Annals, Volume LIV No. 182 / July –September 2009 UDC: 3.33 ISSN: 0013-3264

⁵²Flamini,V.,McDonald,C.& Schumacher,L.(2009).“The Determinants of Commercial Bank Profitability in Sub-Saharan Africa”. IMF Working Paper, WP/09/15.

⁵³Olga Bohachova (2008). “The Impact of Macroeconomic Factors on Rreziks in the Banking Sector: A Cross-Country Empirical Assessment”, Discussion Paper.

reçesioneve të cilat shpjegohen me një ulje të aktiveve riskoze kur humbjet janë të larta dhe kur mbizotërojnë rreziqet makroekonomike.

*Athanasoglou dhe Staikouras,(2006)*⁵⁴ studioan ndikimin e industrisë dhe faktorëve makroekonomikë në përfitueshmërinë e bankave për periudhën 1998-2002 duke përdorur të dhënat për institucionet kredidhënëse të Europës Juglindore. Rezultatet ishin të përziera, e në veçanti inflacioni kishte ndikim statistikisht të rëndësishëm dhe lidhje pozitive me përfitueshmërinë.

Nga të gjitha studimet e kryera nga autorë të ndryshëm, vërejmë që në përfitueshmërinë e bankave ndikojnë disa faktorë specifike e makroekonomike të cilët në vende të ndryshme kanë nivel ndikimi të ndryshëm.

2.5 ASIMETRIA E INFORMACIONIT

Duke qënë se bankat kanë funksion ndërmjetësues me sektorin real, normal që janë dhe të ekspozuar ndaj tij. Ndërkohë që kushtet makroekonomike rriten, për rrjedhojë edhe rreziku i ndërmjetësimit rritet. Pikërisht këtu, përballen bankat me asimetrinë e informacionit nga marëdhënia kredimarrës-kredidhënës, ku:

1. **Asimetria e informacionit:** një nga problemet kryesore me të cilat një bankë përballlet gjatë kreditimit është i lidhur me rrezikun e kreditit, i cili ka të bëjë me pamundësinë e bankës që të disponojë të njëjtin informacion që ka huamarrësi mbi kthimin e mundshëm dhe rrezikun e projektit.

Këto probleme përfshijnë edhe:

A) **Situatën e zgjedhjes së pafavorshme** (*Akerlof,1970*)⁵⁵ ndodh kur huamarrësit me probleme, të cilët kanë projekte të dobëta ekonomike dhe me rrezik të lartë, janë të prirur të pranojnë kushte jo të favorshme të kredisë (*Stiglitz dhe Weiss, 1981*)⁵⁶. Këta kreditorë, duke patur projekte me rrezik të lartë, janë të gatshëm të pranojnë norma të larta interesi sepse në rast se projekti finalizohet me sukses ata do jenë të vetmit fitues.

B) **Situatën e rrezikut moral** (*Diamond, 1984*)⁵⁷ mund të evidentohet vetëm pasi huamarrësi të ketë marrë kredinë dhe lidhet me mundësinë e përfshirjes në veprimtari të papranueshme për huadhënësin. Asimetria e informacionit midis huamarrësit dhe huadhënësit krijon kushte për një situatë të tillë.

Në shumë literatura (*Leyland dhe Pyle, 1977*)⁵⁸, (*Diamond, 1984*)⁵⁹ është trajtuar të kuptuarit të rolit të bankave në gjetjen e informacionit të “brendshëm” rreth

⁵⁴Panayiotis P. Athanasoglou,P,P.,Delis,M,D. & Staikouras,C,K.(2006). “Determinants of Bank Profitability in the South Eastern European Region”. Bank of Greece Economic Research Department –Working Paper No.47. ISSN 1109-6691

⁵⁵Akerlof (G.) (1970): “The Market for Lemons: Quality Uncertainty and the Market Mechanism”, Quarterly Journal of Economics, August, fq. 488-500

⁵⁶ Stiglitz (J.) and Weiss (A.) (1981): “Credit Rationing with Imperfect Information”, American Economic Review

⁵⁷Diamond (D.) (1984): “Financial Intermediation and Delegated Monitoring”, Review of Economic Studies 51, fq. 393-414

⁵⁸Leyland (H.) and Pyle (D.) (1977): “Informational asymmetries, Financial Structure and Financial Intermediation”, Journal of Finance 32, fq. 371-387

kredimarrësve në mënyrë që të zbusin problemet e asimetrisë së informacionit. Një marrëdhënie afatgjatë mes një klienti dhe bankës lejon që klienti të përfitojë nga kreditë më të lira të mundshme nga banka- siç është efekti i certifikimit (certification effect) (Diamond, 1991)⁶⁰.

2. Rreziku moral nga kredimarrësi -kur një huadhënës ka blerë mbrojtjen nga rreziku i kredisë dhe ka më pak interes në monitorimin e kredimarrësit sesa në mungesë të tregjeve të transferimit të rrezikut të kredisë. Duke supozuar që lojtarët e tjerë të tregut nuk mund të kryejnë monitorimin siç e bën banka, dhe një nxitje më e ulët për monitorimin nga banka do të përkeqësonte problemin e rrezikut moral në krahasim me gjendjen e ekuilibrit në mungesë të tregjeve për transferimin e rrezikut të kreditit (Gorton dhe Pennacchi, 1995⁶¹; Morrison, 2002⁶²).

Gorton dhe Winton (2002)⁶³ në studimin e tyre shprehin se megjithëse ekzistojnë dëshmi të konsiderueshme empirike për të mbështetur pretendimet e rolit të veçantë që luajnë bankat në zgjidhjen e problemeve të informacionit asimetrik dhe avantazhin e tyre krahasues në raport me lojtarë të tjerë të tregut, këto dëshmi përfshijnë studime e ngjarje që gjejnë kthime jo normale në tregun e aksioneve të firmave në përgjigje të paralajmërimeve bankare të kredive të reja, të rinovuara apo jo të rinovuara apo në lidhje me dështimin e huamarrësit.

Duffee dhe Zhou (2001)⁶⁴ kanë përshkruar një tjetër grup të rrethanave në të cilat problemi i përzgjedhjes së pafavorshme mund të jetë më pak i rëndë. Nëse ekziston një periudhë kohe (ndoshta në fillim të një kontratë të kredie) gjatë së cilës nuk ekziston asnjë informacion asimetrik midis huadhënësit dhe klientit në lidhje me probabilitetin e dështimit, atëherë blerja e mbrojtjes nga huadhënësi gjatë kësaj periudhe mund të mos rezultojë nga një problem i zgjedhjes së pafavorshme.

2.6 LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR AMVISIMIN E RREZIKUT DHE MJAFTUESHMËRINË E KAPITALIT

Në mënyrë që të shohim nëse ka mangësi në legjislacion në lidhje me procedurat e rregulloret në procesin e amvisimit të rrezikut të kredisë dhe raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, më poshtë po listojmë shkurtimisht përmbledhjen e disa neneve⁶⁵ kryesore të **Ligjit nr. 9662** që kanë për qëllim amvisimin e këtij rreziku dhe nivelin e raportit të

⁵⁹Diamond (D.) (1984): "Financial Intermediation and Delegated Monitoring", Review of Economic Studies 51, fq. 393-414

⁶⁰Diamond (D.) (1991): "Monitoring and Reputation: The Choice Between Bank Loans and Privately Placed Debt", Journal of Political Economy 99, fq. 688-721

⁶¹Gorton (G. B.) and Pennacchi (G.) (1995): "Banks and Loan Sales: Marketing Nonmarketable Assets", Journal of Monetary Economics 35, fq. 389-411

⁶²Morrison (A. D.) (2002): "Credit Derivatives, Disintermediation and Investment Decisions", Working paper, Oxford University

⁶³Gorton (G. B.) and Winton (A.) (2002): "Financial Intermediation", NBER Working Paper, fq. 15

⁶⁴Duffee (G. R.) and Zhou (C.) (2001): "Credit Derivatives in Banking: Useful Tools for Managing Risk", Journal of Monetary Economics 48, fq. 25-54

⁶⁵Banka e Shqipërisë, Ligji_Nr9662_Datë18-12-2006 për_bankat_në_RSH

mjaftueshmërisë së kapitalit. Më pas do paraqitet se sa zbatohen këto rregulla nga bankat e nivelit të dytë që operojnë në Shqipëri.

Sipas **Nenit 57 (Dispozita të përgjithshme)**, banka siguron një nivel të mjaftueshëm kapitali në raport me veprimtaritë e lejuara që ushtron, shtrirjen e tyre, si dhe tërësinë e rreziqeve, ndaj të cilave banka ekspozohet. Ajo duhet të jetë brenda kufizimeve të vendosura në mënyrë individuale ose të konsoliduar, të përcaktuara në këtë ligj ose në akte nënligjore të nxjerra nga BSH.

Sipas **Nenit 58 (Rregullat për administrimin e rrezikut)**, BSH përcakton rregulla për : llogaritjen e aktiveve të ponderuara me rrezikun; llogaritjen e ekspozimeve ndaj rrezikut ose rreziqeve; parimet e vlerësimit të tipologjisë së rreziqeve;klasifikimin dhe matjen e rrezikut të humbjes nga falimentimi i kundërpartisë; llogaritjen dhe përcaktimin e pozicionit të hapur valutor.

Sipas **Nenit 59 (Kapitali rregullator, mjaftueshmëria e kapitalit dhe garancia)**, banka mban kapitalin rregullator në një nivel të mjaftueshëm dhe struktura, elementet përbërëse dhe metoda e llogaritjes së kapitalit rregullator të bankës përcaktohen nga BSH. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit rregullator përcaktohet në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, por ai është jo më pak se 8% dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë bankare, kapitali rregullator i bankës nuk duhet të bien nën nivelin e kapitalit fillestar minimal të kërkuar në çastin e liçencimit të saj. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit rregullator llogaritet mbi baza individuale ose të konsoliduara. Gjithashtu banka për ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të saj ndaj kreditorëve, duhet të investojë një pjesë të kapitalit të saj fillestar minimal të dhuruar në të paktën një prej aktiveve të mëposhtme:1. depozitë në BSH me normë interesi të përcaktuar me marrëveshje midis tyre; 2. letra me vlerë të emetuar nga Këshilli i Ministrave ose BSH; dhe 3.aktive me rrezik të vogël.

Sipas **Nenit 60 (Aktivet e ponderuara me rrezikun)**, aktivet e ponderuara me rrezikun përbëjnë shumën e vlerave kontabël të zërave të aktiveve të bilancit dhe jashtë bilancit, të ponderuara me rrezikun e kredisë, tregut dhe të rreziqeve të tjera, ndërsa koeficientët e ponderimit për zërat e aktiveve brenda dhe jashtë bilancit përcaktohen nga BSH.

Sipas **Nenit 61 (Rreziku i kredisë)**, rreziku i kredisë nënkupton rrezikun që rrjedh nga pamundësia e kredimarrësit dhe e garantuesit të kredisë ose të kundërpartisë për aktivet e tjera, për të përmbushur detyrimet ndaj bankës ose degës së bankës së huaj, sipas kushteve të marrëveshjes së lidhur midis tyre. Banka sipas kërkesave të BSH klasifikon dhe vlerëson aktivet e saj brenda dhe jashtë bilancit; krijon fonde rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga zhvlerësimi i aktiveve, mbi bazën e klasifikimeve dhe vlerësimeve të saj; harton metoda të brendshme vlerësimi për rrezikun e kredisë. Gjithashtu, banka mban një dokumentacion të plotë dhe të qartë lidhur me çdo fazë të procesit të dhënies se kredisë dhe procesit të investimit, duke realizuar një administrim të sakte të procesit të kredidhënies, masave dhe mënyrës së monitorimit të tij, si dhe kontrollin e duhur mbi rrezikun e kredisë. Klasifikimi i aktiveve brenda dhe jashtë bilancit të bankës ose të degës së bankës së huaj bëhet duke vlerësuar minimalisht: aftësinë paguese të debitorit; mënyrën në të cilën një debitor përmbush detyrimet e tij; cilësinë e kolateralit, nëse ka; aftësinë paguese të garantuesit.

Sipas **Nenit 64 (Ekspozimi maksimal i lejueshëm)** ekspozimi i bankës ndaj një personi ose personave të lidhur me të nuk mund të tejkalojë 20% të kapitalit rregullator; kur personi ose grupi i personave të lidhur është shoqëria mëmë, filial i bankës, apo një ose

më shumë filiale të shoqërisë mëmë, ekspozimi nuk mund të tejkalojë 25% të kapitalit rregullator; ekspozimi i bankës ndaj personave të lidhur me të nuk mund të tejkalojë 10% të kapitalit të saj rregullator; banka nuk merr përsipër ekspozime të mëdha, të cilat, të marra së bashku, tejkalojnë 700% të kapitalit rregullator; banka respekton në çdo kohë kufizimet e përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij neni, në lidhje me ekspozimet e saj. Në rast se ekspozimet tejkalojnë kufizimet e mësipërme, banka raporton menjëherë në BSH, e cila përcakton masat e nevojshme dhe kohën për të rivendosur ekspozimet brenda kufizimeve të mësipërme.

Sipas **Nenit 66 (Rreziku i likuiditetit)**, bankat mbajnë likuiditetin në një shumë, strukturë dhe raporte që i lejojnë ato të përmbushin detyrimet e tyre dhe angazhimet e marra, sipas afateve kohore në një kosto të arsyeshme dhe me një rrezik minimal; me qëllim administrimin e rrezikut të likuiditetit, në mënyrë efektive, banka ose dega e bankës së huaj harton dhe zbaton politika lidhur me: a) planifikimin e lëvizjeve të cash-it, përfshirë edhe ngjarjet e papritura; b) monitorimin në vazhdimësi të likuiditeteve; c) marrjen e masave të duhura për parandalimin ose eliminimin e shkaqeve të mungesës së likuiditetit.

Sipas **Nenit 67 (Rezerva e detyrueshme)**, bankat mbajnë depozita pranë BSH, siç parashikohet në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, në nivele minimale të përcaktuara nga kjo e fundit, të quajtura rezerva të detyrueshme, të cilat lidhen me shumën e pasiveve apo ndryshimeve të tyre ose të kategorive specifike të pasiveve.

Sipas **Nenit 68 (Rezervat për mbulimin e humbjeve)**, bankat vlerësojnë vazhdimisht rreziqet e kredisë dhe krijojnë rezervat për mbulimin e humbjeve të shkaktuara nga huatë dhe pretendime të ngjashme, si edhe nga detyrimet e mundshme që ndodhen jashtë bilancit; rezervat për mbulimin e humbjeve të identifikuar, apo që mund të krijohen bazuar në përvojën e kaluar, që ekzistojnë në portofolin e kredive apo që kanë rezultuar nga detyrimet e mundshme jashtë bilancit, krijohen duke debituar shpenzimet e bankës; BSH përcakton me akt nënligjor metodën e llogaritjes së rezervave të parashikuara në këtë nen dhe kriteret e klasifikimit në varësi të rrezikut të kredive, pretendimeve të ngjashme ose të detyrimeve të mundshme jashtë bilancit.

2.7 SHPJEGIMI I VARIABLAVE

➤ Norma e Kredive me Probleme

Një kredi quhet kredi me probleme kur është duke mos u paguar ose ka shfaqur vonesa në pagesa. Kreditë quhen me probleme kur pagesat e kësteve (interes e principal) kanë kaluar afatin e pagesën për 90 ditë ose më shumë. Sipas FMN⁶⁶ "një kredi është me probleme kur pagesat e interesit dhe principalit janë të vonuara nga 90 ditë apo më shumë, ose të paktën 90 ditë nga pagesat e interesit, refinancuara ose vonuar me marrëveshje, ose pagesat janë më pak se 90 ditë vonesë, por ka arsye të tjera të mira për të dyshuar nëse pagesat do të bëhen në mënyrë të plotë". Norma e kredive me probleme është rezultat i raportit: shlyerje këst kredie e vonuar në raport me mbetjen e kredisë (e principalit).

⁶⁶ IMF, (2005) , "Clarification and Elaboration of Issues Raised by the December 2004 Meeting of the Advisory Expert Group of the Intersecretariat Working Group on National Accounts"

➤ Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) është rezultat i raportit kapitali i bankës ndaj rrezikut të saj. Banka qëndrore kontrollon këtë raport herë pas here për tu siguruar që bankat tregtare mund të përballojnë humbjet e mundshme dhe nëse janë konform kërkesave statuale për kapital.

Ky raport shërben për të mbrojtur depozituesit dhe për të promovuar stabilitetin dhe efikasitetin e sistemeve financiare në vend.

Për llogaritjen e këtij raporti maten dy llojet e kapitalit : Kapitali i grupit të parë (Tier 1) i cili mund të absorbojë humbjet pa ndaluar aktivitetin bankar, dhe Kapitali i grupit të dytë (Tier 2) i cili mund të absorbojë humbjet duke e ngadalësuar aktivitetin e saj e kështu siguron një shkallë të ultë të mbrojtjes për depozituesit.

Formula për llogaritjen e saj është:

$$\text{RMK} = (\text{Kapitali Tier}_1 + \text{Kapitali Tier}_2) / \text{Aktive të ponderuara me Rrezikun}$$

Sipas rregullave të Bazelit⁶⁷ dallimi i dy llojeve të kapitalit është shumë i rëndësishëm

1. Kapital Tier 1: Kapitali aktual + fitimi i mbajtur (RMK mund të jetë 4%)
2. Kapital Tier 2: aksionet e preferuara + 50% e borxhit të varur (RMK mund të jetë 8%)

Rreziku mund të ponderohet me aktivet ose të përcaktohet sipas kërkesave për kërkesë minimale të rregullatorit përkatës kombëtarë. Nëse përdoren aktive të ponderuara me rrezikun, sipas kërkesave të Bazelit.

$$\text{RMK} = (T_1 + T_2) / a \geq 12\%$$

Aktivet e ponderuara llogariten si më poshtë:

Tabelë 3. Llogaritja e Aktiveve të Ponderuara

Cash	10*0%=0
Letrat me vlerë të qeverisë	15*0%=0
Kreditë Hipotekore	20*50%=10
Kreditë e tjera	50*100%=50
Aktivet e tjera	5*100%=5
Rrezikut Total	
Aktivet e ponderuara	65%
Kapitali	5%
RMK (Kapital/Aktivet e ponderuara)	7.69%

Burimi: BCBS (2004) dhe Carvalho (2005)

⁶⁷ Basel II (2006): International Convergence of Capital Measurement and Capital Standards, A Revised Framework Version

➤ Kapitali Rregullator

Kapitali rregullator është kapitali i bankës, i llogaritur sipas kërkesave të rregullores⁶⁸ “Për Kapitalin Rregullator të Bankës” për mbulimin e rrezikut të kredisë, të rreziqeve të tregut dhe të rrezikut operacional.

Kapitali rregullator i bankës, në varësi të karakteristikave të tij dhe kushteve të përcaktuara në këtë rregullore, ndahet në dy kategori:

a) kapitali i nivelit të parë;

b) kapitali i nivelit të dytë.

Sipas BSH, bankat llogarisin kapitalin rregullator të tyre si shumë të kapitalit të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë, duke marrë në konsideratë, edhe zbritjet sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe/ose të akteve të tjera rregullative, gjithashtu përfshijnë kapitalin e nivelit të dytë në kapitalin rregullator të tyre sipas kufijve dhe afateve të mëposhtme:

a) deri në 50% të kapitalit të nivelit të parë (deri më 31.12.2016);

b) deri në 33.3% të kapitalit të nivelit të parë (duke filluar nga 01.01.2017).

Tabelë 4. Raportet dhe nivelet e kapitalit

NR.	Zëra	Vlera
1	Raporti: Kapitali Bazë i Nivelit të Parë/Ekspozime të ponderuara me rrezikun.	≥ 4.5%
3	Raporti: Kapitali i Nivelit të Parë/Ekspozime të ponderuara me rrezikun.	≥ 6%
5	Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	≥ 12%

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjithashtu sipas BSH⁶⁹, bankat duhet që kapitali rregullator i tyre të jetë në çdo kohë më shumë se totali i:

a) kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritur si totali i ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të ponderuara me rrezikun, të shumëzuara me 12%;

b) kërkesës për kapital për rrezikun e tregut të shumëzuar me 1.5;

c) kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde, të shumëzuar me 1.5.

Sipas metodës së treguesit të thjeshtë, e cila konsideron të ardhurën neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit të veprimtarisë së bankës dhe një koeficient α prej 15%.

$$\text{Kërkesa për kapital për rrezikun operacional} = \{(\text{Treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare e vitit T-1}) * (15\%) + (\text{Treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare e vitit T-2}) * (15\%) + (\text{Treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare e vitit T-3}) * (15\%)\} / 3$$

⁶⁸ BSH, Këshilli Mbikqyrës -Vendim Nr.69, Datë 18.12.2014 për miratimin e rregullores “Për Kapitalin Rregullator të Bankës”, fq. 3-4, fq.37

⁶⁹ Vendim nr. 48, datë 31.07.2013 për miratimin e rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, fq.14

Me kusht që:

- treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare e vitit $T-1 > 0$; dhe
- treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare e vitit $T-2 > 0$; dhe
- treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare e vitit $T-3 > 0$;

ku T është viti i raportimit.

➤ **Kapitali Total/Aktive Totale**

Raporti Kapitali Total / Aktivitet Totale është një raport likuiditeti e cila duhet të rezultojë sa më e lartë. Ky raport tregon se sa është aftësia paguese e bankës. Sharpe (1977)⁷⁰ e përkufizon kapitalin si diferencë midis aktiveve dhe depozitave, dhe sa më e madhe të jetë raporti kapitali total/aktivitet totale aq më të sigurta janë depozitat.

➤ **Kredi/Depozita**

Kredia është një borxh i ofruar nga një entitet (organizatë ose individ) të një entiteti tjetër në një normë interesi, të shprehur me anë të një marrëveshjeje e cila specifikon, ndër të tjera, afatin, shumën e principalit, normën e interesit, dhe datën e shlyerjes.

Kredia jepet kundrejt një kostoje (interesi mbi borxhin) e cila shërben si shtysë për dhënie kredie nga huadhënësi.

Kontrata e kredisë shoqërohet nga dy efekte: *efekti i menjëhershëm* duke vënë në dispozicion të klientit kredisë e caktuar, dhe *efekti pasues* që përbën përdorimin e kredisë së vënë në dispozicion (Zaho dhe Salko 2000)⁷¹.

Raporti Kredi/Depozita paraqet nivelin e ndërmjetësimit nga bankat në dy forma, 1. se sa mirë janë menaxhuar fondet e depozitave nga bankat, dhe 2. si ka qenë “oreksi” i bankave për ekspozimin ndaj kredive.

➤ **Kredi Totale/Aktive Totale**

Raporti Kredi Totale/Aktive Totale tregon se sa përqind e aktiveve të bankës përdoren për aktivitetin e kredihënies dhe ky tregues duhet të jetë sa më i lartë sepse tregon se sa peshë zënë aktivet fitimprurëse në formën e kredisë mbi aktivet totale. Prandaj ka shumë rëndësi që këto aktive të jenë sa më shumë të “shëndetshme”.

➤ **Depozita Totale/Aktive Totale**

Depozitat në para përbëjnë formën e grumbullimit të fondeve për bankat tregtare. Një llogari depozitë është një llogari kursimi, llogari rrjedhëse ose ndonjë lloj tjetër të llogarisë bankare që lejon para për të depozituar dhe tërhequr nga mbajtësi i llogarisë. Këto transaksione regjistrohen në librat e bankës, dhe në bilance rezultojnë si detyrime për bankën që banka i detyrohet depozituesit (Zaho dhe Salko 2000)⁷².

Bankat zakonisht janë subjekt i menaxhimit të depozitave në mënyrë që të reduktojnë rrezikun e dështimit të saj. Ajo gjithashtu ka për detyrim reduktimin e shkallës së humbjeve të depozituesit në rast të dështimit të bankës përmes skemës së sigurimit të depozitave.

⁷⁰ Sharpe, W. F. (1964). Capital Asset Prices: A Theory of Market Equilibrium under Conditions of Risk, fq.325

⁷¹ Lavdosh Zaho dhe Drini Salko (2000): “Teknika Bankare”, fq.219

⁷² Lavdosh Zaho dhe Drini Salko (2000): “Teknika Bankare”, fq.36, 83

Ky raport tregon se banka ka fonde e likuiditet të mirë, por gjithashtu nevojitet të mbahet një raport optimal në mënyrë që të mirë menaxhohen këto fonde në dhënien e kredive.

➤ **Aktivitet e Ponderuara me Rrezikun/Aktivitet Totale**

Sipas BSH ⁷³, ekspozimet e ponderuara me rrezikun llogariten si shumë e elementëve të mëposhtëm:

- a) zërave të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme, të ponderuar me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritura sipas Metodës Standarde;
- b) kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në rregullore, të shumëzuara me 12.5;
- c) kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde, të përcaktuara si më poshtë, të shumëzuara me 12.5.

$$RWW^* = [RW (SP) \times (t-t^*)/(T-t^*)] + [RW (Ass) \times (T-t)/(T-t^*)]$$

Ku:

RWW* - janë shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun;

RW (SP) - janë shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, në qoftë se nuk ka mospërputhje në maturitete;

RW (Ass) - janë shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, në rast se nuk do të titullzoheshin, të llogaritura në baza proporcionale;

T- është maturiteti i ekspozimeve themeltare, pjesë e titullzimit të shprehur në vite;

t - është maturiteti i mbrojtjes së kredisë i shprehur në vite;

t* - është 0,25.

Totali i aktiveve të ponderuara me rrezikun në raport me aktivitet totale, paraqet nivelin e aktiveve të ekspozuar ndaj tre rreziqeve: të kredisë, tregut dhe atij operacional.

➤ **Produkti i Brendshëm Bruto**

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) është një tregues ekonomik që paraqet vlerën me çmimet e tregut të të gjitha të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara brenda një shteti në një periudhë të caktuar (zakonisht një vit).

Ndërsa Produkti Kombëtar Bruto (PKB) paraqet vlerën me çmimet e tregut të të gjitha të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara nga burimet e punës dhe pronës së banorëve të një shteti brenda apo jashtë atij shteti në një periudhë të caktuar. PBB-ja është një ndër treguesit kryesorë makroekonomikë për të matur rritjen ekonomike. PBB-ja është dy llojesh reale dhe nominale. PBB-ja reale përfshin mallrat dhe shërbimet përfundimtare të matura me çmime konstante. PBB-ja nominale përfshin mallrat dhe shërbimet përfundimtare të matura me çmime korrente (Anderton, 1995) ⁷⁴.

Rritja e PBB-së shkakton rritjen e të ardhurave të një vendi në përgjithësi, e kjo do të thotë se si bizneset ashtu edhe individët kanë më shumë të ardhura në dispozicion për të shlyer kreditë e tyre, dhe si rrjedhim pritet të ketë një rënie të nivelit të kredive me

⁷³ B.SH, Vendim, Nr. 48, datë 31.07.2013, Për miratimin e rregullores “Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”, fq.13

⁷⁴ Alain Anderton, “Economics”, botimi i dytë, 1995, fq.640-641

probleme (lidhje e zhdrejtë) (Hess, Grimes dhe J. Holmes 2008)⁷⁵, duke çuar kështu edhe në uljen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

➤ **Papunësia**

Problemi më i madh i ekonomisë sonë është papunësia. Dihet problemet që rrjedhin nga papunësia.

Papunësia është një tregues ekonomik dhe përbën përqindjen e të papunësuarve nga tërë kapaciteti i fuqisë punëtore në një territor të caktuar. Ajo tregon nivelin e fuqisë punëtore të pashfrytëzuar në proceset ekonomike në një territor gjeografik. Gjithashtu, shkalla e papunësisë shërben si tregues i mirëqënies ekonomike në përgjithësi. Një shkallë e ulët tregon një ekonomi të fortë ku ata që kërkojnë punë mund ta gjejnë atë shpejt, ndërsa një shkallë e lartë mund të tregojë një ekonomi më të dobët (Wonnacott dhe Wonnacott, 1982)⁷⁶.

Gjatë drepresionit të madh, ekonomisti britanik, John Mynard Keynes krijoi një teori të re për papunësinë duke argumentuar që: a) një ekonomi tregu mund të gjejë ekuilibër në një shkallë të lartë papunësie, b) shkaku i papunësisë është kërkesa agregate e pamjaftueshme, c) kurimi më i mirë i papunësisë është rritja e shpenzimeve qeveritare.

Gjithashtu ai argumenton që nëse ekonomia vuan nga një shkallë e lartë e papunësisë, ndryshimet në shpenzimet totale (kërkesa agregatë) do shkaktojnë ndryshime në produktin kombëtar dhe punësimin. Çmimet dhe rrogat do drejtohen drejt rënies, por nuk do bien shumë.

Komponentët e kërkesës agregate janë:

1. Shpezimet e konsumit personal (varen nga të ardhurat individuale në dispozicion)
2. Kërkesa për investime (një rritje e saj do rrisi prodhimin kombëtar dhe të ardhurat, dhe shumëfishuesi i saj shprehet si (Shumëfishuesi = $1/(1-MPC)$) (MPC = prirje marzhinale për të konsumuar).
Meqënëse kemi që: $Kursimet = Të\ Ardhura - Konsum$, atëherë prirja marzhinale për të kursyer është $1-MPC$, për rrjedhojë shumëfishuesi është i barabartë me $1/MPS$.
3. Blerjet e qeverisë, të mira e shërbime
4. Eksportet neto

Sipas Bofondi dhe Ropele (2011)⁷⁷, rritja e papunësisë shkakton një ulje të të ardhurave të përgjithshme të një vendi, që do të thotë një ulje të aftësisë paguese të kredive të marra, dhe si rrjedhim pritet një rritje të mëtejshme të nivelit të kredive me probleme (lidhje e drejtë), dhe si rrjedhim një ulje të nivelit të kapitalizimit të bankave (lidhje e zhdrejtë);

⁷⁵ Kurt Hess, Arthur Grimes, Mark J. Holmes, 2008, "Credit Losses in Australasian Banking" Department of Economics, Working Paper in Economics 08/10 June 2008

⁷⁶ Paul Wonnacott dhe Ronald Wonnacott, 1982, "Economics", botimi i dytë, fq. 141

⁷⁷ Marcello Bofondi, Tiziano Ropele, 2011, "Macroeconomic determinants of bad loans: Evidence from Italian banks", Occasional Paper, Bank of Italy

➤ Inflacioni

Inflacioni është një tregues makroekonomik që tregon rritjen e përgjithshme të ofertës monetare në një ekonomi të caktuar në një periudhë të caktuar⁷⁸. Një nga efektet që mund të shoqërojë inflacionin është edhe rritja e çmimeve të të mirave dhe shërbimeve. Ndërsa deflacioni ka efekt të kundërt me inflacionin.

Sipas ekonomistëve të shkollës austriake të ekonomisë, termi "inflacion" nuk do të thotë rritje e përgjithshme e çmimeve, por rritje e masës monetare në qarkullim në treg. Sipas tyre rritja e çmimeve është vetëm një nga pasojat e inflacionit monetar, që do të thotë proces i krijuar nga një politikë monetare ekspansionistë (zgjeruese) e bankës qendrore, nëpërmjet së cilës më shumë para në qarkullim, bëjnë që monedha të humbasi vlerë, duke krijuar në mënyrë të pashmangshme edhe një rritje të çmimeve. Duke u nisur nga të tilla baza, shkolla austriake e ekonomisë kritikon sistemin aktual monetar që bazohet mbi monedhën ligjore (*fiat money*) duke folur edhe për mashtrim, duke qënë se e dorëzon të drejtën e inflacionimit të monedhës sipas dëshirës, në duart e bankave qendrore, duke krijuar humbje të fuqisë blerëse, rritje të çmimeve, dhe ciklet ekonomike. Sipas Friedrich Hayek, fitues i cmimit Nobël në Ekonomi⁷⁹, në kundërshtim me sistemin aktual, ekonomistët e shkollës austriake propozojnë rikthimin në një sistem monedhë-mall, si për shembull, një sistem të bazuar mbi arin, apo një sistem ku çdo bankë apo ent financiar të jetë i lirë të emetojë në mënyrë private valutën e vet, në konkurrencë me institutet apo entet e tjera financiare.

Një normë rritje e inflacionit sjell zvogëlimin e normave reale të kthimit mbi aktivet e bankës dhe prandaj shkakton uljen e kredisë. Si pasojë, vendet me inflacion të lartë do të kenë më pak aktivitet kreditimi (Boyd et al. 2001)⁸⁰. Sipas Mishkin (1996)⁸¹ deflacioni i shpejtë në një mjedis ku inflacioni është i lartë, do të shkaktojë norma të larta të interesit real dhe do ushtrojë një ndikim kontraktues mbi ekonominë, e për rrjedhojë do të rrisë rrezikun e kredisë për shkak të tkurrjes së fitimeve të huamarrësve.

Një rritje në normën e inflacionit shkakton një ulje të vlerës reale së principalit të mbetur pa paguar, dhe kredimarrësit do të kishin më shumë mundësi të paguanin këstet e tyre të kredisë, dhe si rrjedhojë pritet një nivel më i ulët i kredive me probleme (lidhje e zhdrejtë) (Frank Shostak 2002)⁸², duke çuar kështu në një rritje të nivelit të kapitalizimit të bankave (lidhje e drejtë).

➤ Normat e Interesit të Kredive

Normat e interesit janë të lidhura me ndryshimet në normat e interesit të tregut dhe për bankën përbën një burim rreziku. Një rritje në normat e interesit të tregut, ka efekt të drejtpërdrejtë në fitimet e bankës dhe e anasjellta. Gjithashtu një rritje në normat e interesit do të ndryshojë sjelljen e huamarrësit pas marrjes së kredisë duke përfshirë marrjen përsipër të projekteve të rrezikshme (rreziku moral) (Stiglitz dhe Weiss 1981)⁸³.

⁷⁸ Frank Shostak. "Defining Inflation", Mises Institute, (2002) fq.6

⁷⁹ Paul Wonnacott dhe Ronald Wonnacott, 1982, "Economics", botimi i dytë, fq. 286

⁸⁰ Boyd, J. H., Levine, R., and B.D. Smith (2001), The impact of inflation on financial sector performance, Journal of Monetary Economics 47(2): fq 221-248

⁸¹ Mishkin, F. (1996), Understanding Financial Crises: A Developing Country Perspective. NBER Working Paper 5600

⁸² Frank Shostak. "Defining Inflation", Mises Institute, (2002) fq.6

⁸³ Stiglitz (J.) and Weiss (A.) (1981): "Credit Rationing with Imperfect Information", American Economic Review

Një rritje e normës së interesit të kredisë do të shkaktonte një rritje të këstit të kredisë, dhe si rrjedhojë kredimarrësit do të kishin më shumë vështirësi në pagesat e kësteve më të larta (lidhje e drejtë) (Stiglitz dhe Weiss 1981)⁸⁴, e për rrjedhojë rritjen e nivelit të kredisë me probleme duke çuar në uljen e nivelit të kapitalizimit të bankës (lidhje e zhdrejtë).

Sipas BSH⁸⁵, në rastet kur pozicioni total neto i hapur valutor i saj, i përcaktuar në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore”, është më i lartë se 2% e kapitalit rregullator, bankat duhet të shumëzojnë me 8% vlerën e këtij pozicioni, për llogaritjen e kërkesës për kapital rregullator për rrezikun e kursit të këmbimit.

➤ **Kursi i Këmbimit**

Sipas Lindgren et al . (1996)⁸⁶ niveli i luhatjeve të kursit të këmbimit përbën ndikimin kryesor në përfitueshmërinë e bankave, prandaj dhe i jep më shumë rëndësi lidhjes së kursit të këmbimit me rrezikun e kredisë sesa rrezikut të valutës si valutë. Luhatjet e kursit të këmbimit dhe ndikimi i tyre në performancën e bankave varet nga ekspozimi i këmbimit valutor që ka banka.

Një rritje e kursit të këmbimit Lekë/Euro apo Lekë/Usd, nëse kushtet e tjera mbesin të pandryshuara, do të shkaktonte një rritje të këstit të kredisë, dhe si rrjedhojë kredimarrësit do ta kishin më shumë vështirësi në pagesat e kësteve më të larta (lidhje e drejtë) (Lindgren et al . 1996)⁸⁷ duke ndikuar në uljen e nivelit të kapitalizimit të bankës (lidhje e zhdrejtë).

⁸⁴ Stiglitz (J.) and Weiss (A.) (1981): “Credit Rationing with Imperfect Information”, American Economic Review

⁸⁵ Banka e Shqipërisë, Vendim, Nr. 48, datë 31.07.2013, Për miratimin e rregullores “Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”, fq.128

⁸⁶ Lindgren, C.-J., Garcia, G., and M. I. Saal (1996). Bank Soundness and Macroeconomic Policy. Washington, D.C.

⁸⁷ Lindgren, C.-J., Garcia, G., and M. I. Saal (1996). Bank Soundness and Macroeconomic Policy. Washington, D.C.


KAPITULLI 3 SISTEMI BANKAR NË VEND DHE PËRSHKRIMI I DISA MASAVE QË KANË NDËRMARRË BANKAT

Në këtë kapitull është paraqitur një analizë e ecurisë së treguesve kyç të sistemit bankar, tregues këto që janë marrë në studim dhe synon që ti japë përgjigje pyetjeve kërkimore të studimit.

3.1 ECURIA E NIVELIT TË KREDIVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

Periudha e studimit të punimit përfshin një kohë relativisht të gjatë që shkon nga tremujori katërt i vitit 2007 deri në tremujorin e katërt të vitit 2014.

Figurë 3. Ecuria e nivelit të kredive, 2007 – 2014 (në mln lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë, përshtatur nga autori

Në ecurinë e kredive në sistemin bankar shqiptar vërejmë që gjatë kësaj periudhe ka një tendencë rritëse të nivelit të kredive në sistemin bankar. Kjo e stimuluar nga rritja e rrjetit bankar në të gjithë vendin dhe nga ulja e normës bazë të bonove të thesarit, e për rrjedhojë edhe e interesit të kredive.

Rritja ka ardhur dhe si rezultat i granteve dhe programeve të ndryshme subvencionuese vendase e të huaja si programi i USAID për garancitë bankare, programi Italian i SME-ve METE, programi i huave EFSE, programi i huave GGF, programi i bashkëpunimit IPARD-like e GIZ-AZHBR si dhe programi AZHBR.

3.2 ECURIA E PESHËS SË KREDITIMIT TË DISA SEKTORËVE KYÇ NË SISTEMIN BANKAR


Analiza e kreditimit sipas sektorëve për nga pesha e kreditimit që zënë në totalin e kreditimit, është ndarë në dy grupe, 1. në sektorë që kreditohen më shumë, të cilat për

rrjedhojë janë më shumë të ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë dhe 2. në sektorë më pak të kredituar.

Tek grupi i parë vërejmë që përqëndrimi më i madh i kreditimit shfaqet në disa sektorë si: tregtia (34.4% në vitin 2014), industria përpunuese (14.68% në vitin 2014), ndërtimi (13.46% në vitin 2014) dhe prodhimi (12.89% në vitin 2014), të cilët së bashku në vitin 2014 kanë një peshë prej 75.43% të totalit të kredisë në sistemin bankar. Ky përqëndrim kredidhënieje shoqërohet me rrezikun e kredisë i cili gjithashtu shoqëron këtë kredidhënie.

Më poshtë ndodhet paraqitja grafike:

Figurë 4. Peshë e sektorëve më të kredituar në sistemin bankar, 2007 – 2014 (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë, përshtatur nga autori


Sipas figurës vërejmë që:

1. Kreditimi në sektorin e tregtisë paraqet një qëndrueshmëri në treg. Mesa duket ky sektor ndikohet më pak nga faktorët e jashtëm.
2. Kreditimi në sektorin e industrisë përpunuese paraqitet me një trend rënës, ku nivelin më të ulët e ka në vitin 2008.
3. Kreditimi në sektorin e ndërtimit arrin pikun e saj në vitin 2008, e cila ka ardhur në rënie si pasojë bllokimit të lejeve të ndërtimit, e për pasojë duke ndikuar një ngërcë në ekonominë në tërësi.
4. Kreditimi në sektorin e prodhimit, shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit e ujit, shfaqet në rritje dhe i qëndrueshëm.

Tek grupi i dytë vërejmë që përqëndrimin më të vogël të kreditimit e kanë sektorë si: hotelet dhe restaurantet (3.87% në vitin 2014), bujqësia (1.58% në vitin 2014), dhe pasuritë e paluajtshme (0.6% në vitin 2014), të cilët së bashku në vitin 2014 kanë një peshë të barabartë me 6.05% të totalit të kredisë në sistemin bankar.

Më poshtë ndodhet paraqitje grafike:

Figurë 5. Peshë e sektorëve më pak të kredituar në sistemin bankar 2007–2014 (në%)



Burimi: Banka e Shqipërisë, përshtatur nga autori


Sipas figurës për kreditimin e grupit më të kredituar vërejmë që:

1. Kreditimi në sektorin e hotelerisë dhe restoranteve shfaqet në rritje dhe i qëndrueshëm, kjo e ndikuar nga bllokimi i lejeve dhe një orientim i ndërtuesve për tu orientuar drejt hotelerisë dhe shfrytëzimi kryesisht i njësive tregtare për hoteleri e restorante.
2. Kreditimi në sektorin e bujqësisë paraqitet me një trend rrites, i cili sa vjen e rritet, pasi fokusi i gjithë sektorit bankar është orientuar drejt kreditimit të agrobizneseve, kjo e ndikuar dhe nga grantet dhe programeve të ndryshme subvencionuese vendase e të huaja si programi i USAID për garancitë bankare, programi Italian i SME-ve METE, programi i huave EFSE, programi i huave GGF, programi i bashkëpunimit IPARD-like e GIZ-AZHBR si dhe programi AZHBR.
3. Kreditimi në sektorin e pasurive të paluajtshme paraqitet me trend rënës, kjo si pasojë e bllokimit të lejeve të ndërtimit, e për pasojë duke ndikuar një ngërç në ekonominë në tërësi.

3.3 ECURIA E NIVELIT TË DEPOZITAVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

Periudha e studimit të punimit përfshin një kohë relativisht të gjatë që shkon nga tremujori katërt i vitit 2007 deri në tremujorin e katërt të vitit 2014.

Figurë 6. Ecuria e nivelit të depozitave, 2007 – 2014 (në mln lekë)




Burimi: Banka e Shqipërisë, përshtatur nga autori

Sipas figurës, vërejmë që niveli i depozitave ka ardhur në rritje nga viti 2007, megjithëse normat e interesit të depozitave kanë ardhur në rënie, niveli i depozitave ka ardhur në rritje, kjo e ndikuar nga një pasiguri të situatës në vend, e për rrjedhojë një pasiguri për të investuar, siç mund të përmendim prishjen e ndërtimeve me leje dhe politikat mbyjtëse të sistemit fiskal. Prandaj, shohim një tendencë të popullatës drejt ruajtjes së kursimeve në depozita me interes të ulët, në vend që ti investojnë ato.

3.4 ECURIA E RAPORTIT TË MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

Periudha e studimit të punimit përfshin një kohë relativisht të gjatë që shkon nga tremujori i parë i vitit 2004 deri në tremujorin e katërt të vitit 2014.

Figurë 7. Ecuria e Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit, 2004-2014 (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Ky tregues paraqet një sistem bankar të mirëkapitalizuar dhe të sigurtë, por gjithmonë kjo vetëm në këndvështrimin e Bazel I, ku sipas tij konsiderohej vetëm rreziku i kredisë.


Mbajtja e një niveli të lartë, në krahasim me kërkesën prej 12%, përbën një nevojë të bankave për ti paraprirë nënvlerësimeve të mundshme që mund t’iu kenë bërë aktiveve të ponderuara me rrezikun.

Deri para datës 31.12.2014, sistemi bankar shqiptar ka pasur në zbatim raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit minimumi 8% sipas Bazel I, më pas e në vazhdim ka raportin minimumi 12% sipas Bazel II.

3.5 ECURIA E NORMËS SË KREDIVE ME PROBLEME

Periudha e studimit të punimit përfshin një kohë relativisht të gjatë që shkon nga tremujori i parë i vitit 2004 deri në tremujorin e katërt të vitit 2014.

Figurë 8. Ecuria e Normës së Kredive me Probleme, 2004-2014 (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë, niveli më i lartë i kredive me probleme arrin në vitin 2013 në masën 23.22% të totalit të tepricës së kredisë.

Vërejmë që kredia me probleme për totalin e sistemit paraqet një trend rritës nga tremujori i katërt i vitit 2008 me 6.46% deri në vitin 2014 (24.88%). Pas vitit 2014 vërejmë një ulje të vogël të kësaj norme, periudhë kjo që shoqërohet edhe me përgatitjet e sistemit bankar për të plotësuar disa nga parimet e Bazel II të cilat lidhen me rrezikun e kredisë. Nga ana tjetër, kjo situatë shfaqet kontradiktore sepse nga njëra anë kemi raport mjaftueshmërie kapitali të qëndrueshëm, e nga ana tjetër kemi normën e kredive me probleme gjithnjë e në rritje dhe me luhatje shumë të mëdha. Një ndër arsytet është se bankat, në kapitalin e tyre kanë edhe asete të ish debitorëve, asete këto që qëndrojnë si kosto të zhytura (sunk cost) për bankën. Prandaj analiza e kapitalizimit të sistemit bankar është e pa plotë nëse nuk analizohet edhe rreziku i kredisë.


Bankat kanë pasur të drejtë që të fshijnë kreditë e këqija nga bilanci (write off), por meqenëse nuk njihej si shpenzim, bankat nuk e realizuan këtë proces sepse do penalizoheshin në tatim. Më vonë, me datë 03 prill 2014, u bë modifikimi i nenit 24,

Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”⁸⁸ të ndryshuar, ku u parashikua shtimi i një pike të dytë, sipas së cilës kredia e keqe do të njihet nga tatimet si shpenzim i zbritshëm për bankat, nëse do të plotësoheshin njëri nga dy kushtet: 1. a) të kenë kaluar 365 ditë pas depozitimit të kërkesës për fillimin e procedimit të ekzekutimit të detyrueshëm të përmbaruesit, në rast se kredia është e siguruar me pasuri të luajtshme/paluajtshme (kolateral); ose 2. të kenë kaluar 365 ditë pas lëshimit nga gjykata të urdhrit të ekzekutimit për asete të ndryshme që mund të zotërojë debitori, në rast se kredia nuk është e garantuar me pasuri të luajtshme/paluajtshme (kolateral).

3.6 ECURIA E RAPORTIT KREDI/DEPOZITA

Periudha e studimit të punimit përfshin një kohë relativisht të gjatë që shkon nga tremujori i parë i vitit 2004 deri në tremujorin e katërt të vitit 2014.

Figurë 9. Ecuria e Raportit Kredi/Depozita, 2004-2014 (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë


Raporti Kredi/Depozita ka nivelin më të ulët në vitin 2004 me 12%, raport ky që ka ardhur në rritje nga viti 2005 dhe arrin maksimumin në vitin 2009. Kjo periudhë përkon me hyrjen në fuqi të disa parimeve të Bazel I/II, ku bankat filluan të shtrëngonin kushtet e marrjes së një kredie dhe filluan të orientohen drejt kredidhënies cilësore e jo sasiore siç kishin vepruar më parë.

3.7 ECURIA E RAPORTIT KREDI TOTALE/AKTIVE TOTALE

Periudha e studimit të punimit përfshin një kohë relativisht të gjatë që shkon nga tremujori i parë i vitit 2004 deri në tremujorin e katërt të vitit 2014.

⁸⁸ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar, neni 24, për një shtesë në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar (2014), fq.1

Figurë 10. Ecuria e Raportit Kredi Totale/Aktive Totale, 2004-2014 (në %)




Burimi: Banka e Shqipërisë

Raporti Kredi Totale/Aktivitet Totale ka nivelin më të ulët në vitin 2004 me 14%, raport ky që ka ardhur gjithnjë në rritje deri në vitin 2009 në 51%. Më pas shohim një trend rënës ku në vitin 2014 arrin në 45.44%. Ky raport tregon pjesën që zënë kreditë totale mbi aktivet totale, dhe fakti që ka ardhur në rënie, konfirmon atë që bankat tashmë nuk i japin kreditë siç i kanë dhënë më parë, por tashmë janë shtuar kërkesat e kriteret që duhet të plotësojnë kredimarrësit. Gjithashtu, rënia e këtij raporti është e ndikuar dhe nga domosdoshmëria e ruajtjes së një niveli të caktuar kapitali, dhe rritja e kredidhënies do të thotë rritje ekspozimi ndaj tre rreziqeve bazë që janë ai i kredisë, i tregut dhe rreziku operacional.

3.8 ECURIA E DY TREGUESVE TË PËRFITUESHMËRISË

Periudha e studimit të punimit përfshin një kohë relativisht të gjatë që shkon nga tremujori i parë i vitit 2004 deri në tremujorin e katërt të vitit 2014.

Figurë 11. Ecuria e dy treguesve të përfitueshmërisë, 2004-2014 (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Raporti Kthyeshmëria nga aktivet paraqitet me trend gradual rënës dhe në tremujorin e tretë të vitit 2013 arrin nivelet më të ulëta, në -0.14% , ku më pas vjen në rritje. Ky raport rezulton në rënie si rezultat i uljes së fitimeve nga kreditë me probleme të cilat në të njëjtën periudhë arrijnë maksimumin e tyre. Edhe raporti Kthyeshmëria nga fondet e veta paraqitet me trend rënës dhe i paqëndrueshëm, ku arrin nivelet më të ulëta në tremujorin e tretë të vitit 2013, pikërisht në -1.67%.

Duke qënë se në tregun shqiptar operojnë disa banka që e kanë origjinën e tyre në Greqi, këto tregues që arrijnë në nivele negative pikërisht në këtë periudhë, vërtetojnë se sistemi bankar shqiptar është ndikuar negativisht ndaj krizës greke të vitit 2013, duke konfirmuar kështu që vuan nga efekti ngjithës (“contagion effect” Mishkin, Eakins 2006)⁸⁹ .

Nisur nga ulja e përfitueshmërisë dhe rritja e kredive me probleme në sistemin bankar shqiptar, lindi e nevojshme që institucionet si BSH, MF⁹⁰, ME⁹¹, MD⁹², ZRPP⁹³ dhe AAB⁹⁴ të reagojnë dhe të marrin masat përkatëse.

Më poshtë janë masat⁹⁵ ligjore e rregullatore që janë ndërmarë e do ndërmerren nga institucionet përkatëse për uljen e kredive me probleme:

Tabelë 5. Plani i masave për kreditë me probleme

	Nr.	Masa	Instit. përgjegjës	Afati
Masa Ligjore	1	Hartimi i Ligjit të ri të Falimentit	MD	Nëntor 2015
	2	Ndryshime në Kodin e Proçedurës Civile	MD	Nëntor 2015
	3	Ndryshime në Ligjin Nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”	MD,ZRPP	Tetor 2015
	4	Ndryshime në ligjin “Për barrët siguruese”	MF,ME	Tetor 2015
Masa Rregullatore	5	Shtyrje e afatit të masave të marra nga BoA mbi koeficientët e rrezikut dhe ristrukturimin e kredive me probleme	BSH	Shtator 2015
	6	Ndryshimi i terminologjisë në Rregulloren për fshirjen e kredive me probleme	BSH	Shtator 2015
	7	Ndryshimi i limitit njëvjeçar për mbajtjen nga bankat të kolateralit të marrë	BSH	Tetor 2015
	8	Trajtimi i 35 grupeve/kompanive me përqindjen më të lartë të borxhit	BSH	Tetor 2015/a) Dhjetor 2016

⁸⁹ Frederic S.Mishkin, Stanley G.Eakins (sixth edition, 2006), “Financial Market & Institution”, fq. 537

⁹⁰ Ministria e Financave

⁹¹ Ministria e Ekonomisë

⁹² Ministria e Drejtësisë

⁹³ Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

⁹⁴ Shoqata e Bankave

⁹⁵ Në apendix ndodhet tabela e plotë, me sqarimet e detajuara

			/b)
9	Përmirësim i kuadrit mbi shitjen e NPL	BSH	Dhjetor 2015
10	Përmirësim i Regjistrat të Kredive	BSH	Prill 2016/ a) Dhjetor 2017/b)
11	Dhënia e kredive vetëm në bazë të deklarave tatimore	BSH	Dhjetor 2015
12	Marrëveshje kuadër për ristrukturim jashtëgjyqësor të borxhit	BSH, AAB	Dhjetor 2015

Burimi: Banka e Shqipërisë

3.9 PYETJET KËRKIMORE

Bazuar në tematikën e punimit janë ngritur katër pyetje kërkimore:

1. A është përmirësuar treguesi Normë e kredive me probleme pas fillimit të implementimit të kuadrit rregullator të Bazel I/II?
2. A është përmirësuar treguesi Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit pas fillimit të implementimit të kuadrit rregullator të Bazel I dhe II ?
3. A është imoperativ implementimi i plotë i kuadrit rregullator BAZEL II dhe projekcioni i BAZEL III ?
4. Si kanë ndikuar masat e ndërmarra nga bankat për të menaxhuar më mirë rrezikun e kredisë?

Para se ti përgjigjemi pyetjeve kërkimore më poshtë ndodhet skema e ndryshimeve bazë në legjislacion në lidhje me përgatitjet për implementimin vetëm të kushtit RMK sipas Bazel I/II:


Tabelë 6. Ndryshimet në legjislacion për implementimin e RMK

Periudha	Ndryshimet në legjislacion	Bazel I	Bazel II
1999	Rregullorja për RMK në formë të thjeshtuar dhe të modifikuar minimumi 8%	x	
01.01.2009	Raportimet sipas SNRF		x
2013	Versioni i parë i rregullores për RMK		x
31.12.2014	Rregullorja vetëm për RMK minimumi 12%		x

Burimi: Banka e Shqipërisë

- Përmes *pyetjes së parë* kërkohet të paraqitet se si ka ndryshuar norma e kredive me probleme pas fillimit të implementimit të kuadrit rregullator Bazel I/II.

Figurë 12. Ecuria e Normës së Kredive me Probleme, 1998-T I 2016 (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë, niveli më i lartë i kredive me probleme ka qënë në vitin 1998 me 55%, më pas ky tregues ka ardhur në rënie në vitin 2000, për tu rritur përsëri në vitin 2001. Nga viti 2001, ka një trend rënës e cila më pas vjen duke u rritur nga viti 2008 dhe në vitin 2013 arrin në masën 23.22% të totalit të tepricës së kredisë. Pas vitit 2014 vërejmë një ulje të vogël të kësaj norme, periudhë kjo që shoqërohet edhe me përgatitjet e sistemit bankar për të plotësuar disa nga parimet e Bazel II të cilat lidhen me rrezikun e kredisë. Kjo situatë shfaqet kontradiktore sepse nga njëra anë kemi raport mjaftueshmërie kapitali të qëndrueshëm, ndërsa nga ana tjetër kemi normë e kredie me probleme gjithnjë e në rritje dhe me luhatje shumë të mëdha. Kjo mund të sqarohet me faktin se bankat, në pjesën e tyre të kapitalit kanë edhe asete të ish debitorëve, asete këto që qëndrojnë si kosto të zhytura (sunk cost)⁹⁶. Prandaj analiza e kapitalizimit të sistemit bankar është e pa plotë nëse nuk analizohet edhe rreziku i kredisë.

Ndërsa në vitin 2015 vërejmë një ulje të këtij treguesi, ulje e cila ka ardhur pas muajit prill 2014, kryesisht nga fshirja e kredive të këqija nga bilanci, pas modifikimit që iu bë nenit 24, Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar⁹⁷.

- Përmes pyetjes së dytë kërkohet të paraqitet se si ka ndryshuar raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit pas fillimit të implementimit të kuadrit rregullator Bazel I/II.


Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit nga viti 1998-2000 paraqitet me një trend rritës, me pas në vitin 2004 paraqitet me trend rënës, rënie kjo që arrin në nivelin më të ulët (15%) në vitin 2011. Ky tregues paraqet një sistem bankar të mirëkapitalizuar dhe të sigurtë, por gjithmonë kjo, vetëm në këndvështrimin e Bazel I, ku sipas tij konsiderohej vetëm

⁹⁶ Schmalensee, R. (1992). “Sunk Costs and Market Structure: A Review Article.” Journal of Industrial Economics, fq.127

⁹⁷ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar, neni 24, për një shtesë në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar (2014), fq.1

rreziku i kredisë. Mbajtja e një niveli të lartë, në krahasim me kërkesën prej 12%, përbën një nevojë të bankave për ti paraprirë nënvlerësimeve të mundshme që mund t’iu kenë bërë aktiveve të ponderuara me rrezikun.

Figurë 13. Ecuria e Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit, 1998-T I 2016 (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjithashtu po në vitin 2013, vërejmë që ky raport mjaftueshmërie mbi kapitalin është drejt rritjes, e ndikuar kjo edhe për arsye se në korrik 2013 Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën e Italisë miratuan rregulloren e re për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit. Qëllimi i saj ishte përcaktimi i rregullave për llogaritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit njëloj si Bazel II, si dhe përcaktimin e nivelit minimal të këtij raporti prej 12%. Nga kjo, rezulton që bankat i kanë paraprirë ligjit të ri për mjaftueshmërinë e kapitalit⁹⁸ që do hynte në fuqi më 31.12.2014.

- Përmes *pyetjes së tretë* kërkohet të paraqitet nëse ndryshimet e deritanishme të kuadrit rregulator shqiptar, mundësojnë implementimin e plotë të kuadrit rregulator Bazel I/II dhe projeksionin për Bazel III.

Duke qënë se rregullorja e re sipas **Bazel II** për mjaftueshmërinë e kapitalit ka hyrë në fuqi që më 31.12.2014 për bankat që operojnë në Shqipëri, tashmë është ligj zbatimi i saj. BSH për llogaritjen e kërkesave për kapital për rrezikun e kredisë sipas metodës standarde, ka ngarkuar Institucionet e Jashtme të Vlerësimit të Kredisë (ECAI) si të pranuar të cilët janë institucione të jashtme të vlerësimit të kredisë, të njohura nga Banka e Shqipërisë dhe të përfshirë në listën e ECAI-ve të pranuar. Për qëllime të përllogaritjes

⁹⁸ Banka e Shqipërisë, Vendim, Nr. 48, datë 31.07.2013, Për miratimin e rregullores “Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”, fq.13

së kërkesës për kapital, bankat mund të përdorin vetëm vlerësimet e kredisë së ECAI-ve të pranuar⁹⁹.

Lista ECAI-ve të pranuar¹⁰⁰ janë: 1.Moody's, 2.Fitch, 3.Standard &Poor's, dhe 4.Japan Credit Rating (JCR)¹⁰¹.

Sipas Bazel II, propozohen tre metoda për llogaritjen e nevojave minimale për kapital të nevojshëm për të mbuluar rrezikun e kredisë:

1. Metoda e Standartizuar
2. Metoda Bazë e Vlerësimit të Brendshëm (IRB)
3. Metoda e Avancuar e Vlerësimit të Brendshëm

Sipas BSH, bankat në Shqipëri nuk kanë kapacitetet e nevojshme për matjen dhe amvsimin e rrezikut të kredisë sipas metodës së avancuar të vlerësimit të brendshëm, dhe një vlerësim jo i saktë i tij duke u bazuar në të dhëna jo të plota, mund të shkaktojë rezultate shumë të dëmshme për sistemin bankar.

Vështirësitë e implementimit të plotë të kuadrit rregullator janë:

- Departamenti i Mbikëqyrjes, brenda vitit 2016, do finalizojë udhëzuesin e standardizuar për bankat e nivelit të dytë me qëllim zbatimin e Proçesit të Brendshëm të Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit, mbështetur në komponentët e **Shtyllës II të Bazel II**;
- Mungesa e tregut të kapitalit për vlerësimin e kompanive, do bëjë që pesha e rrezikut të tyre do vlerësohet 100%, njësoj si në Bazel I, duke nxitur që kompanitë të mos jenë të interesuara për tu vlerësuar sepse do rrezikonin mundësinë e kreditimit dhe kostoja e lartë monetare që shoqëron vlerësimin e tyre nga ECAI;
- Duhet të ndryshojnë metodat dhe standardet e brendshme në mbledhjen dhe raportimin për llogaritjen e aktiveve me rrezik;
- Nuk merr në konsideratë ndryshimet e papritura në kushtet ekonomike apo të një sektori të veçantë, duke çuar në nënvlerësim apo mbivlerësim të rreziqeve aktuale;
- Format e llojet e produkteve që bankat i ofrojnë klientëve janë të ndryshme nga kategoritë standarte të metodës;
- Bankave iu duhet që të shpenzojnë për përdorimin e modeleve të brendshme me të ndjeshme ndaj rrezikut sipas metodave më të avancuara të kuadrit të kapitalit.

Bazel III vendosi detyrime më strikte mbi mjaftueshmërinë e kapitalit bankar dhe për herë të parë vendosi detyrime mbi likuiditetin, ndër të tjera gjithashtu parashtroi edhe kërkesën për rritjen e transparencës. Në vendin tonë, që në prill 2015, të gjitha bankat e nivelit të dytë në websitet e tyre raportojnë informacionin sipas rregullores “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”¹⁰².

⁹⁹Banka e Shqipërisë Vendim, Nr. 48, datë 31.07.2013, për miratimin e rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, fq. 3


¹⁰⁰ Në apendikse ndodhen klasat e ekspozimeve për vlerësimet e kredive me metodën standarde sipas secilës ECAI

¹⁰¹Urdhër “Mbi njohjen e institucioneve të jashtme të vlerësimit të kredisë, të pranuar” Aneksi 1: Lista e ECAI-ve të pranuar, 22.04.2015, fq.2

¹⁰²Sipas Kërkesave të Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008, ndryshuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

Dallimet¹⁰³ mes Bazel II e Bazel III paraqiten në figurën e mëposhtme:

Figurë 14. Dallimet mes Bazel II e Bazel III



Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar, përshtatur nga autorja

Siç vihet re dallimet mes Bazel II e Bazel III për nivelin e kapitalizimit që kanë aktualisht, të cilin më shumë sforco po e mbajnë mbi nivelin minimal të kërkuar, do jetë shumë e vështirë që Bazel III të implementohet në një periudhë afatmesme. Nga Bazel III vetëm kërkesa për rritjen e transparencës është realizuar tashmë, pasi për bankat nuk kërkon kohë apo kosto ky proces.

- Përmes *pyetjes së katërt* kërkohet të paraqitet ndikimi tek variablat kyç të studimit i masave që vetë bankat kanë ndërmarrë për të mundësuar implementimin e kuadrit rregullator Bazel I/II.

Masat që kanë ndërmarrë bankat për përmirësimin e treguesve kyç janë:

- Optimizimi i përfitueshmërisë përmes diversifikimit dhe rritja e gamës së produkteve, shërbimeve dhe produktet e personalizuar që i ofrohen klientëve ekzistues dhe bizneseve të reja;
- Trajnimi çdo vit i stafit për të mundësuar shërbimin më të mirë bankar të mundshëm klientëve të bankës;
- Prioritet kryesor për departamentet e biznesit rritja e kredithënies në industritë strategjike dhe të synuara për zhvillimin ekonomik të vendit;
- Rritja e cilësisë së portofolit përmes një analize të kujdesshme për zbutjen e rrezikut të ndërmarrë, përmes: 1. Përmirësimit të paketave të garancisë;

¹⁰³ Katharina Seal, (October 2015) IMF, The international regulatory reform agenda: Implementation issues and implication for Asian Countries, fq. 11


2. Monitorim të vazhdueshëm të performancës së klientëve ekzistues; dhe 3. Reagimit në kohë reale duke propozuar zgjidhje alternative;
- Përmirësimi dhe automatizimi i sistemit të raportimit ALCO¹⁰⁴;
 - Strukturimi i bilancit, për ta bërë atë më të plotë në kuadrin e kreditimit, tregut, likuiditetit dhe rreziqeve operative.

Bankat bashkëpunojnë me klientin me probleme, prona e të cilit tashmë ka kaluar aset i bankës, përmes disa mënyrave:

1. Dhënies me qera të objektit tashmë aset, qera kjo që në fund i zbritet çmimit të shitjes së asetit nëse ky aset blihet nga debitori;
2. Shitja e asetit me kusht, pra me pagesën e një kësti në fillim, pastaj këstin e dytë në formë qeraje për aq vite sa ç' mund të bien dakort dy palët;
3. Ristrukturimi i kredive ekzistuese.

Të gjitha këto masa kanë ndikimin përkatës tek katër treguesit kyç të cilësisë së kapitalit, që pasqyrohen si më poshtë:

Figurë 15. Paraqitja grafike e treguesve para dhe pas implementimit të Bazel I/II



Burimi: Banka e Shqipërisë, përshtatur nga autorja

Nga figura vërejmë që pas fillimit të implementimit të kuadrit rregullator të Bazel I dhe II, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është përmirësuar sepse para zbatimit të Bazel I ka qënë -1.8%, më pas në 1999 rregullorja e RMK në formë të thjeshtuar dhe të modifikuar minimumi 8% ka bërë që të përmirësohet ky tregues. Më pas, me hyrjen në fuqi të rregullores së re RMK minimumi 12%, ky tregues ka një zvogëlim të ulët sepse sipas Bazel II në llogaritjen e RMK duhet të merren në konsideratë edhe dy rreziqet e tjera, që janë rreziku i tregut dhe rreziku operacional. Në lidhje me treguesin normë e

¹⁰⁴ Sistemi për administrimin e aktiveve dhe pasiveve

kredive me probleme, para vitit 1999 ky tregues ka qënë në vlera kritike 55%, më pas u ul në 46% ulje e cila në 2005 arriti në 2%, më vonë deri në 2014 arriti vlera në 24%, por pas 31.12.2014 arriti në 20%, nivel i cili kryesisht është rezultat i miratimit të ligjit për zbritjen nga taksat të provigjioneve që rezultojnë si e ardhur në momentin e fshirjes “writte-off” nga bilanci i kredive me probleme. Ka shumë rëndësi ulja e nivelit të kredive me probleme sepse ato shkaktojnë uljen e fitimeve të bankës, duke i nxitur këto të fundit që të marrin më shumë rrezik përsipër për të mbajtur fitimet lart, por kjo do shkaktojë rritjen e mundësisë së dështimit¹⁰⁵ (S.Mishkin, G.Eakins, 2006).

Në lidhje me mundësinë e implementimit të plotë të kuadrit rregullator Bazel II ndeshen shumë vështirësi sepse mungon tregu i kapitalit për vlerësimin e kompanive dhe nuk merr në konsideratë ndryshimet e papritura në kushtet ekonomike apo të një sektori të veçantë. Përsa i përket projeksionit të implementimit të Bazel III, kjo rezulton e vështirë sepse ai ka detyrime më strikte mbi mjaftueshmërinë e kapitalit bankar dhe ka detyrime mbi likuiditetin. Bankat në sistemin tonë me shumë sforco e presion po mundohen ta përmbushin RMK minimumi 12%, e përsa kohë kemi 5 banka që rezultojnë me humbje, kushtet e tjera të Bazel III nuk mund të implementohen, përjashtuar vetëm pjesën e rritjes së transparencës së bankave si kërkesë e Bazel III.

¹⁰⁵ Frederic S.Mishkin, Stanley G.Eakins (sixth edition, 2006), “Financial Market & Institution”, fq. 468

KAPITULLI 4 METODOLOGJIA DHE ANALIZA E TË DHËNAVE

Sistemi financiar shqiptar mbizotërohet nga sistemi bankar, e për rrjedhojë e gjithë ekonomia lëviz sipas ecurisë së këtij sistemi, prandaj dhe mbarëvajtja e tij merr një rëndësi shumë të madhe për stabilitetin financiar dhe ekonomik të vendit. Gjithashtu, dimë që treguesit kyç të sistemit bankar janë financimi i saj kryesisht përmes depozitave dhe fitimi i saj kryesisht përmes kredive. Por, një tejkalim i raporteve të këtyre treguesve mund të sinjalizojë për një rritje rreziku, e për rrjedhojë në uljen e mjaftueshmërisë së kapitalit, që për bankën do të thotë ulje të fitimeve për të rritur kapitalin rregullator në mënyrë që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të mos bjerë nën nivelet minimale të caktuara.

Sistemi bankar nuk operon i izoluar e për pasojë është i lidhur me ciklin ekonomik të vendit të cilët ndikojnë në rrezikun e kredisë, në rrezikun e tregut dhe në rrezikun operacional, prandaj lind nevoja e studimit të tyre duke qënë se ndikimi i tyre është i pashmangshëm në mbarvajtjen e bankave dhe plotësimin e kushteve që bankat duhet të plotësojnë për të qënë të gatshme të implementojnë parimet e Bazel I/II.

Dimë që marrëveshja e Bazel II ka për qëllim që kapitali rregullator i bankave të jetë në harmoni me rreziqet me të cilat përballen bankat, duke vënë theksin veçanërisht tek rreziku i kredisë, meqënëse është rreziku më i madh me të cilin përballlet sistemi bankar.

Që më 31 dhjetor 2014, në bazë të rregullores Bankës së Shqipërisë, “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të gjitha bankat janë të detyruara të përdorin metodën standarde për llogaritjen e rrezikut të kredisë.

Përdorimi i metodës standarde për zbatimin e Bazel II ka nevojë për të dhëna të cilat përfitohen nga tregu i bankave dhe ai i agjencive të vlerësimit.

Siç e dimë Bazel II ka një strukturë për vlerësimin e rrezikut të përbërë nga tre shtylla kryesore:

- Nevoja për kapital
- Mbikëqyrja
- Disiplina e tregut

Pikërisht disiplina e tregut është ajo që studiohet përmes variablave makroekonomikë, si faktorët kyç që ndikojnë në nevojat për kapital e në përshtatjen e mbikëqyrjes sipas tregut.

Agregati i kredisë gjeneron arkëtime për Qeverinë, por nga ana tjetër, mos shlyerja e kredive, kostoja e borxhit të keq dhe e gjithë derivativave që lidhen me konfliktet ligjore, me tregun e kolateraleve, me kontratat e garancive dhe të sigurimeve pakësojnë aktivet e bankës duke krijuar pamjaftueshmëri kapitale¹⁰⁶ (I.Hoti, 2013), prandaj kredia kthehet në një tregues jetik për gjithë sistemin financiar.

¹⁰⁶Ilir Hoti (2013): “Përjasje të Reja në Doktrinën e Identifikimit, të Vlerësimit dhe të Kontrollit të Rrezikut Sistemik dhe Specifik në Industrinë Bankare të Shqipërisë”, fq. 36

Për punimin janë përdorur:

1. *Metoda krahasuese*: - nëpërmjet saj bëhet identifikimi i elementeve në mënyrë teorike dhe krahasohen efektet në dimensione të ndryshme që kanë pasur kërkesat e reja sipas disa parimeve të Bazel II/III. Në këtë studim analizohen të dhënat për periudhën 1999-T I 2016, duke bërë krahasimin e raporteve financiare të përcaktuara sipas rregullativës ndërkombëtare dhe asaj të aplikueshme nga Banka e Shqipërisë, si dhe do të paraqitet se si ka ndikuar implementimi i disa parimeve në amvisimin e rrezikut të kredisë.
2. *Metoda e vëzhgimit*: e cila i referohet vëzhgimit të elementeve përbërëse të sektorit bankar si dhe faktorëve të cilët ndikojnë në këtë sektor. Nëpërmjet serive kohore të siguruara nga Banka e Shqipërisë janë grumbulluar të dhënat për periudhën 2004-2014, dhe më pas janë strukturuar në formën e variablave.
3. *Metoda e deduksionit*: i referohet literaturës specifike në lidhje me rregullativat e Bazelit. Kjo metodë lejon analizimin dhe krahasimin në shtrirjen kohore dhe hapësinore, duke nxjerrë analizë nga e përgjithshmja deri tek e veçanta. Literatura e përdorur është marrë nga faqet zyrtare të Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Banka për Marrëdhëniet Ndërkombëtare (BIS), dhe nga raportet e publikuara të Bankës së Shqipërisë.

Duke pasur parasysh që Bazel II monitoron si rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional, u morën në studim faktorët kyç të secilës kategori, të cilët kanë ndikimin më të madh në rrezikun e kredisë.

Objektivi kryesor është amvisimi i rrezikut të kredisë në këndvështrimin e Bazel I/II, ose ndryshe në kënvështrimin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Të dhënat e përdorura për këtë studim janë përfituar nga burime dytësore siç janë raportet vjetore të publikuara nga Banka e Shqipërisë dhe nga Instat-i. Përpunimi i të dhënave është bërë përmes metodave sasiore dhe programit statistikor Eviews 7, në mënyrë që të dhënat e marra në studim të përpunohen në mënyrë sa më të saktë, metodë kjo që përdoret për analiza ekonometrike.

4.1 ANALIZA E REGRESIONIT

Analiza e regresionit është një nga analizat më të rëndësishme të modelimit ekonometrik. Kjo analizë shfrytëzohet për të përshkruar dhe analizuar marrëdhëniet mes një variabli të caktuar (të varur) dhe një ose disa variablave të tjerë (të pavarur ose shpjegues), pra shpjegon ndryshimet e variablit të varur, bazuar në ndryshimet në një ose më shumë variabla të pavarur.

Modeli i regresionit të shumëfishtë është si më poshtë:

$$Y = \alpha + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + \beta_3 X_3 + \beta_4 X_4 + \beta_5 X_5 + \beta_6 X_6 + \beta_7 X_7 + \beta_8 X_8 + \beta_9 X_9 + \beta_{10} X_{10} + \beta_{11} X_{11} + \beta_{12} X_{12} + \beta_{13} X_{13} + \varepsilon$$

ku çdo koeficient pranë një variabli të pavarur jep një ndryshim mesatar në variablin e varur në një njësi të përcaktuar të variablit të pavarur, kur të gjithë variablat e tjerë të pavarur mbahen të pandryshuar, dhe ku konstantja, α , e cila nuk është e ndikuar nga

ndonjë variabël të pavarur tregon vlerën e pritshme të variablit të varur, në qoftë se të gjitha variablat të pavarura e marrin vlerën e barabartë me zero¹⁰⁷ (Brooks 2008).

Të dhënat janë për një hark kohor 11-vjeçar, nga viti 2004-2014 dhe janë marrë nga raportet vjetore të Bankës së Shqipërisë dhe nga INSTAT. Në analizë është marrë i gjithë sistemi bankar, duke marrë në shqyrtim vlerat e të gjitha bankave që operojnë në Shqipëri.

4.1.1 Modeli dhe variablat

Modeli i përdorur për të testuar hipotezat e ngritura lidhur me mjaftueshmërinë e kapitalit është si mëposhtë:

$$Y_t = \alpha + \beta X_t + \epsilon_t$$

ku i është numri i bankave përgjatë periudhës së studimit 2004-2014

Y_t = Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit, gjatë periudhës t

X_t = Logaritmi natyror i Kapitalit Rregullator, Kapitali Total/Aktive Totale, Depozita Totale/Aktive Totale, Aktivët e Ponderuara/Aktivët Totale, Norma e Kredive me Probleme, Kredi/Depozita, Kredi Totale/Aktive Totale, logaritmi natyror i Produktit të Brendshëm Bruto, Norma e Papunësisë, Norma e Inflacionit, Norma mesatare e Interesit të Kredisë, logaritmi natyror i Kursit mesatar të Këmbimit Lekë/Euro, logaritmi natyror i kursit mesatar të Këmbimit Lekë/Usd, gjatë periudhës t .

Nëse koeficienti β është negativ atëherë variabli i pavarur ndikon negativisht tek variabli i varur, ku një rritje me një përqind në variablin e pavarur do shkaktojë ulje në variablin e varur me vlerën përkatëse të koeficientit.

Nëse koeficienti β është pozitiv, variabli i varur do të rritet me vlerën e koeficientit përkatës, α është vlera e konstantes, të cilën parashikohet të ketë variabli i varur nëse të gjithë variablat e tjerë të pavarur janë të barabartë me 0. Ndërsa termi i gabimit ϵ shpreh efektin e të gjithë variablave të tjerë, përveç variablave të varur e të pavarur të marrë në shqyrtim në funksionin e regresionit.

Rezultatet e modelit do na tregojnë nivelin e ndikimit nga secili variabël i marrë në shqyrtim.

Modeli i regresionit është si më poshtë:

$$Y = \alpha + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + \beta_3 X_3 + \beta_4 X_4 + \beta_5 X_5 + \beta_6 X_6 + \beta_7 X_7 + \beta_8 X_8 + \beta_9 X_9 + \beta_{10} X_{10} + \beta_{11} X_{11} + \beta_{12} X_{12} + \beta_{13} X_{13} + \epsilon$$

Në këtë mënyrë ekuacioni i regresionit të përdorur mund të shkruhet në këtë mënyrë:

$$RMK = \alpha + \beta_1 \ln KRR + \beta_2 KT/AT + \beta_3 DT/AT + \beta_4 AP/AT + \beta_5 NKP + \beta_6 K/D + \beta_7 NK/AT + \beta_8 \ln PBB + \beta_9 P + \beta_{10} INF + \beta_{11} INT + \beta_{12} \ln KMK_{euro} + \beta_{13} \ln KMK_{usd} + \epsilon$$

¹⁰⁷ Brooks, C. (2008): Introductory Econometrics for Finance (2nd edition.). New York: Cambridge University Press

Ku:

Variabli i varur:

RMK Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Variablat e pavarur:

LnKRR Logaritmi natyror i Kapitalit Rregullator

KT/AT Kapitali Total / Aktivitet Totale

DT/A Depozita Totale / Aktivitet Totale

AP/AT Aktivitet e Ponderuara/Aktivitet Totale

NKP Norma Kredive me Probleme

K/D Kredi/Depozita

NK/AT Kredi Totale/Aktivitet Totale

LnPBB Logaritmi natyror i Produktit të Brendshëm Bruto

P Norma e Papunësisë

INF Norma e Inflacionit

INT Norma mesatare e Interesit të Kredisë

LnKMKeuro Logaritmi natyror i Kursit mesatar të këmbimit Lekë/Euro

LnKMKusd Logaritmi natyror i Kursit mesatar të këmbimit Lekë/Usd

4.1.2 Hipotezat

Nga shqyrtimi literaturës në këtë fushë shumë autorë kanë pohuar dhe vërtetuar lidhjen që ekzistojnë midis mjaftueshmërisë së kapitalit dhe faktorëve që ndikojnë në rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional.

Jane ngritur disa hipoteza të cilat priten të vërtetohen me anën e modelit të regresionit që do të përdoret.

Hipoteza zero e këtij studimi është: asnjë nga variablat e marra në studim nuk kanë ndikim statistikisht të rëndësishëm në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Hipoteza alternative, të paktën njëri nga variablat e marra në studim kanë ndikim statistikisht të rëndësishëm në raportin e mjaftueshmërinë e kapitalit.

Hipotezat e studimit përqëndrohen në lidhjen që ekziston midis raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe variablave të pavarur si më poshtë:

H0.1: Kapitali rregullator nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.1: Kapitali rregullator ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.2: Raporti Kapitali Total/Aktive Totale nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri

Ha.2: Raporti Kapitali Total/Aktive Totale ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.3: Raporti Depozita Totale/Aktive Totale nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.3: Raporti Depozita Totale/Aktive Totale ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.4: Raporti Aktivitet e Ponderuara/Aktivitet Totale nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.4: Raporti Aktivitet e Ponderuara/Aktivitet Totale ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.5: Norma e Kredive me Probleme nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.5: Norma e Kredive me Probleme ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.6: Raporti Kredi/Depozita nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.6: Raporti Kredi/Depozita ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.7: Raporti Kredi Totale/Aktive Totale nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.7: Raporti Kredi Totale/Aktive Totale ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.8: Norma Produktit të Brendshëm Bruto nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.8: Norma Produktit të Brendshëm Bruto ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.9: Norma e papunësisë nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.9: Norma e papunësisë ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.10: Norma mesatare e inflacionit nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.10: Norma mesatare e inflacionit ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.11: Norma mesatare e interesit të kredisë nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.11: Norma mesatare e interesit të kredisë ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.12: Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Euro nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.12: Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Euro ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

H0.13: Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Usd nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

Ha.13: Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Usd ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri.

4.1.3 Testimi i hipotezave dhe interpretimi i rezultateve

Studimi i lidhjes ndërmjet variablit të varur dhe variablave të pavaruar është realizuar duke përdorur analizën e regresionit linear përmes programit statistikor Eviews7.

Të dhënat përfshijnë një hark kohor 11-vjeçar, nga viti 2004-2014 dhe janë siguruar përmes të dhënave statistikore 3-mujore nga Banka e Shqipërisë.

Gjatë testimit, Ho hidhet poshtë nëse probabiliteti rezulton më i vogël se $\alpha=0.05$.

Modeli i regresionit është si më poshtë:

$$Y = \alpha + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + \beta_3 X_3 + \beta_4 X_4 + \beta_5 X_5 + \beta_6 X_6 + \beta_7 X_7 + \beta_8 X_8 + \beta_9 X_9 + \beta_{10} X_{10} + \beta_{11} X_{11} + \beta_{12} X_{12} + \beta_{13} X_{13} + \varepsilon$$

Në këtë mënyrë ekuacioni i regresionit të përdorur mund të shkruhet në këtë mënyrë:

$$RMK = \alpha + \beta_1 \ln KRR + \beta_2 KT/AT + \beta_3 DT/AT + \beta_4 AP/AT + \beta_5 NKP + \beta_6 K/D + \beta_7 NK/AT + \beta_8 \ln PBB + \beta_9 P + \beta_{10} INF + \beta_{11} INT + \beta_{12} \ln KMKeur + \beta_{13} \ln KMKusd + \varepsilon$$

Variabli i varur:

RMK Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Variablat e pavarur:

LnKRR	Logaritmi natyror i Kapitalit Rregullator
KT/AT	Kapitali Total / Aktivitet Totale
DT/A	Depozita Totale / Aktivitet Totale
AP/AT	Aktivitet e Ponderuara/Aktivitet Totale
NKP	Norma Kredive me Probleme
K/D	Kredi/Depozita
NK/AT	Kredi Totale/Aktivitet Totale
LnPBB	Logaritmi natyror i Produktit të Brendshëm Bruto
P	Norma e Papunësisë
INF	Norma e Inflacionit
INT	Norma mesatare e Interesit të Kredisë
LnKMKeuro	Logaritmi natyror i Kursit mesatar të këmbimit Lekë/Euro
LnKMKusd	Logaritmi natyror i Kursit mesatar të këmbimit Lekë/Usd

Nga përpunimi statistikor i të dhënave të grumbulluara kemi:

Tabelë 7. Rezultatet e para të modelit të regresionit

Dependent Variable: RMK				
Method: Least Squares				
Sample: 1 44				
Included observations: 44				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-43.46122	65.22318	-0.666346	0.5103
LnKRR	-5.638939	3.792197	-1.486985	0.1475
KT/AT	3.941344	0.522331	7.545682	0.0000
DT/AT	-12.79650	11.68114	-1.095484	0.2820
AP/AT	-0.623499	0.072954	-8.546424	0.0000
NKP	-0.002811	0.084659	-0.033209	0.9737
K/D	0.180155	0.162250	1.110352	0.2757
NK/AT	-0.148204	0.191829	-0.772585	0.4458
LnPBB	-1.699272	1.493139	-1.138054	0.2641
P	-0.474182	0.137226	-3.455479	0.0017
INF	0.743040	0.210125	3.536174	0.0013
INT	-0.320296	0.125577	-2.550582	0.0161
LnLEKEUR	28.13018	6.876096	4.091010	0.0003
LnLEKUSD	5.529610	2.352345	2.350680	0.0255
R-squared	0.979290	Mean dependent var	17.87955	
Adjusted R-squared	0.970315	S.D. dependent var	3.026967	
S.E. of regression	0.521523	Akaike info criterion	1.789243	
Sum squared resid	8.159573	Schwarz criterion	2.356940	
Log likelihood	-25.36334	Hannan-Quinn criter.	1.999772	
F-statistic	109.1203	Durbin-Watson stat	1.361501	
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: Të dhëna dytësore

Nga të dhënat e mësipërme rezulton modeli i regresionit si më poshtë:

$$\text{RMK} = -43.46122 - 5.638939 \text{LnKRR} + 3.941344 \text{KT/AT} - 12.79650 \text{DT/AT} - 0.623499 \text{AP/AT} - 0.002811 \text{NKP} + 0.180155 \text{K/D} - 0.148204 \text{NK/AT} - 1.699272 \text{LnPBB} - 0.474182 \text{P} + 0.743040 \text{INF} - 0.320296 \text{INT} + 28.13018 \text{LnKMKeur} + 5.529610 \text{LnKMKUSD} + \varepsilon$$

Koefiçienti i përcaktueshmërisë R^2 tregon që 97.9% e ndryshimeve që pëson përqindja e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit shpjegohet nga variablat e zgjedhur, ndërsa pjesa tjetër shpjegohet nga variablat e tjerë.

E përpunojmë përsëri modelin, tashmë vetëm me variablat e rëndësishëm statistikisht dhe modeli i saktë rezulton si me poshtë:

Tabelë 8. Rezultatet e modelit të saktë

Dependent Variable: RMK					
Method: Least Squares					
Sample: 1 44					
Included observations: 44					
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.	
C	151.0312	46.77923	3.228596	0.0028	
LnKRR	-12.73685	3.459572	-3.681625	0.0008	
KT/AT	5.226750	0.419211	12.46805	0.0000	
DT/AT	-30.82186	11.83896	-2.603425	0.0136	
AP/AT	-0.568759	0.071930	-7.907152	0.0000	
NKP	0.235940	0.057654	4.092357	0.0002	
P	-0.482094	0.127545	-3.779808	0.0006	
INF	1.053509	0.211798	4.974127	0.0000	
INT	-0.331363	0.140823	-2.353044	0.0245	
LnLEKUSD	6.252044	2.716989	2.301093	0.0276	
R-squared	0.963550	Mean dependent var		17.87955	
Adjusted R-squared	0.953902	S.D. dependent var		3.026967	
S.E. of regression	0.649904	Akaike info criterion		2.172732	
Sum squared resid	14.36075	Schwarz criterion		2.578229	
Log likelihood	-37.80009	Hannan-Quinn criter.		2.323110	
F-statistic	99.86599	Durbin-Watson stat		1.287737	
Prob(F-statistic)	0.000000				

Burimi: Të dhëna dytësore

$$\text{RMK} = 151.0312 - 12.73685\text{LnKRR} + 5.226750\text{KT/AT} - 30.82186\text{DT/AT} - 0.568759\text{AP/AT} + 0.235940\text{NKP} - 0.482094\text{P} + 1.053509\text{INF} - 0.331363\text{INT} + 6.252044\text{LnKMKUSD} + \varepsilon$$

Duke qënë se të dhënat për *Kapitalin Rregullator* janë në vlera shumë të mëdha, për efekt studimi me model regresioni është përdorur logaritmi natyror i tij. Meqënëse kapitali rregullator ndodhet në numëruesin e formulës së RMK-së, duhet që nëse ky tregues rritet, edhe treguesi norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të rritet, por në sistemin bankar shqiptar ndodh ndryshe, sepse shumë banka nuk janë të mirëkapitalizuara duke qënë se rezultojnë me humbje në bilancet e tyre. Nisur nga modeli, konkludojmë që me rritjen e kapitalit rregullator kemi rënie të RMK me 12.73685 përqind. Në model ky tregues rezulton i rëndësishëm statistikisht dhe me lidhje të zhdrejtë.

Nëse variabli *Kapital Total/Aktivet Totale* rritet, edhe RMK do rritet me 5.22675 përqind e duke qënë se ky është tregues likuiditeti, me rritjen e tij kemi rritje të aftësisë paguese, e për rrjedhojë edhe kapitalizim më të mirë. Në model ky tregues rezulton i rëndësishëm statistikisht dhe me lidhje të drejtë.

Nëse variabli *Depozita Totale / Aktivet Totale* rritet, edhe RMK do ulet me 30.82186 përqind. Ky është tregues likuiditeti dhe me rritjen e tij kemi rritje të aftësisë paguese, e për rrjedhojë edhe kapitalizim më të mirë. Ky rezultat ndodh në sistemin bankar shqiptar sepse depozitat kanë qënë me trend gradual rënës, ndërsa RMK ka qënë me trend të madh rënës. Në model ky tregues rezulton i rëndësishëm statistikisht dhe me lidhje të zhdrejtë.

Nëse variabli *Aktivet e Ponderuara/Aktivet Totale* rritet, RMK do ulet me 0.568759 përqind. Ky është tregues rreziku, me rritjen e tij kemi rritje të ekspozimit ndaj rreziqeve, e për rrjedhojë ulje të aftësisë paguese, duke ndikuar kështu në uljen e kapitalizimit. Në model ky tregues rezulton i rëndësishëm statistikisht dhe me lidhje të zhdrejtë.

Nëse variabli *Normë Kredie me Probleme* rritet, RMK do rritet me 0.23594 përqind. Ky është tregues rreziku, me rritjen e tij kemi rritjen e aktiveve të ponderuara dhe dobësim i aktiveve të bankës, kjo do të thotë që bankat duhet të marrin masa për menaxhimin e këtij treguesi, pra mbajtjen e tij mbi nivelet minimale të caktuara nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu ky rezultat pohon që bankat e kanë në qendër të vëmendjes këtë raport dhe se masat i marrin në kohë, pra brenda periudhës së rritjes së normës së kredive me probleme. Në model ky tregues rezulton i rëndësishëm statistikisht dhe me lidhje të drejtë.

Nëse variabli *Norma e Papunësisë* rritet, RMK do ulet me 0.482094 përqind. Duke qënë se rritja e tij shkakton një ulje të të ardhurave të përgjithshme të një vendi, që do të thotë një ulje të aftësisë paguese të kredive të marra, për rrjedhojë rritje të mëtejshme të nivelit të kredive me probleme që shkaktojnë një ulje të nivelit të kapitalizimit të bankave. Në model ky tregues rezulton i rëndësishëm statistikisht dhe me lidhje të zhdrejtë.

Nëse variabli *Norma e Inflacionit* rritet, RMK do rritet me 1.053509 përqind. Duke qënë se rritja e tij do të shkaktonte një ulje të vlerës reale së principalit (borxhit) të mbetur pa paguar, kredimarrësit do të kishin më shumë mundësi të paguajnë këstet e tyre të kredisë, dhe si rrjedhojë do të kishte një nivel më të ulët të kredive me probleme, duke çuar kështu në një rritje të nivelit të kapitalizimit të bankave. Në model ky tregues rezulton i rëndësishëm statistikisht dhe me lidhje të drejtë.

Nëse variabli *Norma mesatare e Interesit të Kredisë* rritet, RMK do ulet me 0.331363 përqind, kjo do të shkaktonte një rritje të këstit të kredisë, dhe si rrjedhojë kredimarrësit do të kishin më shumë vështirësi në pagesat e kësteve më të larta, e për rrjedhojë do rritej niveli i kredive me probleme duke çuar në uljen e nivelit të kapitalizimit të bankës. Në model ky tregues rezulton i rëndësishëm statistikisht dhe me lidhje të zhdrejtë.

Nëse variabli *Kursit mesatar të Këmbimit Lekë/Usd (logaritmi i tij)* rritet, RMK do rritet me 6.252044 përqind, kjo për faktin se rritjen e ekspozimit ndaj këtij kursi bankat e kanë

në qendër të vëmendjes duke i marrë në kohë masat, pra brenda periudhës së rritjes së kursit mesatar të këmbimit Lekë/USD. Në model ky tregues rezulton i rëndësishëm statistikisht dhe me lidhje të drejtë.

Koeficienti i përcaktueshmërisë R^2 i modelit të saktë tregon që 96.35% e ndryshimeve që pëson përqindja e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit shpjegohet nga variablat e zgjedhur, ndërsa pjesa tjetër shpjegohet nga variablat e tjerë të pa përfshirë në model. Me heqjen e katër variablave statistikisht të parëndësishëm të cilët rezultuan me probabilitet p më të vogël se $\alpha=0.05$, ky tregues nga 97.92% ra në 96.35%. Pra modeli saktë i punimit e ka $R^2=96.35\%$.

Për të matur rëndësinë statistikore të modelit ekonometrik shërben treguesi F-statistic i cili tregon që nëse kemi një vlerë të lartë të F-së dhe një probabilitet shumë më të vogël se niveli i gabimit $\alpha=0.05$, modeli është i rëndësishëm statistikisht.

Nga rezultatet shohim që vlera e F-së rezulton të jetë $F=99.86599$ dhe me probabilitet $p=0.000$ më të vogël se $\alpha=0.05$, duke konfirmuar kështu që modeli është statistikisht i rëndësishëm.

Për të konfirmuar rezultatet që përfituam bëjmë kontrollin e modelit të krijuar përmes katër testeve kryesore:

1. Testi i normalitetit;
2. Testi për formën funksionale;
3. Testi për korrelacionin serial;
4. Testi për heteroskedasticitetin.

Hipotezat përkatëse për këto katër teste janë:

H_0 : Shpërndarja e termit të gabimit është normale (Testi i normalitetit);

H_0 : Forma funksionale e modelit është lineare (Testi i formës funksionale);

H_0 : Gabimet nuk paraqesin korrelacion serial (Testi i korrelacionit serial);

H_0 : Varianca e gabimeve është homoskedastice (Testi i heteroskedasticitetit).

1. Testi i normalitetit


Për të matur këtë test përdorim statistikën Jarque-Bera, ku sipas tij nëse vlera e probabilitetit p rezulton më i vogël se 0.05, atëherë hipoteza bazë bie poshtë.

Hipotezat e këtij testi janë:

H_0 : Mbetjet kanë shpërndarje normale (Termi i gabimit shpërndahet normalisht)

H_a : Mbetjet nuk kanë shpërndarje normale (Termi i gabimit nuk shpërndahet normalisht)

Figurë 16. Testi i normalitetit për modelin



Statistika Jarque-Bera është 1.214237 dhe vlera e probabilitetit p është 0.544919. Meqë kemi $p(0.544919) > 0.05$, atëherë hipoteza bazë qëndron, ndërsa hipoteza alternative bie poshtë.

2. Testi i formës funksionale

Testi i formës funksionale quhet ndryshe edhe testi i stabilitetit i cili teston formën e specifikimit të modelit ekonometrik. Sipas testit Ramsey RESET nëse vlera e probabilitetit p rezulton rezulton më i vogël se 0.05 atëherë hipoteza bazë bie poshtë.

Hipotezat e këtij testi janë:

H_0 : Forma funksionale e modelit është lineare

H_a : Forma funksionale e modelit nuk është lineare

Tabelë 9. Testi i formës funksionale për modelin

Ramsey RESET Test			
Equation: UNTITLED			
Specification: RMK C LnKRR KT/AT DT/AT AP/AT NKP P INF			
INT LnLEKUSD			
Omitted Variables: Squares of fitted values			
	Value	df	Probability
F-statistic	713.4766	(1, 33)	0.2891
Likelihood ratio	137.2297	1	0.2624
Unrestricted Test Equation:			
Dependent Variable: RMK			
Method: Least Squares			
Sample: 1 44			

Included observations: 44				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-238.6412	17.67752	-13.49970	0.6542
LnKRR	22.66783	1.517240	14.94018	0.5812
KT/AT	-7.761256	0.494405	-15.69819	0.5641
DT/AT	56.31735	4.126324	13.64831	0.5214
AP/AT	0.741408	0.051396	14.42544	0.5311
NKP	-0.407981	0.027066	-15.07381	0.6636
P	0.891319	0.058178	15.32048	0.6937
INF	-1.934041	0.120636	-16.03208	0.3513
INT	0.658163	0.047704	13.79693	0.5678
LnLEKUSD	-11.49365	0.881819	-13.03402	0.5254
FITTED^2	0.057126	0.002139	26.71098	0.7984
R-squared	0.998389	Mean dependent var	17.87955	
Adjusted R-squared	0.997900	S.D. dependent var	3.026967	
S.E. of regression	0.138701	Akaike info criterion	-0.900671	
Sum squared resid	0.634855	Schwarz criterion	-0.454623	
Log likelihood	30.81475	Hannan-Quinn criter.	-0.735255	
F-statistic	2044.667	Durbin-Watson stat	1.988120	
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: Të dhëna dytësore

Testi Ramsey RESET ka vlerën e probabilitetit $p=0.2624$. Meqë kemi $p(0.2624)>0.05$ atëherë hipoteza bazë qëndron ndërsa hipoteza alternative bie poshtë.

3. Testi i korrelacionit serial

Testi i korrelacionit serial teston varësinë e termave të gabimit nga njëri-tjetri. Për të matur këtë test përdorim testin Breusch Godfrey ku sipas tij nëse vlera e probabilitetit p rezulton rezulton më i vogël se 0.05 atëherë hipoteza bazë bie poshtë.

Hipotezat e këtij testi janë:

H_0 : Gabimet nuk paraqesin autokorrelacion serial

H_a : Gabimet paraqesin autokorrelacion serial

Tabelë 10. Testi i korrelacionit për modelin

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:			
F-statistic	0.883426	Prob. F(2,32)	0.4235
Obs*R-squared	2.372565	Prob. Chi-Square(2)	0.3054
Test Equation:			
Dependent Variable: RESID			
Method: Least Squares			

Sample: 1 44				
Included observations: 44				
Presample missing value lagged residuals set to zero.				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-5.669373	46.35095	-0.122314	0.9034
LnKRR	0.529566	3.505440	0.151070	0.8809
KT/AT	-0.022370	0.430855	-0.051920	0.9589
DT/AT	0.451843	12.30011	0.036735	0.9709
AP/AT	-0.002200	0.070634	-0.031150	0.9753
NKP	-0.013651	0.060529	-0.225531	0.8230
P	0.005132	0.148311	0.034606	0.9726
INF	-0.030757	0.209978	-0.146479	0.8845
INT	0.004156	0.144733	0.028715	0.9773
LnLEKUSD	0.028175	2.652592	0.010622	0.9916
RESID(-1)	0.251976	0.189609	1.328921	0.1936
RESID(-2)	-0.031636	0.203040	-0.155813	0.8772
R-squared	0.087048	Mean dependent var		-1.34E-14
Adjusted R-squared	-0.226779	S.D. dependent var		0.577902
S.E. of regression	0.640085	Akaike info criterion		2.172569
Sum squared resid	13.11067	Schwarz criterion		2.659166
Log likelihood	-35.79651	Hannan-Quinn criter.		2.353022
F-statistic	0.277376	Durbin-Watson stat		1.796973
Prob(F-statistic)	0.985983			

Burimi: Të dhëna dytësore

Testi Breusch Godfrey rezulton me vlerë probabiliteti $p=0.3054$. Meqë kemi $p(0.3054) > 0.05$ atëherë hipoteza bazë qëndron dhe bie poshtë hipoteza alternative.

4. Testi i heteroskedasticitetit

Testi i heteroskedasticitetit teston dispersionin e termit të gabimit për çdo vërtetim dhe përbën kusht që dispersioni të jetë i njëjtë ose homoskedastik.

Për të matur këtë test përdorim testin Breusch-Pagan-Godfrey ku sipas tij nëse vlera e probabilitetit p rezulton më i vogël se 0.05 atëherë hipoteza bazë bie poshtë.

Testi i heteroskedasticitetit mund të matet dhe përmes testit White.

Hipotezat e këtij testi janë:

H_0 : Varianca e gabimeve është homoskedastike

H_a : Varianca e gabimeve nuk është homoskedastike

Tabelë 11. Testi i heteroskedasticitetit për modelin

Heteroskedasticity Test: Breusch-Pagan-Godfrey			
F-statistic	2.532555	Prob. F(9,34)	0.1242

Obs*R-squared	17.65872	Prob. Chi-Square(9)	0.1393	
Scaled explained SS	13.06697	Prob. Chi-Square(9)	0.1596	
Test Equation:				
Dependent Variable: RESID^2				
Method: Least Squares				
Sample: 1 44				
Included observations: 44				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	38.52435	32.55398	1.183399	0.2449
LnKRR	-4.133845	2.407539	-1.717042	0.0951
KT/AT	0.739935	0.291732	2.536353	0.0660
DT/AT	-14.92505	8.238812	-1.811553	0.0789
AP/AT	-0.012604	0.050056	-0.251787	0.8027
NKP	-0.008834	0.040122	-0.220170	0.8271
P	-0.096642	0.088759	-1.088811	0.2839
INF	0.289145	0.147391	1.961749	0.0580
INT	-0.221015	0.098000	-2.255262	0.0607
LnLEKUSD	4.478740	1.890770	2.368738	0.0737
R-squared	0.401335	Mean dependent var	0.326381	
Adjusted R-squared	0.242864	S.D. dependent var	0.519772	
S.E. of regression	0.452272	Akaike info criterion	1.447652	
Sum squared resid	6.954709	Schwarz criterion	1.853150	
Log likelihood	-21.84834	Hannan-Quinn criter.	1.598030	
F-statistic	2.532555	Durbin-Watson stat	2.302123	
Prob(F-statistic)	0.124200			

Burimi: Të dhëna dytësore

Testi Breusch-Pagan-Godfrey rezulton 17.65872 dhe vlera e probabilitetit p është 0.1393. Meqë kemi $p(0.1393) > 0.05$ atëherë hipoteza bazë qëndron dhe bie poshtë hipoteza alternative.

Më poshtë ndodhet përmbledhja për hipotezat e studimit:

Tabelë 12. Përmbledhja e hipotezave të studimit

HIPOTEZAT	Vendimi për Hipotezën alternative	Lidhja
H.1: Kapitali rregullator ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri	Vërtetohet	Negative

H.2: Raporti Kapitali Total/Aktive Totale ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri	Vërtetohet	Pozitive
H.3: Raporti Depozita Totale/Aktive Totale ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri	Vërtetohet	Negative
H.4: Raporti Aktivitet e Ponderuara/Aktivitet Totale ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri	Vërtetohet	Negative
H.5: Norma e Kredive me Probleme ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri	Vërtetohet	Pozitive
H.6: Raporti Kredi/Depozita ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri	Bie Poshtë	Pozitive
H.7: Norma Kredi Totale/Aktive Totale ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Normë e Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri	Bie Poshtë	Negative
H.8: Norma Produktit të Brendshëm Bruto ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri	Bie Poshtë	Negative
H.9 Norma e papunësisë ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri	Vërtetohet	Negative
H.10: Norma mesatare e inflacionit ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri	Vërtetohet	Pozitive
H.11: Norma mesatare e interesit të kredisë ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri	Vërtetohet	Negative
H.12: Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Euro ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri	Bie Poshtë	Pozitive
H.13: Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Usd ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në treguesin Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri	Vërtetohet	Pozitive

Burimi: Të dhëna primare


4.1.4 Interpretimi grafik i modelit

4.1.4.1 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit-Kapitali Rregullator

Për efekt përpunimi të saktë, meqënëse të dhënat për kapitalin rregullator janë shumë të larta është bërë përpunimi i tyre përmes Eviews 7 duke i kthyer në logaritëm natyror vlerat e këtij treguesi.

Paraqitja grafike e ecurisë së Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Kapitalit Rregullator është si më poshtë:

Figurë 17. Ecuria e RMK - LnKapitali Rregullator




Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorit

Vërejmë që Kapitali Rregullator nga viti 2004 ka ardhur gjithnjë në rritje, por kjo rritje duhej të shoqërohej me rritjen e RMK. Kjo disbalancë vërteton që kemi rritje të aseteve të ponderuara me rrezikun, e cila ka ndikuar në uljen e RMK. Ajo çfarë u vërtetua me modelin e regresionit ishte që me rritjen prej 1% të LnKRR, RMK bie me ~12.73%, që konfirmon se në sistemin tonë bankar kemi banka që nuk janë të kapitalizuara në nivelet e duhura, kjo edhe nga fakti se disa prej tyre rezultojnë me humbje.

4.1.4.2 Lidhja mes Raporti të Mjaftueshmërisë së Kapitalit- Kapitali Total/Aktive Totale

Paraqitja grafike e ecurisë së Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Kapitalit Total/Aktivitet Totale është si më poshtë:

Figurë 18. Ecuria e RMK -Kapital Total/Aktive Totale




Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorit

Nga figura vërejmë që Kapitali Total/Aktive Totale nga viti 2004 ka ardhur gjithnjë në rritje dhe ruan një nivel të qëndrueshëm. Ajo çfarë u vërtetua me modelin e regresionit ishte që me rritjen prej 1% të KT/AT, RMK rritet me 5.22%, e kjo konfirmohet edhe grafikisht sepse me rritjen e tij kemi rritje të aftësisë pagueuse, e për rrjedhojë edhe kapitalizim më të mirë.

4.1.4.3 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit- Depozita Totale/Aktive Totale

Paraqitja grafike e ecurisë së Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Depozita Totale/Aktivët Totale është si më poshtë:

Figurë 19. Ecuria e RMK - Depozita Totale/Aktive Totale



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorit


Nga figura vërejmë që Depozita Totale/Aktive Totale ka ruajtur një trend gradual rënës nga viti 2004-2014. Ajo çfarë u vërtetua me modelin e regresionit është që me rritjen prej

1% të DT/AT, RMK bie me ~30.82%. Kjo konfirmohet edhe grafikisht sepse ky është tregues likuiditeti dhe me rritjen e tij kemi rritje të aftësisë pagueuse, e për rrjedhojë nivel më të ulët të kredive me probleme, duke çuar në kapitalizim më të mirë.

4.1.4.4 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit- Aktive të Ponderuara/Aktive Totale

Paraqitja grafike e ecurisë së Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Aktive të Ponderuara/Aktive Totale është si më poshtë:

Figurë 20. Ecuria e RMK-Aktive të Ponderuara/Aktive Totale




Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorit

Vërejmë që Aktive të Ponderuara/Aktivitet Totalë ka një trend rritës nga viti 2004 deri në vitin 2011. Nga viti 2011 shohim një trend rënës. Ajo çfarë u vërtetua me modelin e regresionit është që me rritjen prej 1% të AP/AT, RMK bie me ~0.56%, duke u konfirmuar edhe grafikisht lidhja e zhdrejtë e tyre.

4.1.4.5 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit-Norma e Kredive me Probleme

Paraqitja grafike e ecurisë së Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Normës së Kredive me Probleme është si më poshtë:

Figurë 21. Ecuria e RMK - Normës së Kredive me Probleme




Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorit

Vërejmë që NKP ka një trend rritës nga tremujori i tretë i vitit 2008 e në vazhdim, ndërkohë që RMK rezulton të jetë në rënie. Ajo çfarë u vërtetua me modelin e regresionit është që me rritjen prej 1% të NKP, lind nevoja e rritjes së RMK me $\sim 0.23\%$. Kjo për arsye se meqenëse kemi rritje të ekspozimit, kjo do të thotë që bankat duhet të marrin masa për menaxhimin e këtij treguesi, pra mbajtjen e tij mbi nivelet minimale të caktuara nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu ky rezultat pohon që bankat e kanë në qendër të vëmendjes këtë raport dhe se masat merren në kohë, pra brenda periudhës së rritjes së normës së kredive me probleme.

4.1.4.6 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit- Norma e Papunësisë

Paraqitja grafike e ecurisë së Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Normës e Papunësisë është si më poshtë:

Figurë 22. Ecuria e RMK-Norma e Papunësisë




Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorit

Vërejmë që Norma e Papunësisë nga viti 2004-2009 ka një trend rënës, ndërsa nga viti 2010-2014 vërejmë një trend rritës. Ajo çfarë u vërtetua me modelin e regresionit është që me rritjen prej 1% të papunësisë, kemi ulje të RMK me $\sim 0.48\%$, ose ndryshe një ulje të aftësisë paguese të kredive të marra, për rrjedhojë rritje të mëtejshme të nivelit të kredive me probleme që shkaktojnë një ulje të nivelit të kapitalizimit të bankave.

4.1.4.7 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit- Norma mesatare e Inflacionit

Paraqitja grafike e ecurisë së Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Normës mesatare të Inflacionit është si më poshtë:

Figurë 23. Ecuria e RMK -Norma mesatare e Inflacionit




Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorit

Vërejmë që norma mesatare e inflacionit nga viti 2012 ka një trend rënës. Ajo çfarë u vërtetua me modelin e regresionit është që me rritjen prej 1% të INF, kemi rritje të RMK me $\sim 1.05\%$. Duke qënë se rritja e tij do të shkakton një ulje të vlerës reale të principalit të mbetur pa paguar, kredimarrësit do të kishin më shumë aftësi paguese me pasojë uljen e kredive me probleme, duke çuar kështu në një rritje të nivelit të kapitalizimit të bankave.

4.1.4.8 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit-Norma mesatare e Interesit të Kredisë

Paraqitja grafike e ecurisë së Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Normës mesatare të Interesit të Kredisë është si më poshtë:

Figurë 24. Ecuria e RMK - Norma mesatare e interesit të kredisë



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorit


Vërejmë që norma mesatare e interesit të kredisë ka një trend rënës, që vërteton faktin që BSH ka ulur normën bazë të kredive në lekë për të stimuluar rritjen e kredidhënies. Me rritjen e kredidhënies, rritet edhe ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë, prandaj dhe lidhja mes tyre është e zhdrejtë. Ajo çfarë u vërtetua me modelin e regresionit është që me rritjen prej 1% të INT, kemi rënie të RMK me ~0.33%.

4.1.4.9 Lidhja mes Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit-Kursi mesatar i Këmbimit Lekë/USD

Për efekt përpunimi të saktë, meqënëse të dhënat për kursin mesatar të këmbimit Lekë/USD nuk ofrohen në përqindje, janë përpunuar përmes Eviews 7 duke i kthyer në logaritëm natyror vlerat e këtij treguesi, në mënyrë që edhe analiza e tij me RMK të jetë e saktë.

Paraqitja grafike e ecurisë së Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Kursit mesatar të Këmbimit Lekë/USD është si më poshtë:

Figurë 25. Ecuria e RMK- Kursi mesatar i Këmbimit Lekë/USD



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorit

Vërejmë që kursi mesatar i këmbimit Lekë/USD ka një trend rënës, dhe ndjek përgjithësisht të njëjtin trend me RMK. Ajo çfarë u vërtetua me modelin e regresionit është që me rritjen prej 1% të LnLEKUSD, kemi rritje të RMK me ~6.25%, kjo për faktin se rritjen e ekspozimit ndaj këtij kursi bankat e kanë në qendër të vëmendjes duke i marrë në kohë masat, pra brenda periudhës së rritjes së kursit mesatar të këmbimit Lekë/USD.

4.2 ANALIZA E PYETËSORIT

Është bërë shpërndarje pyetësoi 112 specialistëve të departamentit të kredive dhe departamentit të menaxhimit të rrezikut të të gjitha bankave që operojnë në tregun bankar shqiptar. Pyetësoi është fokusuar në politikën e orientimin që ka secila bankë, të ndikuar nga Banka e Shqipërisë si mbikëqyrëse e tyre dhe nga politika e aksionerëve përkatës. Përpunimi në grup i tyre, jep një orientim të të gjithë sistemit bankar në Shqipëri.

4.2.1 Problematika që vështirësojnë kreditimin


Në mënyrë të përmblodhur për të parë se sa e vështirësojnë kreditimin e klientëve tre problematikat e mëposhtme, përgjigjet grupohen si më poshtë:

Tabelë 13. Problematika që vështirësojnë kreditimin e klientëve

Alternativat	Aspak	Pak	Mesatarisht	Shumë	Maksimalisht
Burokracia nga ZRPP	0%	0%	0%	10.4%	89.6%
Zonat Informale (pa dokumenta pronësie)	0%	0%	67.2%	32.8%	0%
Historiku i kredisë	0%	0%	0%	95.2%	4.8%

Burimi: Të dhëna primare

Figurë 26. Problematika që vështirësojnë kreditimin e klientëve



Burimi: Të dhëna primare

Vërejmë që bankat tashmë i shohin maksimalisht problematike, burokracitë e procedurave pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, 89.6%, qofshin këto

per kredimarrësit e rinj apo kredimarrësit ekzistues. Kredimarrësit e rinj minimalisht duhet të aplikojnë në ZRPP-të përkatëse për hartë, kartelë pasurie dhe origjinë prone, dokumenta këto që duhen që në fillim të aplikimit për të verifikuar nëse prona është e lirë e nuk ka barrë hipotekore, si dhe për të verifikuar nëse kjo pronësi është fituar sipas ligjit, sepse në vendin tonë ka plot raste që për të njëjtën pronë të rezultojnë të dalin nga ZRPP dy certifikata pronësie. Ndërsa kredimarrësit ekzistues që kërkojnë të rikreditohen nga banka, të cilëve nëse iu ka kaluar afati një vit nga kreditimi i fundit, banka i kërkon rifreskim kartelet të pasurisë së lënë kolateral (garanci) dhe kjo kërkesë vjen si rezultat i problemeve të ndyshme siç janë shembja e kolateralit ekzistues, ndërtimi i një projekti të ri mbi truallin kolateral, ndarja e kolateralit ekzistues në dy pasuri të tjera, etj... duke rezultuar kështu në ndryshimin e statusit të pronës kolateral pa vënë në dijeni bankën, në favor të së cilës është e bllokuar prona. Të gjitha ndryshimet që i ndodhin pronës kolateral pa lejen e bankës dhe rregjistrimi i tyre në ZRPP, përbëjnë shkelje, por raste të tilla ka plot të cilat dëmtojnë sistemin bankar.

Që në këtë fazë kemi problem në nxjerrjen e këtyre dokumentave, të cilat pretendohet që do vijnë duke u lehtësuar duke qënë se këtë proces mund ta aplikojnë edhe pranë noterëve me kërkesën e klientit. Për të vazhduar më tej, nevoja e paraqitjes pranë ZRPP-ve është edhe pas miratimit të kredisë, është faza e bllokimit të pronës e cila gjithashtu përbën problem më vete. Jashtë përgjigjeve formale të pyetësorit, drejtuesit pohuan se kishin pasur raste që kredidhënia nuk është finalizuar vetëm për arsyen se vonesat e burokracitë në ZRPP krijojnë vonesa të mëdha duke çuar deri në heqjen dorë nga klientët. Këtu shtojmë edhe rastet e debitorëve të cilëve iu kalon prona aset i bankës, dhe deri në përfundimin e procedurave të brendshme, ZRPP-të i lënë pas dore këto procese.

Pamvarësisht se tashmë iu lejohej edhe noterëve kryerja e kësaj procedure përsëri vonesat janë të njëjta, aplikimi bëhet shpejt (sepse realizohet në zyrën e noterit), por dalja e dokumentave nga hipoteka vazhdon të jetë problematike.

Në lidhje me *zonat informale*, 67.2% e bankave e shohin mesatarisht problematike, zona këto pa dokumenta pronësie sipas standartit që kërkon banka, duke ulur mundësinë e kreditimit të një pjese të mirë klientësh, pasi bankat kërkojnë kolaterale që janë brenda qytetit (vijës së verdhë) dhe pronat e fshatit apo pronat tokë bujqësore nuk i preferon më për shkak të vlerës së ulët në treg dhe mungesës së dokumentit sipas standartit, ku në rastin e debitorit të keq, banka të ketë mundësinë e marrjes së kolateralit (pronës garanci) në posedim, dhe të mund ta shesë atë. Paraqitet mesatarisht problematike sepse, bankat e kanë rritur nivelin e ekspozimit për kreditë pa kolateral, qofshin këto kredi për individë apo për biznese, ekspozime këto që arrijnë deri në masën 1,000,000 lekë për individët, e 2,000,000 lekë për bizneset.

Në lidhje me *regjistrin e kredive*, 95.2% e bankave tashmë i shohin shumë problematike, sepse ai paraqet historikun e klientit për kreditë e të gjitha llojeve, kartave të kreditit dhe overdrafteve. Regjistri është dokument i domosdoshëm për çdo aplikim, e për rrjedhojë ky raport i kredimarrësit ka mbrojtur shumë banka nga ekspozimi i keq, pasi shumë klientë më parë i kanë fshehur ekspozimet ndaj bankave të tjera, duke krijuar mundësinë e mbi kreditimit dhe rritjes së ekspozimit të disa bankave njëherësh ndaj të njëjtit klient. Historiku i kredisë na shfaqet si problematike sepse bankat për të mbajtur klientët e mëdhenj e të mos ekspozohen nga largimi i mundshëm i tyre tek bankat konkurrencte,

shpeshherë me qëllim nuk i informojnë klientët e tyre për diferenca në këstet e kredive në mënyrë që statusi i tyre të shkojë nga 0 në 1, duke i kthyer këto klientë jo shumë të preferuar nga bankat konkurrenente. Pra në këtë këndvështrim, “truket” e specialistëve me regjistrin e kredive, kthehen në problematike për rritjen e kreditimit, sepse regjistri i kredive përbën dokumentin e domosdoshëm në një aplikim.

Këtu dallojmë dy situata, situata e parë është kur klienti e ka pasur një kredi me probleme dhe tashmë e ka mbyllur atë, dhe situata e dytë është kur klienti e ka aktive kredinë me probleme. Në rastin e parë, kreditimi përbën një rrezik që mbart banka duke kredituar një klient që ka shfaqur vonesa të mëdha në historikun e tij si kredimarrës, ndërsa në rastin e dytë krahas rrezikut të rastit të parë, i shtohet edhe fakti që bankës nuk i lejohet me ligj kreditimi i klientëve me vonesa qoftë kjo edhe për mbylljen e një kredie me probleme, nëse nuk është kategorizuar si ristrukturim.

4.2.2 Menaxhimi i klientit me vonesa


Në mënyrë të përmblodhur për të parë se sa përdoren secila nga masat e mëposhtme në menaxhimin e një klienti me vonesa, përgjigjet grupohen si më poshtë:

Tabelë 14. Menaxhimi i klientit me vonesa

Alternativat	Aspak	Pak	Mesatarisht	Shumë	Maksimalisht
Njoftimi zyrtarë me postë	0%	0%	24.11%	75.89%	0%
Vizita	0%	0%	0%	9.83%	90.17%
Telefonata	0%	0%	0%	6.25%	93.75%

Burimi: Të dhëna primare

Figurë 27. Menaxhimi i klientit me vonesa



Burimi: Të dhëna primare

Informimi i klientit nuk nënkupton thjesht njoftimin për detyrimet e tij si kredimarrës, por edhe njoftimin e personave të tjerë dorëzanës që kanë firmosur në kontratën e kredisë siç

mund të jenë, bashkëshorti/ja, prindërit, apo miq e kolegët e tij/saj. Prandaj informimi përbën atë që ndryshe quhet menaxhimi i klientit.

Njoftimi zyrtarë me postë vlerësohet nga 75.89% shumë i praktikuar sepse ai i paraprin procedurave ligjore për debitorin që nuk paguan detyrimin përkatës. Arsye tjetër përse ky njoftim vlerësohet shumë është se edhe numri i kredive me probleme ka ardhur gjithnjë në rritje dhe nevojitet ulja e tyre edhe përmes procedurave ligjore.

Vërejmë që bankat nga tre njoftimet bazë që përdorin, më i praktikuari është njoftimi i debitorëve përmes telefonit i cili vlerësohet nga 93.75% maksimalisht. Gjithashtu edhe vizita në vend vlerësohet 90.17% maksimalisht, kjo për faktin se vizitat në vend kushtojnë më shumë kohë e kosto transporti sesa telefonatat.

4.2.3 Masat për menaxhimin e rrezikut të kredisë


Në mënyrë të përmbledhur për të parë se sa është i orientuar sistemi bankar drejt masave të mëposhtme për rritjen e mjaftueshmërisë së kapitalit sipas kërkesës së Bazel II përgjigjet grupohen si më poshtë:

Tabelë 15. Masat për menaxhimin e rrezikut të kredisë

Alternativat	Aspak	Pak	Mesatarisht	Shumë	Maksimalisht
Rritja e kapitalit	0%	0%	0%	31.5%	68.5%
Kredidhënia e re bazuar në cilësi përmes rritjes së kritereve	0%	0%	0%	4.4%	95.6%
Ulja e kredive me probleme	0%	0%	0%	22.6%	77.4%
Rritjen e rristurimeve të kredive ekzistuese	0%	25%	36%	39%	0%
Orientimi drejt shitjes së aseteve të ish debitorëve	0%	9.8%	42.1%	48.1%	0%

Burimi: Të dhëna primare

Figurë 28. Masat për menaxhimin e rrezikut të kredisë



Burimi: Të dhëna primare

Me hyrjen në fuqi të kushtit të mjaftueshmërisë së kapitalit minimumi 12% me datë 31.12.2014, bankat kanë filluar të jenë më agresive drejt pesë masave të mësipërme, të

cilat janë në funksion të pastrimit të balanceve të tyre nga “mbetjet” të cilat dëmtojnë aktivet e tyre, e për rrjedhojë rrisin koston e bankës përmes *rritjes së kapitalit*. Vërejmë që bankat tashmë janë të orientuara maksimalisht drejt rritjes së kapitalit, 68.5%, kjo së pari si kërkesë e detyrueshme nga BSH, si dhe nga nevoja për zbatimin e rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit në raport me rreziqet me të cilat ballafaqohen bankat. Rezulton 68.5% sepse bankat më të mëdha e kanë pasur prioritet edhe më parë këtë tregues.

Sipas grafikut vërejmë që bankat janë 95.5% maksimalisht të *orientuara drejt kredithënies cilësore*, e jo më sasiore siç ka qënë rreth viteve 2004-2008. Tashmë marrja e një kredie kërkon plotësimin e disa kushteve shtesë të cilat më parë nuk kanë qënë pjesë të procesit të kredithënies, pa përmendur që regjistri i kredisë duhet të jetë i pastër, pa historik të keq kredie.

Vërejmë që 77.4% vlerësojnë maksimalisht që janë të orientuara drejt *uljes së kredive me probleme*, përshpjektimit të procedurave ligjore për kontabilizimin e kalimit në aset të kolateralit.

Gjithashtu vërejmë që 39% vlerësojnë shumë orientimin drejt *ristrukturimeve të kredive* ekzistuese. Ky tregues rezulton në këtë nivel sepse tashmë bankat e kanë humbur besimin te kredimarrësit me probleme, dhe nuk e shohin si zgjidhje të parë. Sipas ekperiencës së tyre kjo ka rezultuar shpeshherë zgjidhje, por ka edhe raste ku përsëri klientët me kredi të ristrukturuar të jenë rikthyer në klientë me probleme, për të cilët kanë rifilluar procedurat ligjore.

Vërejmë që *shitja e aseteve* tashmë të kontabilizuar nuk realizohet lehtë, prandaj orientimi drejt kësaj alternative është vlerësuar shumë nga 48.1%. Kjo si rezultat se tregu i pasurive ofron shumë prona të reja e pa probleme, e në përgjithësi nga popullata preferohet më shumë blerja e një pasurie pak më të shtrejtë e pa probleme se e një pasurie tjetër më të lirë e me probleme që mund të lindin nga ish debitorët.

4.2.4 Masat për rritjen e kredithënies cilësore


Në mënyrë të përmbledhur për të parë se sa problematike janë masat e mëposhtme rritjen e kredithënies, përgjigjet grupohen si më poshtë:

Tabelë 16. Masat për rritjen e kredithënies cilësore

Alternativat	Aspak	Pak	Mesatarisht	Shumë	Maksimalisht
Kërkesat e bankës për kolateral	0%	0%	0%	20.70%	79.30%
Burokracia e bankës	0%	0%	0%	30.20%	69.80%
Niveli i komisioneve	0%	0%	47.70%	52.30%	0%
Përqindja e interesit të kredisë	0%	0%	11.30%	59.60%	29.10%

Burimi: Të dhëna primare

Figurë 29. Masat për rritjen e kredidhënies cilësore



Burimi: Të dhëna primare

Me anën e kësaj analize vërejmë që 79.3% e bankave tashmë i kushtojnë vëmendje maksimale marzhit të *mbulimit të kredisë me kolateral* duke marrë për bazë dy vlera, vlerën e tregut dhe vlerën e likuidimit të menjëhershëm. Për përcaktimin e këtyre vlerave, vlerësuesit e jashtëm apo ato të brendshëm të bankës duhet të zbatojnë udhëzuesin e BSH¹⁰⁸. Gjithashtu, vërejmë që përgjithësisht kolaterale të llojit tokë bujqësore nuk preferohen më nga bankat si kolateral, kjo për arsye të problemeve të shkaktuara nga zbatimi i ligjit nr. 7501 ku të gjithë pjestarët e familjes bujqësore me dt. 01.08.1991 duhej ligjërisht të firmosnin si hipotekues të pronës bujqësore, anomali kjo që lindi më vonë me ndryshimin e ligjit. Nga ky problem shumë klientëve me probleme ka qënë e pamundur ti merrej prona nga banka sepse në kontratat e hipotekës kishte firmosur vetëm titullari i dokumentit të pronësisë, e për pasojë dhe vjelja e kredisë nga klientët ekzistues. Ky është një ndër rastet tipike ku rreziku ligjor dëmton sistemin bankar.

Duke qënë se është rritur vëmendja drejt kredidhënies cilësore, edhe *burokracia* dhe masat në dhënien e kredive janë rritur prandaj dhe 69.8% e vlerësojnë maksimalisht që burokracia në marrjen e një kredie është rritur. Kryesisht burokracia konsiston në të kërkuarit të dokumentave shtesë që verifikojnë të ardhurat e kredimarrësit, dokumentave të pronësisë përmes origjinës së plotë të pronës që do lihet kolateral dhe dokumentave informuese ose parakontraktore që i jepen klientit, kërkesë kjo e B.SH¹⁰⁹ për rritjen e transparencës së bankës me klientin.

Me komision në kredidhënie, kuptojmë komisionin e çeljes së kredisë, primin policës së sigurimit të jetës, primin e policës së sigurimit të pronës, penalitetet për pagesat e vonuara dhe penalitetin për mbylljen e kredisë para afati. Bankat kryesisht janë duke blerë kredi nga njëra-tjetra, dhe këtyre klientëve që normal kanë regjistër kredie me status të mira, pothuajse të gjitha bankat i ofrojnë komision çeljeje 0%, duke përdorur komisionet për rritjen cilësore të portofolit të kredisë.

¹⁰⁸ Banka e Shqipërisë, Udhëzues për përgatitjen e vlerësimeve të pasurive të paluajtshme për qëllime të marrjes së një kredie nga një institucion financiar (2013)

¹⁰⁹ B.SH., Rregullorja “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja” (Sipas Kërkesave të Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008, ndryshuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015)

Vërejmë që *komisionet* e ndryshme në lidhje me kredidhënien vlerësohen mesatarisht problematike, përkatësisht në masën 52.3%. Kjo sepse disa banka, bazuar në politikën e tyre të brendshme janë treguar më të “lirë” në treg, me synimin rritjen e klientelës, ndryshe nga bankat e mëdha të cilat tashmë e kanë një portofol të kënaqshëm kredie, dhe në sajë të reklamave e emrit të mirë në treg nuk kanë nevojë që të “luajnë” me komisionet për tërheqjen e klientëve. Duhet pranuar që komisionet e mbylljeve të kredive para afatit kanë rënë, sepse më parë deri në vitin 2013 përgjithësisht kanë qënë rreth 5%, ndërsa tani, në sajë të ngopjes së tregut me kredi, komisionet janë ulur deri në intervalin 0%-3%, me qëllim rritje e nivelit të kredive.

Përqindja e interesit të kredive paraqitet shumë problematike, 59.6%, kjo sepse vërtetë B.SH e ka ulur normën bazë të bonove të thesarit, bankat nuk mund të ulin fitimet e tyre, sepse dihet që fitimi kryesor janë të ardhurat nga kreditë. Prandaj, bankat kanë zgjedhur një formë tjetër për të mbrojtur veten. Në dukje normat e interesit që ofrojnë e i bëjnë marketing duken të ulëta, por e parë në këndvështrimin e normës efektive të interesit (NEI)¹¹⁰ realisht ajo nuk rezulton të jetë e favorshme siç reklamohet. Kjo disbalancë vjen si pasojë e minimeve të përdorura nga bankat pas një afati 12-24 mujor, dhe në kontratat e kredive përgjithësisht norma shprehet në formën “ $x\%$ deri në afatin m , më pas bono thesari + $y\%$, jo më pak se $z\%$ ”, ku $x\%$ është norma marketing, $y\%$ është norma e fitimit ndërsa $z\%$ është gjithmonë më e lartë se $x\%$, psh. “4% deri me datë 31.12.2017, më pas Bono Thesari + 2%, jo më pak se 7%”¹¹¹. Pikërisht, $z\%$ është norma me të cilën përballet klienti dhe prej saj i rritet detyrimi mujor për tu paguar, duke ndikuar kështu në uljen e aftësisë paguese të tij. Prandaj rekomandoj që në analizën e aftësisë paguese të klientit të merret në konsideratë norma efektive e kredisë e jo norma $x\%$ e cila përfundon pas një periudhë të limituar sepse vërtetë rritet kredidhënia përmes reklamave, por në një afat të shkurtër ajo kthehet në kredi me probleme.

4.2.5 Ndikimi i ambientit të jashtëm në rritjen kredidhënies cilësore

Në mënyrë të përmbledhur për të parë se sa problematike janë faktorët makroekonomikë për veprimtarinë dhe rritjen e nivelit të kredidhënies përgjigjet grupohen si më poshtë:

Tabelë 17. Ndikimi i ambientit të jashtëm në rritjen kredidhënies cilësore

Alternativa	Aspak	Pak	Mesatarisht	Shumë	Maksimalisht
Produkti i Brendshëm Bruto	0%	0%	10.4%	89.6%	0%
Paqëndrueshmëria politike/pasiguria	0%	0%	0%	22.10%	77.90%
Norma e papunësisë	0%	0%	0%	10.72%	89.28%
Taksat e larta	0%	0%	0%	11.30%	88.70%
Informaliteti i ekonomisë	0%	0%	0%	20.10%	79.90%


¹¹⁰ Banka e Shqipërisë, Rregullore “Mbi Transparencën për Produktet dhe Shërbimet Bankare e Financiare” (Miratuar me vendimin nr. 59.datë 29.08.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, ndryshuar me vendimin nr. 14, datë 09. 03. 2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë) fq. 3.

¹¹¹ Banka të ndryshme vendosin normë të ndryshme në varësi të produktit të kredisë e rrezikut që shoqëron atë.

Norma e inflacionit	0%	19.65%	80.35%	0%	0%
Kursi i këmbimit	0%	41.08%	58.92%	0%	0%

Burimi: Të dhëna primare

Figurë 30. Ndikimi i ambientit të jashtëm në rritjen kredidhënies cilësore



Burimi: Të dhëna primare

Vërejmë që bankat e vlerësojnë 89.6% shumë të rëndësishme ndryshimet në *produktin e brendshëm bruto*, të cilat e rrisin më shumë ekspozimin e bankës. Kjo sepse një përqendrim i nivelit të jetesës, shkakton një ulje të aftësisë paguese e për pasojë rritjen e rrezikut të kredisë, dhe nga të dhënat e INSTAT rezulton që niveli i PBB është në rënie që nga tremujori i tretë i vitit 2012.

Vërejmë që *paqëndrueshmëria politike/pasiguria* në lidhje me kredidhënien vlerësohet nga 77.9% maksimalisht problematike. Kjo sepse thuajse të gjitha bankat e kanë vuajtur dhe vazhdojnë ta vuajnë këtë problem, kryesisht me klientët e punësuar në sektorin shtetëror të cilët hiqen e vihen në punë sipas përkatësive politike. Nuk mbeten pas as të punësuarit në sektorin privat të cilët punësohen nga bizneset kryesisht vetëm sipas projekteve /tenderave publike, të cilat janë shumë fitimprurëse por me afat të shkurtër dhe me mbarimin e projekteve mbesin të papunë, duke shkaktuar kështu një rritje të kredive me probleme.

Norma e papunësisë përbën nga 89.28% maksimalisht problem në rritjen e rrezikut të kredisë, kjo sepse kjo normë ka pësuar një rritje shumë të madhe në tremujorin e tretë të vitit 2013 në 16.44%, nga 13.31% që ishte në tremujorin e katërt të 2012. Kjo rritje përkon edhe me kohën e ndryshimeve politike në vend, ndryshime këto që shumë klientë të rregullt ekzistues, i kanë kthyer në klientë problematikë për shkak të heqjes nga vendi i punës (fshesa politike).

Taksat e larta për biznesin dhe tatimet e larta mbi të ardhurat personale të individëve në lidhje me kredidhënien vlerësohen nga 88.7% maksimalisht problematike, duke shkaktuar paaftësi në pagesat e kësteve të kredisë, e në këtë mënyrë në rritjen e kredive me probleme. Disa nga taksat për biznesin, veçanërisht taksat vendore të Bashkive, pothuajse janë dyfishuar që në vitin 2014. Nga ana tjetër, rritja e tatim fitimit nga 10% që ishte deri më 31.12.2014, në 15% ka ulur ndjeshëm të ardhurat e biznesit dhe individëve, duke çuar në dobësimin e aftësisë paguese.

Informaliteti i lartë paraqitet nga 79.9% maksimalisht problematike, kjo sepse deri para fushatës së informalitetit të ndërmarrë nga qeveria, analiza e klientit bazohej edhe në të dhënat informale të klientit, duke krijuar kushtet për një rrezik moral, nga punonjësit e bankave për të mbartur më shumë rrezik, të ndikuar nga planet (objektivat) që kanë për dhënie kredie. Rreziku moral në banka ndodhë për shkak të mungesës së disiplinës së tregut¹¹² (S.Mishkin, G.Eakins,2006).

Po të krahasohet xhiroja e bizneseve gjatë vitit 2015 në raport me 2014, tek pjesa më e madhe e bizneseve vërehet një rritje pothuajse dy herë më e lartë. Prandaj ulja e informalitetit ndikon në rritjen e kredidhënies cilësore duke ulur mundësinë për interpretime subjektive në analizën e aftësisë paguese të klientit. Pra, fushata kundër informalitetit e bërë në shtator 2015 ka ulur dukshëm informalitetin duke bërë që bizneset të përmirësojnë bilancet e tyre fiskale, dhe në këtë mënyrë kanë ulur dukshëm mundësinë e përgatitjes gabim të analizës financiare, e cila më parë bazohej kryesisht tek te ardhurat reale e jo fiskale.

Norma e Inflacionit paraqitet nga 80.35% mesatarisht problematike duke pohuar se B.SH ka arritur ta mbajë në nivele të qëndrueshme dhe për bankat e nivelit të dytë nuk përbën problem ky tregues. Dihet që një rritje inflacioni, e përmirëson pagesën e kredive sepse shkaktonte një ulje të vlerës reale të principalit të mbetur pa paguar, dhe kredimarrësit kanë më shumë mundësi të paguajnë këstet e kredisë, dhe si rrjedhojë një nivel më të ulët të kredive me probleme. Nga këndvështrimi i bankave mbajtja e inflacionit në nivele të qëndrueshme, i mbron ato nga ekspozimet ndaj këtij treguesi.

Kursi i këmbimit i klientëve rezulton nga 58.92% mesatarisht problematike, sepse bankat kanë akoma kredi në portofolin e tyre të disbursuara në monedhë të huaj, prandaj së fundmi është rritur orientimi drejt kredidhënies në monedhën në të cilën janë të ardhurat, në mënyrë që të minimizohet ekspozimi nga kurset e këmbimit. Në këtë mënyrë bankat e kanë ulur shumë ekspozimin ndaj kursit të këmbimit, dhe ajo që mbartin sot, janë kreditë që janë dhënë më parë.

4.3 KONKLUZIONE

Gjatë këtij kapitulli u ndalëm gjerësisht në dy analiza: 1. modelit të regresionit dhe 2. pyetësorit. Të dy këto analiza studiojnë raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit i cili në qendër të vet ka rrezikun e kredisë.

¹¹² Frederic S.Mishkin, Stanley G.Eakins (sixth edition, 2006), “Financial Market & Institution”, fq. 489

- Përmes *analizës regressive* jam përpjekur që të testoj hipotezën kryesore të punimit, lidhjen mes mjaftueshmërisë së kapitalit dhe variablave të tjerë të marrë në studim, sesi bankat mund ta menaxhojnë më mirë secilin tregues të cilët kanë ndikim të ndryshëm. Rezultatet treguan se të gjithë variablat e marrë në studim ndikojnë në mënyra të ndryshme disa në uljen dhe disa në rritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Nga përpunimi i të dhënave nga 13 variabla të marrë në shqyrtim, vetëm 9 prej tyre rezultuan statistikisht të rëndësishëm ashtu sikurse ishin trajtuar edhe në literaturë. Peshën më të madhe nga të gjithë variablat e kishte depozitat totale mbi aktivet totale, raport ky që tregon shkallën e likuiditetit në përgjithësi, fondin të cilin banka duhet ta menaxhojë sa më mirë në formën e dhënies së kredive cilësore, në mënyrë që ky raport të mbahet në nivele optimale. Me shumë ndikim paraqitet edhe kapitali rregullator i cili është variabli kyç për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Gjithashtu edhe treguesit si kapitali total/aktive totale, aktivet e ponderuara/aktivet totale, norma e kredive me probleme, norma mesatare e interesit dhe norma mesatare e kursit të këmbimit shfaqin lidhje statistikisht të rëndësishëm.
- Përmes *analizës së pyetësorit*, vërejmë që orientimi i bankave është drejt pastrimit të bilanceve nga kreditë me probleme të trashëguara nga vitet 2004-2008, kohë kjo kur bankat ishin të orientuara vetëm drejt rritjes së kredidhënies, më pas me shfaqjen e krizës së vitit 2008, BSH e përforcoi mbikëqyrjen e saj duke shtuar kërkesat për uljen e kredive me probleme, element ky që ka çuar bankat drejt kredidhënies cilësore. Me rregulloret e reja për mjaftueshmërinë e kapitalit vërejmë që bankat janë të orientuara drejt cilësisë, sidomos ato banka që tashmë e kanë një portofol të madh, dhe përpiqen ta menaxhojnë atë sa më mirë.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME TË STUDIMIT

➤ KONKLUZIONE

Bankat tashmë janë të orientuara drejt pastrimit të bilanceve të tyre nga mbetjet e kredive me probleme, kjo përmes shitjes së asetëve të ish debitorëve, realizimit të kontratave të qerave për pronat aset dhe ristrukturimit të kredive me probleme. Këto masa kanë për qëllim zbatimin e rregulloreve të vendosura nga BSH, siç është raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit minimumi 12%, e cila tashmë përbën ligj për sistemin bankar shqiptar që më datë 31.12.2014.

Vërejmë gjithashtu që ndryshimet politike kanë pasur ndikimin e tyre tek produkti i brendshëm bruto, norma e papunësisë dhe norma e inflacionit, faktorë këto që kanë ndikuar në përkeqësimin e kredive me probleme. Këtu mund të përmendim lëvizjet politike për kredimarrësit e punësuar në sektorin publik.

Një ndihmesë të madhe iu dha bankave të nivelit të dytë miratimi i ligjit për zbritjen nga taksat të fshirjeve nga bilanci i kredive të këqija.

Sipas dy analizave të studimit konkluzionet renditen si më poshtë:

➤ **Sipas analizës së modelit të regresionit konkludojmë që:**

Studime të ndryshme për kreditë me probleme kanë paraqitur si faktorë ndikues variabla të ndryshëm. E parë kjo nga këndvështrimi i Bazel II, pra nga këndvështrimi i mjaftueshmërisë së kapitalit, matja e tij do fokusohet në kategoritë e mëposhtme:

- 1. Kapitali Total**
- 2. Aktive të ponderuara me rrezikun**
 - a. Rreziku i kredisë
 - b. Rreziku i tregut
 - c. Rreziku operacional

1. Kapitali Total:

Si variabla sinjalizues për ndryshime në kapitalin total janë: Kapitali rregullator, Kapitali Total/Aktive totale, Depozita Totale/Aktive Totale dhe shohim që të tre këto tregues kanë ndikim të madh tek raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit. Të tre këto tregues rezultuan se kanë ndikim statistikisht të rëndësishëm tek raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, duke vërtetuar kështu hipotezën alternative. Të gjithë janë të lidhur me kapitalin i cili nga këndvështrimi i Bazel II, përbën epiqendrën ndaj të cilit sillen të gjithë rreziqet. Nëse kemi luhajtje të mëdha nga mesatarja, secili nga këto variabla jep sinjalin se ku duhet fokusuar vëmendja e menaxhimit të lartë dhe masat që duhet të merren për përmirësimin e tyre.

2. Variabla të aktiveve të ponderuara me rrezikun:

Si variabla sinjalizues për ndryshime në aktivet e ponderuara me rrezikun është përfshirë në studim vetëm variabli Aktivet e Ponderuara/Aktivitet Totale i cili shfaqet me një trend rritës që nga tremujori i parë i vitit 2009 dhe rezulton të ketë ndikim statistikisht të rëndësishëm tek raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit duke vërtetuar kështu hipotezën alternative.

a. Rreziku i kredisë

Si variabla sinjalizues për ndryshime në rrezikun e kredisë janë marrë variablat: Norma e Kredive me Probleme, Kredi/Depozita dhe Kredi Totale/Aktivitet Totale të cilët në qendër kanë kredidhënien. Kredia shihet edhe nga niveli i kredive me probleme, nga “oreksi” i bankave për të përdorur fondin e depozitave në dhënie kredie (për rritje të fitimeve), dhe nga menaxhimi i aktiveve totale, duke u përpjekur që të mos tejkalohet raporti Kredidhënie Totale/Aktive Totale. Nga këto variabla, vetëm variabli Norma e Kredive me Probleme rezulton të ketë ndikim statistikisht të rëndësishëm tek raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit duke vërtetuar kështu hipotezën alternative. Ndërsa dy variablat e tjerë nuk rezultuan statistikisht të rëndësishëm, duke vërtetuar kështu hipotezën bazë.

b. Rreziku i tregut

Si variabla sinjalizues për ndryshime në rrezikun e tregut janë marrë variablat: Produkti i Brendshëm Bruto, Norma e Papunësisë dhe Norma e Inflacionit. Nga këto variabla, vetëm variabli Produkti i Brendshëm Bruto nuk rezulton të ketë ndikim statistikisht të

rëndësishëm tek raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit duke vërtetuar kështu hipotezën bazë. Ndërsa dy variablat e tjerë rezultuan statistikisht të rëndësishëm, duke vërtetuar kështu hipotezën alternative, që do të thotë se në lidhje me raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, ato e përfaqësojnë më mirë rrezikun e tregut. Nga të tre këto variabla ndikimin më të madh rezultoi ta ketë Norma e Inflacionit.

c. Rreziku operacional

Si variabla sinjalizues për ndryshime në rrezikun operacional janë marrë variablat: Norma mesatare e interesit të kredisë, Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Euro dhe Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Usd. Nga këto tre variabla, i parëndësishëm statistikisht rezultoi të jetë vetëm Kursi mesatar i këmbimit Lekë/Euro, ndoshta sepse ky kurs nuk ka pasur luhajta të mëdha për periudhën e studimit. Ndërsa dy variablat e tjerë rezultuan statistikisht të rëndësishëm, duke vërtetuar kështu hipotezën alternative, që do të thotë se në raport me raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, ato e përfaqësojnë më mirë rrezikun operacional.

➤ Sipas analizës së pyetësorit konkludojmë që:

- Bankat tashmë i shohin maksimalisht problematike 89.6%, *burokracinë e procedurave pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme*, qofshin këto për kredimarrësit e rinj, kredimarrësit ekzistues apo dhe vetë bankave për procedurat e marrjes së pronave të debitorë. Megjithëse tashmë iu lejohet edhe noterëve kryerja e kësaj procedure, përsëri vonesat janë të njëjta, aplikimi bëhet shpejt sepse realizohet në zyrën e noterit, por dalja e dokumentave nga hipoteka vazhdon të jetë problematike.
- Problematika për *zonat informale*, paraqitet mesatarisht problematike, 67.2%, zona këto pa dokumenta pronësie sipas standartit që kërkon banka, duke ulur mundësinë e kreditimit të një pjese të mirë klientësh, pasi bankat kërkojnë kolaterale që tregtohen më shpejt, ndërsa pronat e fshatit apo pronat tokë bujqësore nuk i preferon më për shkak të vlerës së ulët në treg, dhe mungesës së dokumentit sipas standartit, ku në rastin e debitorit të keq, banka të ketë mundësinë e marrjes së kolateralit në posedim, dhe të shitjes së tij. Paraqitet mesatarisht problematike sepse bankat ofrojnë edhe kredi pa kolateral që arrijnë deri në 2,000,000 lekë.
- *Regjistrin e kredive*, bankat e shohin shumë të rëndësishëm, 95.2%, i cili paraqet historikun e klientit për kreditë e të gjitha llojeve. Ky raport i kredimarrësit ka mbrojtur shumë banka nga ekspozimi i keq, pasi shumë klientë i kanë fshehur më parë ekspozimet ndaj bankave të tjera, duke krijuar mundësinë për rritjen e ekspozimit të disa bankave njëherësh ndaj të njëjtit klient, prandaj përbën dokument të domosdoshëm për çdo aplikim. Historiku i kredisë shfaqet si problematike sepse bankat për të mbajtur klientët e mëdhenj shpeshherë me qëllim nuk i informojnë këta klientë për diferenca në kështet e kredive në mënyrë që statusi i tyre të shkojë nga 0 në 1, duke i kthyer këto klientë jo shumë të preferuar nga bankat konkurrente. Pra në këtë këndvështrim, “truket” e

specialistëve me regjistrin e kredive, kthehen në problematike për rritjen e kreditimit, sepse regjistri i kredive përbën dokumentin e domosdoshëm në një aplikim.

- Duke qënë se informimi i klientit nuk nënkupton thjesht njoftimin e tij si kredimarrës, por edhe njoftimin e personave të tjerë dorëzanës që kanë firmosur në kontratën e kredisë, përbën atë që ndryshe quhet menaxhimi i klientit. Nga tre njoftimet bazë që përdoren në sistemin bankar, më i përdoruri është njoftimi i debitorëve përmes *telefonit* i cili vlerësohet nga 93.75% maksimalisht, ndërsa më pak i përdoruri është *njoftimi zyrtarë me postë* i cili vihet në funksion kur vizitat dhe telefonatat nuk e kryejnë funksionin e tyre. Njoftimi zyrtar përdoret edhe për ti paraprirë procedurave ligjore për debitorin që nuk paguan detyrimin përkatës.
- Me hyrjen në fuqi të kushtit të mjaftueshmërisë së kapitalit me datë 31.12.2014, konkludojmë që bankat nga viti 2014 kanë filluar të jenë më agresive drejt pesë masave të cilat janë në funksion të pastrimit të bilanceve të tyre nga “mbetjet” të cilat dëmtojnë bilancet e tyre, e për rrjedhojë rrisin koston e bankës përmes *rritjes së kapitalit*. Rezulton që bankat tashmë janë të orientuara maksimalisht drejt rritjes së kapitalit, 68.5%, kjo si kërkesë e detyrueshme nga BSH për zbatimin e rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit në raport me rreziqet me të cilat ballafaqohen bankat.
- Rezulton që bankat janë maksimalisht të orientuara drejt *kredidhënies cilësore*, 95.6%, e jo më sasiore siç ka qënë rreth viteve 2004-2008. Tashmë marrja e një kredie kërkon plotësimin e disa kushteve shtesë të cilat më parë nuk kanë qënë pjesë e procesit të kredidhënies, pa përmendur që regjistri i kredisë duhet të jetë i pastër, pa historik të keq kredie.
- Rezulton që bankat janë 77.4% maksimalisht të orientuara drejt *uljes së kredive me probleme* e përshtetimit të procedurave ligjore për kontabilizimin e kalimit në aset të kolateralit.
- Rezulton që 39% vlerësojnë shumë orientimin drejt *ristrukturimeve të kredive ekzistuese* dhe paraqitet në këtë nivel sepse tashmë banka e ka humbur besimin tek ai kredimarrës. Sipas ekperiencës së tyre kjo ka rezultuar shpeshherë zgjidhje, por ka edhe raste ku përsëri klientët me kredi të ristrukturuar të jenë rikthyer në klientë me probleme, për të cilët kanë rifilluar procedurat ligjore.
- Rezulton që *shitja e aseteve* tashmë të kontabilizuar nuk realizohet lehtë, prandaj orientimi drejt kësaj alternative është vlerësuar shumë nga 48.1%. Kjo si rezultat se tregu i pasurive ofron shumë prona të reja e pa probleme të cilat janë më të preferuara nga popullata.
- Vërejmë që bankat tashmë i kushtojnë vëmendje maksimale marzhit të *mbulimit të kredisë me kolateral* duke marrë për bazë dy vlera, vlerën e tregut dhe vlerën e likuidimit të menjëhershëm. Gjithashtu, përgjithësisht kolaterale të llojit tokë bujqësore nuk preferohen më nga bankat si kolateral, kjo për arsye të problemeve

të shkaktuara nga zbatimi i ligjit nr. 7501 ku të gjithë pjestarët e familjes bujqësore me dt. 01.08.1991 duhej ligjërisht të firmosnin si hipotekues së pronës bujqësore, anomali kjo që lindi më vonë me ndryshimin e ligjit. Nga ky problem shumë klientëve me probleme ka qënë e pamundur ti merrej prona nga banka, e për rrjedhojë vjelja e kredisë nga klientët ekzistues. Ky është një ndër rastet tipike ku rreziku ligjor dëmton sistemin bankar.

- Rezulton që është rritur vëmendja drejt kredidhënies cilësore, edhe *burokracia* dhe masat në dhënien e kredive janë rritur prandaj dhe 69.8% e vlerësojnë maksimalisht që burokracia në marrjen e një kredie është rritur.
- Rezulton që *komisionet* e ndryshme në lidhje me kredidhënien vlerësohen mesatarisht problematike, përkatësisht në masën 52.3%. Kjo sepse disa banka, bazuar në politikën e tyre të brendshme janë treguar më të lirë në treg, me synimin rritjen e klientelës, ndryshe nga bankat e mëdha të cilat tashmë e kanë një portofol kredie, dhe në sajë të reklamave e emrit të mirë në treg dhe nuk kanë nevojë që të “luajnë” me komisionet për tërheqjen e klientëve. Duhet pranuar që komisionet e mbylljeve të kredive para afatit kanë rënë të cilat deri para vitit 2013 kanë qënë rreth 5%, ndërsa tani, në sajë të ngopjes së tregut me kredi, për rrjedhojë e uljes së kërkesës për kredi, komisionet janë ulur deri në intervalin 0%-3%, kjo në varësi të portofolit të bankës.
- *Përqindja e interesit të kredive* paraqitet shumë problematike, 59.6%, kjo sepse vërtetë B.SH e ka ulur normën bazë të bonove të thesarit, bankat nuk mund të ulin fitimet e tyre, sepse dihet që fitimi kryesor janë të ardhurat nga kreditë. Prandaj, bankat kanë zgjedhur një formë tjetër për të mbrojtur veten. Në dukje normat e interesit që ofrojnë e i bëjnë marketing duken të ulëta, por e parë në këndvështrimin e normës efektive të interesit (NEI)¹¹³ realisht ajo nuk rezulton të jetë e favorshme siç reklamohet. Kjo reklamë e tyre vërtet rrit kredidhënien, por në një afat të shkurtër e kthen atë në kredi me probleme.
- Rezulton që bankat i vlerësojnë shumë të rëndësishme ndryshimet në *produktin e brendshëm bruto*, 89.6% të cilat e rrisin më shumë ekspozimin e bankës. Kjo sepse një përkeqësim i nivelit të jetesës, shkakton një rritje të rrezikut të kredisë.
- Rezulton që *paqëndrueshmëria politike/pasiguria* në lidhje me kredidhënien vlerësohet maksimalisht problematike, përkatësisht në masën 77.9%. Kjo sepse thuajse të gjitha bankat e kanë vuajtur dhe vazhdojnë ta vuajnë këtë problem, kryesisht me klientët e punësuar në sektorin shtetëror të cilët hiqen e vihen në punë sipas përkatësive politike. Nuk mbeten pas as të punësuarit në sektorin privat të cilët punësohen nga bizneset kryesisht vetëm sipas projekteve /tenderave publike, të cilat janë shumë fitimprurëse por me afat të shkurtër dhe me mbarimin

¹¹³ Banka e Shqipërisë, Rregullore “Mbi Transparencën për Produktet dhe Shërbimet Bankare e Financiare” (Miratuar me vendimin nr. 59.datë 29.08.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, ndryshuar me vendimin nr. 14, datë 09. 03. 2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)fq. 3

e projekteve mbesin të papunë, duke shkaktuar kështu një rritje të kredive me probleme.

- *Norma e papunësisë* përbën nga 89.28% maksimalisht problem në rritjen e rrezikut të kredisë, kjo sepse kjo normë ka pësuar një rritje shumë të madhe në tremujorin e tretë të vitit 2013 në 16.44%, nga 13.31% që ishte në tremujorin e katërt të 2012. Kjo rritje përkon edhe me kohën e ndryshimeve politike në vend, ndryshime këto që shumë klientë të rregullt ekzistues, i kanë kthyer në klientë problematikë për shkak të heqjes nga vendi i punës (fshesa politike).
- *Taksat e larta* për biznesin dhe tatimet e larta mbi të ardhurat personale të individëve në lidhje me kredidhënien vlerësohet maksimalisht problematike, përkatësisht në masën 88.7%, duke shkaktuar paaftësi në pagesa të kësteve të kredisë, e në këtë mënyrë në rritjen e kredive me probleme. Disa nga taksat për biznesin, veçanërisht taksat vendore të Bashkive, pothuajse janë dyfishuar që në vitin 2014. Nga ana tjetër, rritja e tatim fitimit nga 10% që ishte deri me 31.12.2014 në 15% ka ulur ndjeshëm të ardhurat e biznesit dhe individëve, duke çuar në dobësimin e aftësisë paguese.
- *Informaliteti i lartë* paraqitet nga 79.9% maksimalisht problematike, kjo sepse deri para fushatës së informalitetit të ndërmarrë nga qeveria, analiza e klientit bazohej edhe në të dhënat informale të klientit, duke krijuar kushtet për një rrezik moral, nga punonjësit e bankave për të mbartur më shumë rrezik, të ndikuar nga planet (objektivat) që kanë për dhënie kredie. Prandaj ulja e informalitetit ndikon në rritjen e kredidhënies cilësore duke ulur mundësinë për interpretime subjektive në analizën e aftësisë paguese të klientit e cila më parë bazohej kryesisht tek të ardhurat reale e jo fiskale.
- *Norma e Inflacionit* paraqitet nga 80.35% mesatarisht problematike duke pohuar se B.SH ka arritur ta mbajë në nivele të qëndrueshme dhe për bankat e nivelit të dytë nuk përbën problem ky tregues. Dihet që një rritje inflacioni, e përmirëson pagesën e kredive sepse shkaktton një ulje të vlerës reale të principalit të mbetur pa paguar, dhe kredimarrësit kanë më shumë mundësi të paguajnë këstet e kredisë, dhe si rrjedhojë një nivel më të ulët të kredive me probleme. Nga këndvështrimi i bankave mbajtja e inflacionit në nivele të qëndrueshme, i mbron ato nga ekspozimet ndaj këtij treguesi.
- *Kursi i këmbimit* i klientëve rezulton nga 58.92% mesatarisht problematike, sepse bankat kanë akoma kredi në portofolin e tyre të disbursuara në monedhë të huaj, prandaj së fundmi është rritur orientimi drejt kredidhënies në monedhën në të cilën janë të ardhurat, në mënyrë që të minimizohet ekspozimi nga kurset e këmbimit.

➤ **REKOMANDIME**

Më poshtë renditen disa rekomandime të ndara sipas palëve të interesit, duke filluar nga ato që janë direkt në kontakt me problematikën e kredive me probleme deri tek niveli më i lartë vendimmarrës.

➤ **Bankave të nivelit të dytë:**

- Norma e kredive me probleme duhet të menaxhohet më shumë nga bankat sepse nga studimi rezultoi që është tregues me ndikim të konsiderueshëm dhe statistikisht të rëndësishëm në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit;
- Nga studimi rezultoi që kapitali rregullator është me ndikim të konsiderueshëm dhe statistikisht i rëndësishëm në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, prandaj bankat duhet ta monitorojnë më me prioritet, me qëllim përmbushjen e rregullores së Bazel II;
- Bankat bëjnë mirë që përdorin minimumet në normën e interesit për të mbrojtur veten, por ato duhet që klientit t'ia bëjnë të ditur se norma fillestare nuk është për të gjithë periudhën e kredidhënies, por është vetëm për afate 1-2 vjeçare dhe se pas 1-2 vitesh kësti i kredisë i rritet, e të mos rezultojë me probleme si pasojë e mos informimit të rritjes së normës.
- Në analizat financiare të aftësisë paguese të klientëve duhet të marrin në konsideratë Normen Efektive të Interesit (NEI), dhe jo normën me të cilën bëjnë marketingun për shitjen e kredisë;
- Bankat duhet të vazhdojnë të jenë të orientuara drejt kredidhënies cilësore;
- Të jenë më shumë të orientuara drejt ristrukturimeve e të mos drejtohen menjëherë drejt posedimit të pronës, presion ky që nxit klientët drejt tregut të fajdeve apo veprimtarive të tjera kriminale;
- Bankat kanë filluar, por duhet të vazhdojnë të kërkojnë marzhe të larta mbulimi kredie me kolateral, në mënyrë që kolaterali të jetë lehtësisht i tregtueshëm, e nëse kalon ankadet e shitjes, vlera e tij të mos rezultojë më e ulët se detyrimi i mbetur i klientit. Nga ana tjetër nuk duhet të pranojë kolaterale me marzhe mbulimi kredie tepër të larta, sepse me marrjen aset të pronës, bankës i bie që klientit përveç se ti mbylli kredinë, ti kalojë edhe diferencën e vlerës së kontabilizimit të asetit. Prandaj rekomandohet që kjo pjesë të menaxhohet me kujdes.
- Nga studimi rezultoi që variabli Depozita Totale/Aktivitet Totale kishte një ndikim të konsiderueshëm në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, prandaj është përgjegjësi e bankave mirëmbajtja e fondeve të popullatës, kështu që ato duhet të kujdesen më shumë për uljen e kredive me probleme.
